



# **INSPEKTIMI DHE VLERËSIMI I BRENDSHËM I SHKOLLËS**

**(UDHËZUES PËR INSPEKTIMIN E PLOTË TË SHKOLLËS)**

**TIRANË, 2011**

Ky botim u përgatit nga ekipi qendror:

- |             |           |
|-------------|-----------|
| 1. Robert   | Gjedia    |
| 2. Anesti   | Misha     |
| 3. Stavri   | Llambiri  |
| 4. Neritan  | Babamusta |
| 5. Refik    | Çela      |
| 6. Vladimir | Pasku     |

Stafi i IKAP-it:

- |               |        |              |         |
|---------------|--------|--------------|---------|
| 1. Edit       | Dibra  | 11. Lindita  | Çifçi   |
| 2. Rahim      | Kaleci | 12. Petrit   | Haxhia  |
| 3. Teuta      | Çobaj  | 13. Ilireta  | Kamani  |
| 4. Aleksandër | Prenga | 14. Holta    | Seferi  |
| 5. Antoneta   | Ramaj  | 15. Majlinda | Lika    |
| 6. Rolanda    | Bulku  | 16. Anisa    | Neli    |
| 7. Bukurie    | Haxhia | 17. Mirela   | Kondili |
| 8. Eniana     | Veli   | 18. Anastas  | Kacorri |
| 9. Etleva     | Lundra | 19. Lindita  | Doçi    |
| 10. Uzri      | Alku   |              |         |

Ky botim u konsultua dhe u mbështet nga ekspertët ndërkombëtarë të fushës së kurrikulës dhe të inspektimit, të ardhur në IKAP gjatë periudhës 2010-2011, në kuadër të programit “Cilësi dhe Barazi në Arsim”

- |              |          |
|--------------|----------|
| 1. Alexandru | Crishan  |
| 2. Giseele   | Desseuix |
| 3. Alain     | Michel   |

Redaktimi shkencor: Nikoleta Mita

Redaktimi letrar: Antoneta Ramaj

Falenderojmë për kontributin, idetë, sugjerimet e vlefshme, që kanë dhënë në takimet e posaçme të punës për këtë udhëzues, specialistë të MASH-it, AKAFP-së, IZHA-s, AKP-së, DAR-it Tiranë, si dhe pedagogë të fushës së vlerësimit nga Fakulteti i Shkencave Sociale të Universitetit të Tiranës, drejtues dhe mësues të shkollave 9-vjeçare dhe të mesme në qytete dhe fshatra të ndryshme të vendit.

© Copyright: IKAP

## **PËRMBAJTJA**

<b>FJALA E MINISTRIT .....</b>	<b>5</b>
<b>INSPEKTIMI DHE VLERËSIMI I BRENDSHËM I SHKOLLËS .....</b>	<b>6</b>
<b>FUSHA I. KURRIKULA E ZBATUAR .....</b>	<b>9</b>
<b>FUSHA II. MËSIMDHËNIA DHE TË NXËNËT .....</b>	<b>26</b>
<b>FUSHA III. KLIMA DHE ETIKA NË SHKOLLË .....</b>	<b>47</b>
<b>FUSHA IV. KUJDESI PËR NXËNËSIT .....</b>	<b>56</b>
<b>FUSHA V. MENAZHIMI I SHKOLLËS .....</b>	<b>68</b>
<b>FUSHA VI. ZHVILLIMI I BURIMEVE NJERËZORE .....</b>	<b>81</b>
<b>FUSHA VII. VLERËSIMI I NXËNËSVE DHE ARRITJET .....</b>	<b>94</b>
<b>FJALORTH .....</b>	<b>107</b>
<b>BIBLIOGRAFIA .....</b>	<b>113</b>
<b>NË VEND THE MBYLLJES .....</b>	<b>115</b>

*Të dashur mësuese dhe mësues,*

*Të nderuar drejtues dhe drejtuese të shkollave,*

Vitet e fundit po zbatohen reforma të thella në shkollat e arsimit parauniversitar. Këto inisiativa të reja, të guximshme dhe sfiduese janë përpjekje që po i japin shkollës më shumë autonomi, liri profesionale dhe vendimmarrje.

Përgjegjësitë e shkollës janë të mëdha. Shkolla është vendi ku edukohet qytetaria demokratike dhe synohet të formohen të rinj e të reja që të përballojnë me sukses çdo sfidë.

Sot shkolla ka një përmbajtje të re. Ajo zbaton dhe zhvillon një kurrikulë të përafërt dhe konkurruese me atë evropiane. Kurrikula bërthamë dhe ajo me zgjedhje, projektet kurrikulare, veprimtaritë dhe aftësitë ndërkurrikulare janë elemente të qarta të reformimit të përmbajtjes së shkollës sonë. Kurrikula e re i pajis nxënësit me kompetenca të domosdoshme për të vijuar studimet në shkollat e larta ose për t'u përfshirë drejtpërdrejt në tregun e punës, si brenda dhe jashtë vendit.

Procesi i mësimdhënies dhe i nxënies po pasurohet çdo ditë edhe me përfshirjen e teknologjive të reja të informacionit. Kjo ka bërë që mësuesit të ndiejnë nevojën e trajnimit dhe të kualifikimit të vazhdueshëm.

Tashmë jemi në fazën e sigurimit të cilësisë në shkollë. Kjo është një rrugë e gjatë dhe plot vështirësi, por jeni ju, mësuesit dhe drejtuesit e shkollave, që po e përballoni me sukses atë, duke e shndërruar shkollën në një vatër të krijimit të aftësive dhe të rritjes së cilësisë së shërbimit arsimor.


Udhëzuesi "Inspektimi dhe vlerësimi i brendshëm i shkollës" vjen për herë të parë tek ju, me tregues arsimorë të qartë e të matshëm, me instrumente vëzhgimi e vlerësimi, që synojnë përmirësimin dhe rritjen e cilësisë së punës së mësuesve dhe të drejtuesve të shkollës.

Ky është një proces që kërkon kohë, përpjekje dhe angazhim profesional, por mbi gjithçka, kërkon një kombinim të frytshëm të vetëvlerësimit që ju do të zhvilloni vit pas viti si shkollë, me vlerësimin e jashtëm që zhvillohet nga institucionet e specializuara të MASH-it.

Gjej rastin që të përshëndes gjithë stafin e IKAP-it për punën serioze që ka nisur. Ky institucion i ri po bën përpjekjet e duhura për vlerësimin e shërbimit arsimor dhe sigurimin e cilësisë në arsimin parauniversitar shqiptar.

***Ju uroj të gjithëve suksese dhe mbarësi!***

**MYQEREM TAJAJ  
MINISTËR**



## INSPEKTIMI<sup>1)</sup> DHE VLERËSIMI I BRENDSHËM I SHKOLLËS

Procesi i vlerësimit të brendshëm dhe ai i vlerësimit të jashtëm të shkollës kërkon përdorimin e një metodologjie shkencore, të qartë, të besueshme dhe bashkëkohore, e cila siguron të dhëna reale dhe mundësi për të pasqyruar pikat e forta, pikat e dobëta, mundësitë që shkolla ka për të ofruar një shërbim arsimor cilësor, dhe në mënyrë të veçantë, nevojat për përmirësimin e saj në të ardhmen.

Nga ana tjetër, përdorimi i së njëjtës metodologji dhe i të njëjtëve tregues, si nga ekipet e vlerësimit të brendshëm të shkollës, edhe nga ekipet e vlerësimit të shkollës nga jashtë, (nga Inspektorati Kombëtar i Arsimit Parauniversitar) është një mënyrë që përafron këto dy vlerësime që synojnë përmirësimin e punës së shkollës, por edhe përcaktimin e nivelit të cilësisë dhe të meritave të saj. I rëndësishëm është qëllimi i IKAP-it, për të zhvilluar në shkollë hap pas hapi, kulturën e vlerësimit të brendshëm (vetëvlerësim). Kjo është një rrugë profesionale dhe sfiduese që kërkon njohje dhe zotërim të standardeve profesionale dhe etike të vlerësimit, angazhim dhe përgjegjësi të të gjithë personave të përfshirë në vlerësim, të ekipeve të vlerësimit, të autoriteteve dhe organizmave drejtues të shkollës.

***Po cilat janë elementet e metodologjisë së vlerësimit të brendshëm dhe të vlerësimit të jashtëm të shkollës?***

**Fusha** nënkupton një drejtim apo dimension themelor të veprimtarisë së shkollës. Fusha lidhet drejtpërdrejt me gjithë veprimtarinë e shkollës. Përcaktimi i fushave të veprimtarisë bazohet në aktet ligjore dhe nënligjore të arsimit, qëllimet e arsimit, dokumentet kurrikulare. Janë përcaktuar këto fusha kryesore të vlerësimit:

- § **Kurrikula e zbatuar,**
- § **Mësimdhënia dhe të nxënëet,**
- § **Klima dhe etika,**
- § **Kujdesi ndaj nxënësve,**
- § **Menazhimi i shkollës,**
- § **Zhvillimi i burimeve njerëzore,**
- § **Vlerësimi i nxënësve dhe arritjet.**

---

1) Inspektimi në këtë material nënkupton vlerësimin e jashtëm të shkollës.

**Nënfusha** është një nëndarje, detajim dhe element i domosdoshëm që tregon dhe plotëson më së miri përmbajtjen e një fushe të caktuar, për të cilën punon shkolla. Konkretisht, nëse një nga fushat e shkollës është "Kurrikula e zbatuar" detajimet apo nëndarjet për të janë: "Kurrikula bërthamë", "Kurrikula me zgjedhje", "Plani vjetor", "Veprimtaritë ndërkurrikulare" etj., etj., detajime që synojnë të identifikojnë se çfarë ndodh me kurrikulën e zbatuar në shkollë, dhe nga ana tjetër, plotësojnë të gjitha elementet që ka kjo fushë. Këto nëndarje apo detajime konsiderohen si një mundësi për të identifikuar, për të vëzhguar dhe për të vlerësuar në imtësi atë që ndodh në shkollë. Pra, detajimet kryejnë dy funksione:

- a) zërthejnë fushën në elemente organike dhe të domosdoshme për të,
- b) mundësojnë një njohje dhe vlerësim real të situatës në shkollë.

**Treguesi** është një fjali e matshme, pohuese që tregon si është dhe si duhet të jetë niveli i fushave. Nëpërmjet treguesve arrijmë të vlerësojmë sesi është shkolla e vetëvlerësuar dhe e inspektuar. Treguesi:

- § hartohet për secilën nënfushë dhe mund të jenë një apo disa;
- § është gjithnjë i matshëm, që do të thotë se lehtëson procesin e vlerësimit të brendshëm dhe të inspektimit të tij;
- § paraqet pohime që cilësojnë fushën që do të vlerësohet.

*P.sh.:*

Nr.	Fusha	NENFUSHA	TREGUESIT (shembuj)
	Kurrikula e zbatuar	Plani vjetor	- Plani vjetor lëndor hartohet në përputhje me dokumentet kurrikulare dhe sipas veçorive të nxënësve.
II	Mësimdhënia dhe të nxënët	Objektivat e të nxënët	- Plani mësimor i zhvilluar mundëson arritjen e objektivave të të nxënët.
III	Klima dhe etika	Mjedisi fizik	- Shkolla ka mjedise fizike të përshtatshme për zhvillimin e procesit mësimor.
IV	Kujdesi ndaj nxënësve	Kujdesi për këshillimin e karrierës së nxënësve	- Shkolla zbaton programe për këshillimin e karrierës së nxënësve.
V	Menazhimi i shkollës	Plani vjetor i shkollës	- Shkolla zbaton planin e saj vjetor.
VI	Zhvillimi i burimeve njerëzore	Trajnimi dhe kualifikimi i stafit	- Shkolla realizon identifikimin e nevojave të stafit për trajnim.
VII	Vlerësimi dhe arritjet e nxënësve	Produktet që vlerësohen	- Mësuesi <sup>2</sup> vlerëson dosjen e nxënësve.

2) Fjala *mësuesi* nënkupton mësuesen dhe mësuesin.

**Instrument i vëzhgimit**<sup>3</sup> është një fjali që përcakton se si zbatohet, si zhvillohet apo në ç' gjendje paraqitet treguesi i synuar. Nëpërmjet instrumenteve/përshkruesve mblidhen informacione dhe të dhëna për plotësimin e treguesve nga shkolla.

**Shkallë vlerësimi** janë nivelet që përdoren për të vlerësuar shkollën përmes fushave të saj. Nivelet e vlerësimit janë katër: *shumë mirë* që i takon numrit 1, *mirë* që i takon numrit 2, *mjaftueshëm* që i takon numrit 3 dhe *dobët* që i takon numrit 4. Skema me katër shkallë vlerësimi është mjaft e përdorur në vlerësimet që u bëhen shkollave në vendet evropiane. Po ashtu, ky sistem me katër shkallë mundëson një vlerësim real dhe përfshin të gjitha nivelet që mund të arrijë shkolla sipas treguesve.

**Standardi i vlerësimit** është përshkrimi i gjendjes së shkollës për secilën fushë, i cili mundëson një vlerësim sipas niveleve të përmendura më lart. Ky vlerësim është rezultat i përpunimit të të dhënave nga instrumentet e vëzhgimit dhe të vlerësimit që i bëhet secilit tregues, por dhe i të dhënave të siguruara nga metodologjia e zbatuar gjatë vlerësimit të brendshëm apo inspektimit në përgjithësi. Vlerësimi përfundimtar për fushën bazohet gjithnjë në peshën dhe rëndësinë që ka zbatimi i secilit tregues në gjendjen e shkollës.

---

3) Instrumenti i vëzhgimit është përshkrues i treguesit.

## FUSHA 1. KURRIKULA E ZBATUAR

▪ Në realizimin e kurrikulës së zbatuar shkolla ndihmohet nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, njësitë e saj të varësisë qendrore, si dhe nga njësia përkatëse arsimore vendore (DAR/ZA-ja).

▪ Kurrikula e zbatuar ka për bazë Ligjin për Sistemin Arsimor Parauniversitar dhe aktet e tij nënligjore, Kornizën Kurrikulare, Standardet e të nxënësve sipas niveleve arsimore, planin mësimor, programet lëndore dhe materiale të tjera mbështetëse për kurrikulën, që botohen nga institucionet e varësisë së Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës.

▪ Kurrikula e zbatuar në shkollë shtjellohet si një e tërë në drejtim të:

- zhvillimit të koncepteve kryesore mësimore,
- formimit të aftësive ndërkurrikulare dhe ato specifike lëndore,
- edukimit të qëndrimeve, vlerave e besimeve,
- parimeve kryesore të procesit të mësimdhënies e të nxënies,
- vlerësimit të nxënësve.

▪ Kurrikula e zbatuar u mundëson nxënësve zgjedhje individuale sipas nevojave dhe interesave të tyre nëpërmjet kurrikulës me zgjedhje, projekteve kurrikulare dhe mënyrave të tjera të përzgjedhjes nga nxënësit.

▪ Kurrikula me zgjedhje hartohet nga shkolla nëpërmjet bashkëpunimit të personelit të saj me nxënësit, prindërit dhe më gjerë. Shkolla, në përputhje me Ligjin e Sistemit Arsimor Parauniversitar, aktet nënligjore të Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës dhe në bashkëpunim me Bordin, mësuesit, Qeverinë e Nxënësve dhe prindërit harton dhe zbaton procedura:

- a) për përfshirjen e mësuesve, nxënësve dhe prindërve në përmirësimin e cilësisë së shërbimit të shkollës;
- b) për parandalimin e vështirësive në të nxënë dhe kapërcimin e këtyre vështirësive;
- c) për ushtrimin e së drejtës së nxënësve e të prindërve për t'u informuar mbi veprimtarinë e shkollës.

Për vlerësimin e përmbushjes së treguesve, sipas çdo nënfishje të kurrikulës së zbatuar përdoren:

- a) **Vëzhgime:** vëzhgohen orë mësimore, mbledhje të këshillit pedagogjik, të ekipeve lëndore, të drejtorisë së shkollës, të bordit të saj, veprimtari jashtëshkollë të nxënësve etj.
- b) **Biseda:** organizohen biseda sipas formateve të gatshme a të parapërgatitura me drejtuesit e shkollës



(drejtorin dhe nëndrejtorët), mësues, nxënës, prindër, anëtarë të Bordit të Shkollës etj.

- c) **Shqyrtimi i dokumentacionit:** dokumentacioni përfshin planin afatmesëm dhe planin vjetor të shkollës, planin afatmesëm dhe planin vjetor të zhvillimit profesional të shkollës dhe të mësuesve, planin vjetor lëndor, planin ditor, shkresat zyrtare që i dërgohen DAR/ZA-së, shënimet (procesverbalet) e mbledhjeve të drejtorisë, të këshillit pedagogjik, të ekipit kurrikular, të ekipeve lëndore etj.
- d) **Testime:** realizohen me teste të standardizuara që hartohen nga institucione të specializuara dhe me teste të shkurtra (minitestet). Minitestet përdoren për temën e ditës ose për një objektiv të caktuar në listën e objektivave të arritjeve të nxënësve për një kapitull të caktuar. Ato përmbajnë vetëm një kërkesë që ka vetëm dy mundësi vlerësimi: "është zgjidhur saktë" ose "është zgjidhur gabim". Ministesti hartohet për njërin nga tri nivelet: *minimal*, *mesatar* dhe *i lartë*. Ministesti për temën e ditës bazohet në shtjellimin e orës që vëzhgohet. Ministesti i kapitullit mund të hartohet për çdo kapitull të zhvilluar dhe teston qëndrueshmërinë e njohurive.

Për instrumente të veçanta mund të mjaftojë vetëm njëra nga metodat e mësipërme, por zakonisht, për një vlerësim të qartë e sa më të saktë, është i nevojshëm kombinimi i më shumë se një metode, p.sh.: për të vlerësuar instrumentin: "*Mësuesi përdor rregullisht laboratorin virtual (laptop+projektor digjital)*", duhet të shqyrtohet një dokument, pikërisht, plani ditor i mësuesit për të pikasur dendurinë e përdorimit të laboratorit virtual. Mirëpo, kjo metodë është e pamjaftueshme, ndaj duhet të paktën vëzhgimi i një ore mësimore, ku të jetë planifikuar përdorimi i laptopit+projektorin digjital, për të kuptuar më qartë zotësinë e mësuesit në përdorimin efektiv të tij. Më e mira do të ishte edhe një bisedë me mësuesin rreth avantazheve dhe disavantazheve të përdorimit të laboratorit virtual.

Disa nënfusha kanë edhe instrumente të përbashkëta. Arsyeja është se ato trajtohen nga këndvështrime të ndryshme (sipas fushës). Zakonisht nuk vlerësohen të gjitha nënfushat, ndaj duhet që secila prej tyre, e planifikuar për t'u vlerësuar, ta ketë të plotë bashkësinë e instrumenteve.

Nënfusha 1	Treguesi	Instrumente	Nivelet e vlerësimit			
			1	2	3	4
<b>Plani vjetor lëndor</b>	1. Plani vjetor lëndor hartohet në përputhje me dokumentet kurrikulare.	<b>1.1.1.</b> Plani vjetor lëndor hartohet në përshtatje me dokumentet zyrtare për kurrikulën, si: Udhëzuesi për Zhvillimin e Kurrikulës së re të Gjimnazit, elementet kurrikulare të skeletkurrikulave, standardet e fushës së të nxënët, programi lëndor, udhëzimet e MASH-it.				
		<b>1.1.2.</b> Mësuesi shfrytëzon lirinë me 10% më pak ose më shumë të plani vjetor lëndor, në krahasim me programin lëndor.				
		<b>1.1.3.</b> Plani vjetor i përforcimit të një lënde të gjimnazit, përmban: - nivelin minimal të objektivave të arritjeve që i përshkruan programi lëndor, - nivelin minimal të objektivave të arritjeve që i përshkruajnë programet lëndore të klasave paraardhëse.				
		<b>1.1.4.</b> Plani vjetor lëndor mbështetet te teksti i përzgjedhur.				
	2. Plani vjetor lëndor hartohet dhe zbatohet duke marrë parasysh fleksibilitetin e kurrikulës.	<b>1.2.1.</b> Plani vjetor lëndor hartohet dhe zbatohet edhe duke përzgjedhur midis tematikave alternative.				
		<b>1.2.2.</b> Plani vjetor lëndor hartohet dhe zbatohet në përshtatje me aktualitetin dhe zhvillimet e kohës.				
		<b>1.2.3.</b> Plani vjetor lëndor hartohet dhe zbatohet duke shfrytëzuar edhe burime të tjera, të ndryshme nga teksti i nxënësit <sup>4</sup> .				
		<b>1.2.4.</b> Plani vjetor lëndor hartohet dhe zbatohet duke e lehtësuar programin nga tema, koncepte dhe informacione të tejkaluara.				

4) Fjala *nxënës* nënkupton nxënësen dhe nxënësin.

		<b>1.2.5.</b> Plani vjetor lëndor hartohet për t'u zbatuar në kushtet konkrete të shkollës.				
		<b>1.2.6.</b> Plani vjetor lëndor hartohet në përputhje me interesat dhe nivelin e nxënësve.				
	3. Plani vjetor lëndor hartohet duke u mbështetur në formate orientuese.	<b>1.3.1.</b> Plani vjetor lëndor ka një strukturë të qartë, të përbërë nga: hyrja, tabela përmbledhëse dhe plani për çdo kapitull.				
		<b>1.3.2.</b> Hyrja e plani vjetor lëndor paraqet synimin vjetor të lëndës, objektivat e përgjithshëm vjetor për aftësitë specifike lëndore dhe ato kroskurrikulare.				
		<b>1.3.3.</b> Tabela përmbledhëse statistikore e planit vjetor tregon numrin e orëve dhe përqindjet e tyre sipas llojeve të temave <sup>5</sup> .				
		<b>1.3.4.</b> Plani për çdo kapitull përmban: titullin, numrin e orëve mësimore për zhvillimin e kapitullit, objektivat përkatës të programit mësimor dhe tabelën e temave për orët mësimore <sup>6</sup> .				

5) Tabela përmbledhëse

Lloji i temave	Numri i orëve	Përqindja
Njohuri të reja		Përqindja kundrejt totalit të orëve
Përpunimi i njohurive		Përqindja kundrejt totalit të orëve
a) Përsëritje		% kundrejt totalit të orëve të përpunimit
b) Provime		% kundrejt totalit të orëve të përpunimit
c) Projekte kurrikulare		% kundrejt totalit të orëve të përpunimit

6) Tabela e temave për orët mësimore

Nr.	Tema	Lloji	Komente

Te "lloji" shënohet: "përsëritje" për përsëritjen e një ose disa kapitujve; "përsëritje vjetore"; "provim" për detyrat njëorëshe me shkrim; "projekte" për projektet kurrikulare; "laborator" për punët laboratorike.

Te "komente", mësuesi shënon ndryshimet e dobishme që i dalin gjatë vitit shkollor.

Nënfusha 2	Treguesit	Instrumente	Nivelet e vlerësimit			
			1	2	3	4
<b>Aftësitë dhe temat kroskurrikulare</b>	1. Mësuesi harton dhe zbaton objektiva për zhvillimin e aftësive dhe temave kroskurrikulare (ndërkurrikulare).	<b>2.1.1.</b> Mësuesi harton dhe zbaton objektiva për zhvillimin e aftësive kroskurrikulare të tilla, si: aftësia e menazhimit të informacionit, e të menduarit kritik, e të menduarit krijues, e punës së pavarur individuale dhe në grupe të vogla, e problemzgjdhjes, e qëndrimit etiko-social, aftësia e komunikimit në gjuhën shqipe, e përdorimit të matematikës dhe e përdorimit të TIK-ut.				
		<b>2.1.2.</b> Mësuesi i zbaton objektivat për aftësitë kroskurrikulare të lidhura me njëra-tjetrën.				
		<b>2.1.3.</b> Mësuesi i zbaton objektivat për aftësitë kroskurrikulare në të gjithë procesin e nxënies.				
		<b>2.1.4.</b> Objektivat për aftësitë kroskurrikulare janë të orientuara drejt procesit të nxënies.				
		<b>2.1.5.</b> Aftësitë kroskurrikulare planifikohen vetëm në funksion të objektivave të lëndës ku ndërthuren këto aftësi.				
		<b>2.1.6.</b> Mësuesi zhvillon temat ndërkurrikulare në lëndën e tij.				

Nënfusha 3	Treguesit	Instrumente	Nivelet e vlerësimit			
			1	2	3	4
<b>Kurrikula me zgjedhje</b>	1. Shkolla ofron zgjedhjen sipas interesave të nxënësve, mundësive të saj, nevojave të komunitetit dhe tregut të punës.	<b>3.1.1.</b> Kurrikula me zgjedhje planifikohet nëpërmjet: <ul style="list-style-type: none"> <li>- orëve ekstrakurrikulare;</li> <li>- orëve të lira;</li> <li>- orëve të kurrikulës me zgjedhje në arsimin e mesëm.</li> </ul>				

		<b>3.1.2.</b> Shkolla planifikon zgjedhjen në përputhje me nevojat e nxënësve dhe mundësitë e shkollës.				
		<b>3.1.3.</b> Shkolla i siguron çdo nxënësi mundësi për të marrë pjesë në projekte kurrikulare, projekte të nxëni, module dhe praktika profesionale.				
		<b>3.1.4.</b> Shkolla kujdeset që nxënësit të realizojnë orët për shërbimet komunitare (gj) <sup>7</sup> .				
		<b>3.1.5.</b> Shkolla zbaton kriteret e pjesëmarrjes së nxënësve në përforcim (gj).				
		<b>3.1.6.</b> Përzgjedhja e moduleve të praktikave profesionale bëhet në përputhje me profilin dhe kushtet e shkollës.				
		<b>3.1.7.</b> Planifikimi i kurrikulës me zgjedhje bëhet në përshtatje me kërkesat dhe tregun e punës.				
	2. Shkolla zbaton një platformë/program të qartë për procesin e planifikimit të kurrikulës me zgjedhje të detyruar.	<b>3.2.1.</b> Shkolla ka planin e vet të kurrikulës me zgjedhje të detyruar, ku përcaktohen klasat që zhvillojnë lëndë dhe module me zgjedhje.				
		<b>3.2.2.</b> Gjimnazi ka marrë notat përfundimtare të nxënësve të klasës së 9-të dhe ato të Provimeve të Lirimit, nga shkollat përkatëse të arsimit bazë.				
		<b>3.2.3.</b> Gjimnazi përpilon formularin 1 dhe ua shpërndan nxënësve të klasave të 9-ta të arsimit bazë, të paktën katër muaj para datës së përfundimit të vitit shkollor.				
		<b>3.2.4.</b> Gjimnazi përpilon formularin 1 dhe ua shpërndan nxënësve të klasës së 10-të, 11-të dhe të 12-të, të paktën katër muaj para datës së përfundimit të vitit shkollor.				

---

7) (gj) nënkupton gjimnaz.

		<b>3.2.5.</b> Shkolla njofton nxënësit dhe prindërit për kriteret e pjesëmarrjes në lëndë/module të caktuara me zgjedhje të detyruar.				
		<b>3.2.6.</b> Shkolla u paraqet nxënësve dhe prindërve një përshkrim përmbledhës të lëndës/modulit me zgjedhje, ku përfshihet përmbajtja, ngarkesa e modulit dhe përfitimet nga përzgjedhja e tyre.				
		<b>3.2.7.</b> Shkolla, për të siguruar parapëlqimet e nxënësve, i kërkon personel DAR/ZA-së me anë të një shkrese zyrtare.				
		<b>3.2.8.</b> Shkolla ka plotësuar parapëlqimet e nxënësve në kurrikulën me zgjedhje të detyruar. - Përqindja e nxënësve që u është plotësuar parapëlqimi i parë: __ %. - Përqindja e nxënësve që u është plotësuar parapëlqimi i dytë: __ %.				
		<b>3.2.9.</b> Shkolla i siguron çdo nxënësi mësimin e një gjuhe të huaj. - Përqindja e nxënësve që mësojnë një gjuhë të huaj __ %.				
		<b>3.2.10.</b> Shkolla i siguron çdo nxënësi mësimin e gjuhës angleze si gjuhë të huaj të parë ose të dytë. - Përqindja e nxënësve që mësojnë gjuhën angleze si gjuhë të huaj të parë ose të dytë __ %.				
		<b>3.2.11.</b> Planifikimi i kurrikulës me zgjedhje të detyruar bëhet në përshtatje me kërkesat dhe tregun e punës.				
	3. Shkolla zbaton një platformë/program të qartë për procesin e	<b>3.3.1.</b> Shkolla njofton me shkresë zyrtare DAR/ZA-në për modulet që kanë program të miratuar nga MASH-i dhe për mësuesin që e realizon atë (diploma, certifikata). (gj)				

planifikimit të kurrikulës me zgjedhje të lirë.	<b>3.3.2.</b> Shkolla i parashtron DAR/ZA-së kërkesën me shkrim për miratim të moduleve me zgjedhje të lirë që nuk kanë program të miratuar nga MASH-i.				
	<b>3.3.3.</b> Kërkesa me shkrim përmban: - numrin e nxënësve, - numrin e orëve mësimore, - objektivat e përgjithshëm të arritjeve të nxënësve në lëndën/modulin, - përshkrimin përmbledhës të përmbajtjes, - kompetencat e mësuesit përkatës (diploma, certifikimi, licenca), - baza materiale që shkolla disponon (gj).				
	<b>3.3.4.</b> Kryetari i Bordit të Shkollës ka miratuar me shkrim zhvillimin e moduleve që kanë nevojë për shpenzime financiare.				
	<b>3.3.5.</b> Shkolla ka siguruar module të gatshme nga OJF, fondacione, gjimnaze të tjera ose shkolla profesionale, interneti etj.				
	<b>3.3.6.</b> Shkolla/mësuesi harton module në mënyrë të pavarur.				
	<b>3.3.7.</b> Shkolla ka përshtatur module të përgatitura nga të tjerë.				
	<b>3.3.8.</b> Modulet i zhvillojnë mësuesit me diplomën përkatëse ose persona të tjerë me kompetencën e mjaftueshme profesionale.				
	<b>3.3.9.</b> Shkolla ka njoftuar nxënësit dhe prindërit për kriteret e pjesëmarrjes në module.				
	<b>3.3.10.</b> Shkolla u ofron nxënësve dhe prindërve një përshkrim përmbledhës të moduleve.				

		<b>3.3.11.</b> Shkolla bashkëpunon me prindërit për të ideuar tematikat e moduleve.				
		<b>3.3.12.</b> Shkolla/mësuesi bashkëpunon me nxënësit për të ideuar tematikat e moduleve.				
		<b>3.3.13.</b> Shkolla siguron personel jashtëshkollor nga të ardhurat e veta për hartimin ose realizimin e moduleve.				
		<b>3.3.14.</b> Shkolla ka plotësuar parapëlqimet e nxënësve për modulet me zgjedhje të lirë. - Përqindja e nxënësve që u është plotësuar parapëlqimi i parë: ____%. - Përqindja e nxënësve që u është plotësuar parapëlqimi i dytë: ____%.				
		<b>3.3.15.</b> Shkolla ka siguruar module të gatshme ____%, module të përshtatura ____%, module të krijuara ____%.				
		<b>3.3.16.</b> Shkolla ka module: - të përgatitura në bashkëpunim me prindërit e nxënësve të shkollës: ____%; - të realizuara në bashkëpunim me prindërit e nxënësve të shkollës: ____%.				
		<b>3.3.17.</b> Shkolla zhvillon module jashtë mjediseve të saj, në masën ____%.				
		<b>3.3.18.</b> Shkolla ka nxënës që nuk kanë përzgjedhur Histori arti nga fusha e arteve, në masën ____%.				
		<b>3.3.19.</b> Modulet nuk kanë shkallë të lartë vështirësie dhe mbingarkesë njohurish.				
		<b>3.3.20.</b> Është ngritur dhe funksionon komisioni për mbarëvajtjen e shërbimit komunitar (gj).				



Nënfusha 4	Treguesit	Instrumente	Nivelet e vlerësimit			
			1	2	3	4
<b>Teksti</b>	1. Mësuesit përzgjedhin tekstet dhe modulet profesionale.	<b>4.1.1.</b> Shkolla ndjek të gjitha procedurat e përzgjedhjes së tekstit.				
		<b>4.1.2.</b> Mësuesit/instruktorët janë pjesë e procesit të përzgjedhjes.				
		<b>4.1.3.</b> Teksti përzgjidhet në përputhje me nivelin dhe interesat e nxënësve.				
		<b>4.1.4.</b> Teksti përzgjidhet në përputhje me mundësitë e shkollës.				
		<b>4.1.5.</b> Modulet profesionale përzgjidhen në përshtatje me nivelin mesatar të mësuesve dhe të instruktorëve.				
		<b>4.1.6.</b> Modulet e praktikave profesionale me zgjedhje të detyruar përzgjidhen në përshtatje me kushtet mesatare të shkollës.				

Nënfusha 5	Treguesit	Instrumente	Nivelet e vlerësimit			
			1	2	3	4
<b>Laboratorët dhe mjetet mësimore</b>	1. Shkolla është e pajisur në mënyrë të mjaftueshme me laboratorë dhe mjete mësimore.	<b>5.1.1.</b> Shkolla është e pajisur në mënyrë të mjaftueshme me laboratorë të shkencave të natyrës, shkencave shoqërore, TIK-ut dhe laboratorin virtual.				
		<b>5.1.2.</b> Mësuesi shfrytëzon mjetet e laboratorit për përvetësimin e lëndës nga të gjithë nxënësit.				
		<b>5.1.3.</b> Mësuesit dhe nxënësit zbatojnë në laborator rregullat e sigurisë.				
		<b>5.1.4.</b> Mësuesi përdor rregullisht laboratorin virtual (laptop+projektor digjital), për të lehtësuar procesin e të nxënësve.				

		<b>5.1.5.</b> Laboratorët janë të mirëmbajtur.				
		<b>5.1.6.</b> Shkolla ka mjediset dhe mjetet e domosdoshme për lëndën e edukimit fizik dhe të sporteve.				
		<b>5.1.7.</b> Mësuesi i edukimit fizik dhe i sporteve shfrytëzon mjediset dhe mjetet për përvetësimin e lëndës nga të gjithë nxënësit.				
		<b>5.1.8.</b> Mësuesit dhe nxënësit zbatojnë në mjediset e edukimit fizik rregullat e sigurisë nga rreziqet.				
		<b>5.1.9.</b> Mjediset dhe mjetet për lëndën e edukimit fizik dhe të sporteve janë të mirëmbajtura.				
		<b>5.1.10.</b> Shkolla bashkëpunon me komunitetin e prindërve për krijimin e mjeteve mësimore.				
		<b>5.1.11.</b> Mësuesi bashkëpunon me nxënësit për krijimin e mjeteve të reja mësimore.				
		<b>5.1.12.</b> Mjetet didaktike ndërtohen në përputhje me objektivat mësimorë.				

Nënfusha 6	Treguesit	Instrumente	Nivelet e vlerësimit			
			1	2	3	4
<b>Baza prodhuese</b> <sup>8</sup>	1. Shkolla disponon bazë prodhuese për realizimin e moduleve dhe të praktikave profesionale.	<b>6.1.1.</b> Shkolla profesionale ka mjete dhe materiale që nevojiten për çdo profil profesional, të renditura në udhëzuesit kurrikularë.				
		<b>6.1.2.</b> Shkolla profesionale zhvillon praktikat profesionale të nxënësve.				
		<b>6.1.3.</b> Shkolla i organizon praktikat profesionale në				

8) Baza prodhuese është mjedisi mësimor për praktikat profesionale.

		mënyrë të larmishme dhe në funksion të nxënies.				
		<b>6.1.4.</b> Baza prodhuese është një mjedis mësimor i sigurt.				
		<b>6.1.5.</b> Baza prodhuese ka mjetet dhe pajisjet e nevojshme për realizimin e moduleve të praktikës profesionale.				
		<b>6.1.6.</b> Baza prodhuese e bën më konkrete procesin e realizimit të njohurive teorike dhe të koncepteve abstrakte.				
		<b>6.1.7.</b> Baza prodhuese plotëson kërkesat higjieno-sanitare për zhvillimin normal të procesit.				
		<b>6.1.8.</b> Baza prodhuese ka mjete të përshtatshme për nivelin e rezultateve mësimore.				

Nënfusha 7	Treguesit	Instrumente	Nivelet e vlerësimit			
			1	2	3	4
<b>Projektet kurrikulare</b>	1. Mësuesi realizon projekte kurrikulare që i ndihmojnë nxënësit të përpunojnë njohuritë e mësuara dhe të zhvillojnë më tej aftësitë ndërkurrikulare.	<p><b>7.1.1.</b> Mësuesi zhvillon të paktën 1 orë projekt kurrikular për çdo 18 orë mësimore. (gj)</p> <p><b>7.1.2.</b> Projekti i hartuar nga mësuesi (mësuesit) ka këto rubrika:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- titulli i projektit;</li> <li>- objektivat e projektit;</li> <li>- lista e njohurive që do të përvetësohen;</li> <li>- kontributi i çdo mësuesi (nëse në një projekt merr pjesë më shumë se një mësues);</li> <li>- orët mësimore që i takojnë secilit partner, nëse ka (prindër, OJF etj.);</li> <li>- numri i nxënësve që përfshihen në projekt ose numri i klasave;</li> <li>- përshkrimi përmbledhës i veprimtarive kryesore përkatëse, i ndarë në hapat kryesorë, me afatet</li> </ul>				

		<p>dhe përgjegjësit (kur ka dy a më shumë mësues);</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- burimet kryesore të informacionit;</li> <li>- përshkrimi i produktit të projektit;</li> <li>- tematika e secilës orë mësimore në kuadrin e projektit<sup>9</sup>;</li> <li>- mënyra e vlerësimit të nxënësve;</li> <li>- buxheti (nëse ka).</li> </ul>				
		<p><b>7.1.3.</b> Planet e projekteve të nxënësve përmbajnë veprimtaritë kryesore të grupit të punës, personat përgjegjës, afatet.</p>				
		<p><b>7.1.4.</b> Nxënësi i përfshirë në projekt ka një detyrë të përcaktuar qartë.</p>				
		<p><b>7.1.5.</b> Nxënësit plotësojnë dosjen e projektit, e cila përmban:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- planin e projektit të nxënësve;</li> <li>- planet vetjake të nxënësve;</li> <li>- shënimet gjatë takimeve të grupit që kryen projektin;</li> <li>- listën e burimeve të informacionit;</li> <li>- raportin përfundimtar;</li> <li>- të tjera që nxënësit dëshirojnë, si: fotografi, episode interesante gjatë punës etj. (gj)</li> </ul>				
		<p><b>7.1.6.</b> Nxënësit hartojnë raportin përfundimtar të projektit që përmban:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- parashtrimin teorik (përshkruan shkurt njohuritë kryesore që janë përdorur në projekt);</li> <li>- përshkrimin përmbledhtas të veprimtarive kryesore;</li> <li>- çështjet mbizotëruese;</li> <li>- gjetjet më të rëndësishme;</li> <li>- reflektimin mbi ecurinë e projektit;</li> <li>- dosjen e projektit.</li> </ul>				

9) Në disa raste, kur projekti zgjat, është e pamundur të parashikohen zhvillimet e tij, pra, një pjesë e këtyre temave lihen bosh.

		<b>7.1.7.</b> Projekti kurrikular prezantohet para klasës ose para një audience më të gjerë.				
		<b>7.1.8.</b> Shkolla nxit nismën e nxënësve për tematikat e projekteve kurrikulare.				
		<b>7.1.9.</b> Shkolla bashkëpunon me prindërit për tematikat dhe realizimin e projekteve kurrikulare.				
		<b>7.1.10.</b> Projektet kurrikulare kanë prirje për t'u zbatuar në botën reale.				
		<b>7.1.11.</b> Projektet kurrikulare nxitin integrimin e lëndëve.				
		<b>7.1.12.</b> Mësuesi vlerëson çdo nxënës me notë, duke u bazuar te kriteret e Udhëzuesit për Zhvillimin e Kurrikulës së re të Gjimnazit (gj).				
		<b>7.1.13.</b> Mësuesi qartëson nxënësit për mënyrën e vlerësimit të projektit.				

Nënfusha 8	Treguesit	Instrumente	Nivelet e vlerësimit			
			1	2	3	4
Shërbimi komunitar	1. Shërbimi komunitar kryhet nga çdo nxënës sipas procedurave të përcaktuara dhe në dobi të komunitetit.	<b>8.1.1.</b> Mësuesi planifikon vetë ose në bashkëpunim me mësues të tjerë informimin e nxënësve rreth shërbimit komunitar (1-2 orë mësimore).				
		<b>8.1.2.</b> Shkolla/mësuesi, kur informon nxënësit rreth shërbimit komunitar, fton: <ul style="list-style-type: none"> <li>- prindërit;</li> <li>- përfaqësues të institucioneve që përgjigjen ose kryejnë veprimtari të përkujdesjes komunitare;</li> <li>- përfaqësues të qeverisë lokale, bashkisë ose komunave.</li> </ul>				
		<b>8.1.3.</b> Shkolla ka siguruar miratimin me shkrim nga prindi				

		për përfshirjen e fëmijës së tij në një shërbim të caktuar komunitar.				
		<b>8.1.4.</b> Shkolla ka plotësuar formularët e shërbimit komunitar për çdo nxënës.				
		<b>8.1.5.</b> Plani ditor për shërbimet komunitare përmban: <ul style="list-style-type: none"> <li>- qëllimin e vizitës;</li> <li>- nxënësit që do të vëzhgohen;</li> <li>- bisedat me përfituesit e shërbimit;</li> <li>- konstatimet për cilësinë e shërbimit nga nxënësit.</li> </ul>				
		<b>8.1.6.</b> Nxënësit kanë dosjen e shërbimit komunitar.				
		<b>8.1.7.</b> Mësuesi planifikon vetë ose në bashkëpunim me mësues të tjerë prezantimin e shërbimeve komunitare nga nxënësit që e kanë kryer (1-2 orë mësimore).				
		<b>8.1.8.</b> Mësuesi shënon në regjistër numrin e orëve dhe vendin e kryerjes së shërbimit komunitar nga secili nxënës.				
		<b>8.1.9.</b> Nxënësit pajisen me dëshminë për kryerjen e shërbimit komunitar.				

Nënfusha 9	Treguesit	Instrumente	Nivelet e vlerësimit			
			1	2	3	4
<b>Ekipi kurrikular i shkollës</b>	1. Ekipi kurrikular i shkollës luan një rol parësor në planifikimin e një kurrikule me zgjidhje cilësore dhe sipas parapëlqimeve të nxënësve dhe prindërve të tyre.	<b>9.1.1.</b> Shkolla ka ngritur ekipin kurrikular të kryesuar nga drejtori i shkollës dhe me pjesëmarrjen e nëndrejtorëve, kryetarëve të ekipeve lëndore dhe përfaqësuesit të DAR/ZA-së ( <i>zakonisht ai që është anëtar i Bordit të Shkollës</i> ).				
		<b>9.1.2.</b> Ekipi kurrikular fton në mbledhjet e tij përfaqësues të Bordit të Shkollës, qeverisë së nxënësve dhe këshillit të prindërve të shkollës.				

		<b>9.1.3.</b> Secili ekip lëndor i ka parashtruar ekipit kurrikular të shkollës propozimet për kurrikulën me zgjedhje të lirë që mund të zhvillojnë mësuesit e ekipit ( <i>modulet lëndore dhe ato profesionale, projektet në nivel shkolle ose klasash</i> ).				
		<b>9.1.4.</b> Ekipi kurrikular ka përzgjedhur modulet dhe projektet që do t'u ofrohen nxënësve.				
		<b>9.1.5.</b> Ekipi kurrikular ka caktuar lëndët me zgjedhje të detyruar që do t'u ofrohen nxënësve.				
		<b>9.1.6.</b> Ekipi kurrikular ka miratuar projektet kurrikulare në të cilat merr pjesë më shumë se një mësues.				
		<b>9.1.7.</b> Ekipi kurrikular ka miratuar projektet kurrikulare që kanë buxhet.				

## STANDARDI

Shkolla dhe mësuesit përdorin dokumentet kurrikulare për çdo nivel shkollimi, si bazë për zbatimin e kurrikulës bërthamë dhe me zgjedhje. Mësuesit hartojnë dhe zbatojnë plane vjetore lëndore të formatuara dhe të mbështetura te programet lëndore, dokumentet zyrtare dhe tekstet e përzgjedhura sipas të gjitha procedurave. Mësuesit planifikojnë dhe zbatojnë objektiva që zhvillojnë aftësi dhe tema kroskurrikulare, të cilat ndihmojnë procesin e të nxënit. Shkolla ka një program të qartë për planifikimin e kurrikulës me zgjedhje të detyruar dhe të lirë. Kurrikula me zgjedhje planifikohet dhe zbatohet në përshtatje me kushtet dhe mundësitë e shkollës, interesat e nxënësve, nevojat e komunitetit dhe tregut të punës. Shkolla i siguron çdo nxënësi mundësi për të marrë pjesë në projekte kurrikulare, projekte të nxëni, module e praktika profesionale, si dhe të realizojë orët për shërbimet komunitare. Shkolla ka laboratorë dhe mjedise sportive të pajisura me bazë materiale të mjaftueshme për realizimin e procesit mësimorë. Zbatimi i kurrikulës bëhet duke përdorur, përveç librit të nxënësit, edhe materiale shtesë, laboratorë e mjete mësimore në funksion të procesit mësimor.

Shkollat e arsimit profesional përdorin për zhvillimin e kurrikulës së lëndëve profesionale, bazën prodhuese e cila plotëson të gjitha kërkesat për realizimin e moduleve dhe praktikave profesionale.

## **NIVELI 1**

Shkolla dhe mësuesit përdorin dokumentet kurrikulare për çdo nivel shkollimi, si bazë për zbatimin e kurrikulës bërthamë dhe me zgjedhje. Mësuesit hartojnë dhe zbatojnë plane vjetore lëndore të formatuara dhe të mbështetura te programet lëndore, dokumentet zyrtare dhe tekstet e përzgjedhur. Mësuesit planifikojnë objektiva që zhvillojnë aftësi dhe tema kroskurrikulare, të cilat ndihmojnë procesin e të nxënës. Shkolla ka një program të qartë për procesin e planifikimit të kurrikulës me zgjedhje të detyruar dhe të lirë. Kurrikula planifikohet dhe zbatohet në përshtatje me kushtet e shkollës dhe nevojat e komunitetit e tregut të punës. Shkolla i siguron çdo nxënësi mundësi për të marrë pjesë në projekte kurrikulare, projekte të nxëni, module dhe praktika profesionale, si dhe të realizojë orët për shërbimet komunitare. Shkolla ka laboratorë dhe mjedise sportive të pajisura me bazë materiale të mjaftueshme për realizimin e procesit mësimorë. Zbatimi i kurrikulës bëhet duke përdorur, përveç librit të nxënësit, edhe materiale shtesë, laboratorë e mjete mësimore në funksion të procesit mësimor. Shkollat e arsimit profesional përdorin për zhvillimin e kurrikulës së lëndëve profesionale, bazën prodhuese e cila plotëson të gjitha kërkesat për realizimin e moduleve dhe praktikave profesionale.

## **NIVELI 2**

Shkolla dhe mësuesit përdorin dokumentet kurrikulare për çdo nivel shkollimi, si bazë për zbatimin e kurrikulës bërthamë dhe me zgjedhje. Mësuesit hartojnë dhe zbatojnë plane vjetore lëndore të formatuara dhe të mbështetura kryesisht te programet lëndore, teksti i përzgjedhur dhe dokumentet zyrtare, të cilat në ndonjë rast mund të zbatohen *apriori*. Mësuesit planifikojnë objektiva që zhvillojnë aftësi dhe tema kroskurrikulare që ndihmojnë procesin e të nxënës. Shkolla ka një program për procesin e planifikimit të kurrikulës me zgjedhje të detyruar dhe të lirë. Kurrikula planifikohet dhe zbatohet në përshtatje me kushtet e shkollës dhe nevojat e komunitetit e tregut të punës. Shkolla i siguron çdo nxënësi mundësi për të marrë pjesë në projekte kurrikulare, projekte të nxëni, module dhe praktika profesionale, si dhe të realizojë orët për shërbimet komunitare. Kurrikula zbatohet duke përdorur *kryesisht* librin e nxënësit dhe *herë pas here* edhe materiale shtesë. Shkolla ka laboratorë të pajisur me bazë materiale të pamjaftueshme për realizimin e procesit mësimorë. Mjediset sportive plotësojnë kushtet për realizimin e mësimin. Shkollat e arsimit profesional përdorin për zhvillimin e kurrikulës së lëndëve profesionale, bazën prodhuese e cila plotëson kërkesat kryesore për realizimin e moduleve dhe praktikave profesionale.

## **NIVELI 3**

Shkolla dhe mësuesit përdorin dokumente kurrikulare për çdo nivel shkollimi, si bazë për zbatimin e kurrikulës bërthamë dhe me zgjedhje, por ato *përgjithësisht* shihen si detyrime ligjore dhe jo si dokumente



që lehtësojnë e përmirësojnë procesin. Mësuesit hartojnë dhe zbatojnë plane vjetore lëndore të paformatuara, tek të cilat nuk paqyrohen të gjitha kërkesat e programit. Kurrikula zbatohet duke përdorur *kryesisht*, si burim informacioni në funksion të procesit mësimor, librin e nxënësit, të përzgjedhur sipas procedurave të përcaktuara. *Rrallë* përdoren edhe burime shtesë informative. Shkolla ka një program për procesin e planifikimit të kurrikulës me zgjedhje të detyruar dhe të lirë. Kurrikula planifikohet dhe zbatohet në përshtatje me kushtet dhe mundësitë e shkollës. Shkolla i krijon mundësi të pakta nxënësit për të marrë pjesë në projekte kurrikulare, projekte të nxëni, module dhe praktika profesionale, si dhe për të realizuar orët për shërbimet komunitare. Shkolla ka laboratorë dhe mjedise sportive me bazë materiale të pamjaftueshme për të realizuar procesin mësimor. Shkollat e arsimit profesional përdorin për zhvillimin e kurrikulës së lëndëve profesionale, bazën prodhuese e cila i plotëson *pjesërisht* kërkesat për realizimin e moduleve dhe praktikave profesionale.

#### **NIVELI 4**

Shkolla dhe mësuesit përdorin dokumente kurrikulare për çdo nivel shkollimi, për zbatimin e kurrikulës bërthamë dhe me zgjedhje. Kurrikula zbatohet duke bërë planifikimin mësimor, bazuar në udhëzimet zyrtare, të cilat *gjithnjë* shihen si detyrime ligjore e jo si dokumente që lehtësojnë dhe përmirësojnë procesin. Mësuesit zbatojnë plane vjetore lëndore të paformatuara që mbështeten te dokumente kurrikulare, por në to nuk paqyrohen të gjitha kërkesat e programit. Mësuesi planifikon *rrallë* objektiva që zhvillojnë aftësi kroskurrikulare. Kurrikula zbatohet duke u përshtatur vetëm me kushtet dhe mundësitë e shkollës, pa marrë parasysh nevojat, interesat dhe moshën e nxënësve. Zbatimi i kurrikulës bëhet duke përdorur si burim të vetëm informacioni librin e nxënësit. Shkolla ka laboratorë dhe mjedise sportive të papërshtatshme për të realizuar procesin mësimor. Shkollat e arsimit profesional përdorin për zhvillimin e kurrikulës së lëndëve profesionale, bazën prodhuese e cila *nuk* i plotëson kërkesat për realizimin e moduleve dhe praktikave profesionale.

## **FUSHA II. MËSIMDHËNIA DHE TË NXËNËT**

Mësimdhënia dhe të nxënët janë dy procese të rëndësishme, të cilat mundësojnë përvetësimin e programit mësimor nga nxënësit. Kjo fushë është mjaft komplekse dhe delikate për t'u vëzhguar, analizuar dhe për t'u vlerësuar. Modelet mësimore që përdoren në klasa, janë të shumta. Ato janë rrjedhojë e përvojës pozitive të trashëguar dhe e formave bashkëkohore që sugjerohen nga kurrikula zyrtare. Ndërkohë, përvoja bashkëkohore paraqet sot disa "familje të mëdha" të procesit mësimor, të cilat mundësojnë zbatimin e modeleve të shumta mësimore në klasat e të nxënit. Kështu, familja e krijimit të aftësive sociale, të aftësive të përpunimit të informacionit, të ndryshimit të vazhdueshëm të sjelljeve, si dhe të zhvillimit individual janë një bazë teoriko-

praktike mjaft e vlefshme për formate mësimore të shumëllojshme që burojnë nga filozofi të caktuara arsimore.

Duke qenë se mësimdhënia dhe të nxënësit është një fushë e gjerë, përmes këtij materiali po identifikojmë elementet më të rëndësishme të procesit të vlerësimit, duke paraqitur nënfusha, tregues, instrumente/përshkrues të treguesve dhe nivele të vlerësimit. Kjo që t'i shërbejë përmirësimit të vazhdueshëm të procesit mësimor, duke u bazuar në gjetje dhe përpunime reale të situatës së mësimdhënies dhe të të nxënësit në klasat tona, pavarësisht nga cikli, klasa, lënda dhe mësuesi.

### **Përshkrimi i nënfushave**

Hapi i parë profesional që kushtëzon një mësimdhënie dhe nxënie të frytshme është planifikimi i orës mësimore. Mësuesi bën planifikimin duke u mbështetur te udhëzimet zyrtare, dokumentacioni zyrtar kurrikular, plani vjetor i miratuar, tekstet, burimet materiale dhe didaktike që ka në dispozicion. Një rol parësor lehtësues për përgatitjen e planit, kanë njohjet dhe aftësitë e përdorimit dhe të zbatimit të metodologjive të mësimdhënies dhe të të nxënësit. Mësuesi, me kompetencën dhe mjeshtërinë profesionale, duhet të përzgjedhë ato metoda, teknika apo strategji mësimore, të cilat përputhen me objektivat e orës mësimore, janë të zbatueshme në kushtet konkrete të klasës dhe përshtaten me grupmoshën. Në fund të fundit, kriteri i vërtetë i vlerësimit të tyre është rezultati ose sa nxënësit arrijnë t'i përmbushin objektivat. Ky është suksesi i një plani ditor të hartuar mirë dhe me parashikim sa më të saktë të rezultateve.

Nënfusha 1 i takon "**Planit ditor**", i cili nënkupton punën e përditshme të mësuesit për çdo orë mësimore, pra na tregon mënyrën si hartohet një plani i mirë dhe sa na mundëson për një proces mësimor efektiv. Nëse shkolla dëshiron që nxënësit të kenë arritje në fund të vitit shkollor, plani i përcaktuar nga mësuesi duhet të jetë i zbatueshëm në funksion të objektivave të arritjes.

Tek nënfusha 2, "**Objektivat e të nxënësit**", përfshihen elemente të tilla, si: mënyra e paraqitjes së objektivave, tekstet e përzgjedhura, veprimtaritë e zhvilluara, bashkëpunimi mësues-nxënë, nxënë-nxënë, paraqitja e objektivave ose përmbledhja e arritjeve të tyre në fund të orës mësimore.

"**Parimet kryesore gjatë orës mësimore**" është nënfusha 3, që na jep mundësi të identifikojmë se çfarë duhet të bëjë mësuesi që nxënësit të nxënë në mënyrë aktive, për të shmangur ngarkesën, për të mundësuar lidhjen me konceptet e mësuara më parë si brenda lëndës, dhe nga lëndë të tjera apo dhe në klasa të mëparme.

Nënfusha 4, "**Ana shkencore**", merret me formimin shkencor të mësuesit dhe identifikon nëse ai zotëron konceptet dhe është i aftë të zgjidhë ushtrimet dhe situatat shkencore të tekstit të nxënësit.

"**Baza materiale dhe didaktike**" është nënfusha 5 dhe na jep mundësi të identifikojmë sa përdoret baza materiale didaktike e planifikuar, a është ajo në përshtatje me përmbajtjen mësimore, a përdoret lehtësisht

nga nxënësit dhe sa mësuesi, nxënësit dhe prindërit punojnë së bashku për përgatitjen e tyre.

Nënfusha 6, "**Mjedisi fizik**", kërkon që mësuesit të marrin në konsideratë krijimin e kushteve fizike të përshtatshme në klasë për mësimdhënien dhe të nxënësit. Ajo na mundëson të identifikojmë sa është i përshtatshëm mjedisi për punën në ekipe, për metodologjinë që përdoret; sa e mbështet planin mësimor të hartuar nga mësuesi; sa krijon mundësi që nxënësit të lëvizin natyrshëm për interesat e tyre të të nxënësit; sa ekziston mundësia që ky mjedis të shndërrohet lehtësisht në funksion të modeleve të ndryshme mësimore për të nxitur një proces motivues të nxëni.

Padyshim nënfusha 7, "**Metodologjia**", është *zemra e* planit të një ore mësimore, e cila identifikon rrugët, format, mënyrat, hapat, procedurat etj., që mësuesi përdor gjatë gjithë orës mësimore. Në këtë nënfushë shqyrtohen metodat, teknikat dhe strategjitë mësimore që përdoren në klasë dhe që mundësojnë punë individuale, punë në ekipe, përfshirje aktive apo bashkëpunim mësues-nxënës, por edhe ato që lidhen me përmbajtjen mësimore dhe krijojnë mundësi që nxënësit të përvetësojnë apo të krijojnë aftësitë e synuara nga objektivat e arritjes.

Nënfusha 8, "**Detyrat e shtëpisë**", ndalon tek një moment i domosdoshëm që ka të bëjë me nxitjen dhe vijimin e të nxëniit edhe në shtëpi. Mënyra se si mësuesi e zhvillon këtë proces, si dhe në sa nivele i jep detyrat etj. janë elemente që stimulojnë një të nxënë të frytshëm.

"**Aftësitë dhe temat ndërkurrikulare**" i takojnë nënfushës 9 dhe përbëjnë një risi në vlerësimin e mësimdhënies dhe të të nxëniit. Ajo lidhet ngushtë me përpjekjet që duhet të bëjë mësuesi në çdo orë mësimore për të kultivuar aftësitë ndërkurrikulare të: menazhimit të informacionit, të menduarit kritik e krijues, punës individuale dhe në grupe, zgjidhjes së situatave problemore të qëndrimit social, përsosjes së komunikimit në gjuhën shqipe, si dhe aftësitë në përdorimin e matematikës dhe të TIK-ut.

"**Përsëritja**" është konceptuar si nënfusha 10, pasi një sasi orësh përcaktohen në planin vjetor lëndor për këtë drejtim. Instrumentet e parashikuara për këtë nënfushë mundësojnë dhe e ndihmojnë mësuesin ta përdorë me frytshmëri përsëritjen, si një element të rëndësishëm kurrikular.

Nënfusha 11, "**Mjedisi i sigurt për të nxëniit**", është një element tjetër i natyrës afektive dhe që na jep mundësi të identifikojmë klimën në klasë, situatën emocionale që ekziston aty. A ndjehen mirë nxënësit, a i shprehin lirshëm idetë, pikëpamjet, problemet e tyre? A ka raste të dhunës, të konflikteve? Si menazhohen ato? Çështje të diversitetit e të paragjykimeve etj., etj.. Një mjedis i qetë, pozitiv të nxëni është një tregues i domosdoshëm dhe i nevojshëm për arritje në të nxënë.

Në nënfushën 12, "**Fëmijët me nevoja të veçanta**", kemi mundësi të shqyrtojmë elemente që lidhen me nxënës të veçantë me aftësi specifike, të cilët duhen stimuluar, nxitur apo lehtësuar. Kjo nënfushë synon të lehtësojë fëmijët me aftësi të kufizuara të të gjitha llojeve, fëmijët me vështirësi në të nxënë apo fëmijët e talentuar që ndodhen në klasë.

Nënfusha 13, "**Vlerësimi**", nxit rezultate të larta për të nxënësit. Kjo nënfushë ka të bëjë me identifikimin se ç'lloj vlerësimi bën mësuesi në klasë. A është bërë vlerësimi në përputhje me objektivat? A është vlerësimi motivues? A krijohet mundësia që nxënësit të vetëvlerësojnë vetveten dhe njëri-tjetrin?

Drejtime të tjera të vlerësimit, si: a e ndjek në vijimësi dhe a e përdor mësuesi atë jo vetëm si matje, por edhe si nxitje e shtysë për të nxënë; a i qartëson nxënësit për ndryshimet që ekzistojnë midis vlerësimit me gojë, atij me shkrim dhe vlerësimit të produkteve të projekteve kurrikulare duhet të jenë elemente të të nxënësit.

Nënfusha 1	Treguesit	Instrumente	Nivelet e vlerësimit			
			1	2	3	4
<b>Plani ditor</b>	1. Mësuesi harton çdo ditë planin ditor në përputhje me dokumentet kurrikulare dhe sipas veçorive të nxënësve.	<b>1.1.1.</b> Mësuesi bën planifikimin e çdo ore mësimore dhe e paraqet atë në mënyrë të vijueshme në planin ditor.				
		<b>1.1.2.</b> Përdor zakonisht si elemente të përhershme: objektivat, metodologjinë, burimet e mjetet didaktike të mësimdhënies dhe të të nxënësit dhe vlerësimin.				
		<b>1.1.3.</b> Përdor zakonisht strukturën e mëposhtme: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Tema e orës mësimore,</li> <li>• Objektivi përkatës i programit mësimor,</li> <li>• Objektivi (objektivat) e orës mësimore,</li> <li>• Plani i orës mësimore,</li> <li>• Vlerësimi,</li> <li>• Detyrat e shtëpisë,</li> <li>• Refleksione.</li> </ul>				
		<b>1.1.4.</b> Vendos temën përkatëse sipas planit vjetor.				
		<b>1.1.5.</b> Vendos në planin ditor dy lloje objektivash, si: <ul style="list-style-type: none"> <li>- Objektivat e programit përkatës të lëndës/modulit,</li> <li>- Objektivat e orës mësimore.</li> </ul>				
		<b>1.1.6.</b> Paraqet objektiva të lidhura ngushtë me njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet që synohen në fund të orës mësimore.				
		<b>1.1.7.</b> Harton objektiva të arritjeve të kapitullit për të tri nivelet: bazë, i mesëm, i lartë.				

		<b>1.1.8.</b> Planifikon objektiva minimale të domosdoshme.				
		<b>1.1.9.</b> Plani i orës mësimore ndërtohet duke u bazuar në modele të njohura mësimore dhe në modelin individual të mësuesit.				
		<b>1.1.10.</b> Parashikon kohën për çdo veprimtari mësimore të planifikuar që lidhet me njohuritë e reja, përsëritjen etj., të cilat nganjëherë janë të shkruara dhe me hollësi.				
		<b>1.1.11.</b> Shkruan pyetjet që konsiderohen të rëndësishme për procesin e të nxënit.				
		<b>1.1.12.</b> Përcakton kërkesa për fëmijët me nevoja të veçanta, të cilat janë rrjedhojë e objektivave të kurrikulës.				
		<b>1.1.13.</b> Shkruan përmbledhtas kërkesat përkatëse, kur duhet të vlerësojë nxënësit.				
		<b>1.1.14.</b> Rendit të gjitha materialet dhe mjetet didaktike që duhen për zhvillimin normal të mësimin.				
		<b>1.1.15.</b> Paraqet në planin e orës mësimore edhe burime të tjera që u ka kërkuar nxënësve.				
		<b>1.1.16.</b> Paraqet kohën e menduar për zhvillimin e detyrës së kontrollit.				
		<b>1.1.17.</b> Parashikon detyra shtëpie duke i saktësuar ato në tekst, por i shkruan hollësisht, kur i krijon vetë.				
		<b>1.1.18.</b> Parashikon një kohë për refleksion, të cilën e përdor shpesh si një "feedback" për rezultatet e pritshme të nxënësve, në përfundim të orës mësimore.				
		<b>1.1.19.</b> Mban rregullisht, në planin ditor, të dhëna mbi mangësitë tipike të nxënësve me vështirësi në të nxënë.				
		<b>1.1.20.</b> Përdor të njëjtin format pune edhe kur tema mësimore i takon përsëritjes ose projektit kurrikular.				

Nënfusha 2	Treguesit	Instrumente	Nivelet e vlerësimit			
			1	2	3	4
<b>Objektivat e të nxënit</b>	1. Plani mësimor i zhvilluar mundëson arritjen e objektivave të orës mësimore.	<b>2.1.1.</b> Mësuesi paraqet në fillim të orës së mësimit objektivat që duhen arritur nga nxënësit.				
		<b>2.1.2.</b> Mësuesi zbaton planin e përcaktuar në zhvillimin e orës mësimore.				
		<b>2.1.3.</b> Plani mësimor zbatohet duke kaluar natyrshëm nga një fazë e orës mësimore në tjetrën.				
		<b>2.1.4.</b> Teksti dhe materialet burimore që përdoren, lidhen ngushtë me objektivat mësimorë.				
		<b>2.1.5.</b> Koha e planifikuar për çdo veprimtari mësimore zbatohet me rigorozitet.				
		<b>2.1.6.</b> Mësuesi siguron që çdo nxënës të jetë i qartë për atë që duhet të bëjë.				
		<b>2.1.7.</b> Mësuesi e përdor kohën në mënyrë efektive dhe me fleksibilitet në varësi të progresit të nxënësve.				
		<b>2.1.8.</b> Mësuesi së bashku me nxënësit kujtojnë njohuritë e mëparshme që kanë lidhje me përmbajtjen e orës mësimore.				
		<b>2.1.9.</b> Mësuesi shpjegon ose lehtëson për nxënësit mënyrën e realizimit të veprimtarive mësimore.				
		<b>2.1.10.</b> Mësuesi verifikon dhe mbikëqyr ecurinë e nxënësve në krijimin e aftësive për njohjen dhe përdorimin e koncepteve të reja.				
		<b>2.1.11.</b> Metodatat, teknikat dhe strategjitë që përdoren nga mësuesi, (nga bashkëpunimi i tij me nxënësit, nga bashkëpunimi i nxënësve me njëri-tjetrin) mundësojnë arritjen e objektivave.				

		<b>2.1.12.</b> Mësuesi përdor forma dhe teknika të ndryshme vlerësimi për të matur arritjen e objektivave.				
		<b>2.1.13.</b> Zhvillon rregullisht miniteste për objektivat e orës mësimore dhe i vendos rezultatet në planin ditor.				
		<b>2.1.14.</b> Zhvillon rregullisht miniteste për objektiva të veçanta të kapitullit dhe i vendos rezultatet në planin ditor.				
		<b>2.1.15.</b> Plani mësimor i zhvilluar ka siguruar që të gjithë nxënësit të arrijnë objektivat minimalë të domosdoshëm për orën mësimore.				
		<b>2.1.16.</b> Plani mësimor i zhvilluar ka siguruar që një pjesë e nxënësve të kenë arritur objektivat e nivelit mesatar dhe të lartë të orës mësimore.				
		<b>2.1.17.</b> Mësuesi, në fund të orës mësimore, paraqet si janë arritur objektivat nga nivelet e ndryshme të nxënësve.				

Nënfusha 3	Treguesit	Instrumente	Nivelet e vlerësimit			
			1	2	3	4
<b>Parimet kryesore gjatë orës mësimore</b>	1. Gjatë orës mësimore, mësuesi përcakton si parësore përvetësimin nga nxënësit të koncepteve kryesore të lëndës dhe zbulimin e lidhjeve mes tyre.	<b>3.1.1.</b> Mësuesi përpqet vazhdimisht që nxënësit të kuptojnë e të mos riprodhojnë mekanikisht.				
		<b>3.1.2.</b> I vë vazhdimisht nxënësit përballë sfidave të të nxënësve, por duke mos i mbingarkuar me njohuri dhe me nivel tepër të lartë vështirësie.				
		<b>3.1.3</b> Përfshin nxënësit në përvetësimin e njohurive të reja, pasi është siguruar se ata zotërojnë mjaftueshëm njohuritë e nevojshme të mësuara më parë.				
		<b>3.1.4.</b> Shmang shtjellimin vetëm teorik të lëndës duke e				

		konkretizuar me situata dhe ngjarje të jetës së përditshme.				
		<b>3.1.5.</b> U kërkon nxënësve të mos kufizohen vetëm në shtjellimin teorik të lëndës, por ta konkretizojnë rregullisht me ngjarje dhe situata të jetës së përditshme.				
		<b>3.1.6.</b> Përqendrohet në përvetësimin e thellë nga nxënësit të koncepteve kryesore të lëndës dhe zbulimin e lidhjeve mes tyre.				
		<b>3.1.7.</b> Përqendrohet rregullisht në integrimin dhe ristrukturimin e njohurive, veçanërisht, të koncepteve themelore të sapomësuara me ato të kapitujve paraardhës dhe me të klasave paraardhëse.				
		<b>3.1.8.</b> U kërkon nxënësve të integrojnë dhe ristrukturojnë njohuritë, veçanërisht, konceptet themelore të sapomësuara me ato të kapitujve paraardhës dhe me të klasave paraardhëse.				
		<b>3.1.9.</b> Integron rregullisht njohuritë, veçanërisht, konceptet themelore të sapomësuara me njohuritë dhe konceptet e nxëna të lëndëve të tjera.				
		<b>3.1.10.</b> U kërkon nxënësve të integrojnë rregullisht njohuritë, veçanërisht, konceptet themelore të sapomësuara me njohuritë dhe konceptet e nxëna të lëndëve të tjera.				
		<b>3.1.11.</b> Ka përparësi kultivimin te nxënësit, të aftësive specifike lëndore.				

Nënfusha 4	Treguesit	Instrumente	Nivelet e vlerësimit			
			1	2	3	4
<b>Ana shkencore</b>	1.Mësuesi zotëron anën shkencore të lëndës.	<b>4.1.1.</b> Mësuesi zotëron konceptet themelore bashkëkohore të lëndës, lidhjet mes këtyre koncepteve, metodat tipike bashkëkohore të kërkimit të saj shkencor dhe strukturën shkencore të shtjellimit.				



		<b>4.1.2.</b> Mësuesi është në gjendje t'u përgjigjet saktë pyetjeve që përmban teksti i nxënësit dhe të zgjidhë saktë kërkesat (ushtrime, problema etj.) e këtij teksti.				
		<b>4.1.3.</b> Njeh lidhjet shkencore të lëndës me lëndë të tjera dhe zotëron njohuri të mjaftueshme të lëndëve të tjera, të cilat janë të domosdoshme për zotërimin e lëndës.				

Nënfusha 5	Treguesit	Instrumente	Nivelet e vlerësimit			
			1	2	3	4
<b>Baza materiale didaktike</b>	1. Mjetet didaktike e materialet e përdorura në orën mësimore mbështetin të nxënët.	<b>5.1.1.</b> Baza materiale dhe didaktike e planifikuar për mësim përdoret plotësisht në orën mësimore.				
		<b>5.1.2.</b> Mësuesi ka përgatitur dhe vetë mjete mësimore që lidhen drejtpërdrejt me arritjen e objektivave.				
		<b>5.1.3.</b> Mësuesi bashkëpunon me nxënësit, prindërit dhe komunitetin për të siguruar mjete mësimore.				
		<b>5.1.4.</b> Mësuesi përdor TIK-un në mësim, në varësi të përmbajtjes dhe objektivave mësimorë.				
		<b>5.1.5.</b> Mësuesi dhe nxënësit janë të familjarizuar me përdorimin e saktë të mjeteve didaktike dhe teknike.				
		<b>5.1.6.</b> Secili nxënës ka tekstin e tij dhe mjetet më të domosdoshme individuale për pjesëmarrje në procesin mësimor (stilolaps, fletore, vizore, ngjyra, ngjitës, laps etj.).				

Nënfusha 6	Treguesit	Instrumente	Nivelet e vlerësimit			
			1	2	3	4
<b>Mjedisi fizik</b>	1. Mjedisi fizik i klasës është funksional dhe motivon të nxënët.	<b>6.1.1.</b> Mjedisi fizik i klasës është i përshtatshëm dhe në funksion të metodave të përzgjedhura (vendosja e bankave, paraqitja e mjeteve dhe materialeve mësimore).				

		<b>6.1.2.</b> Mjedisi fizik i klasës u mundëson nxënësve të lëvizin dhe të komunikojnë lirshëm në klasë, për të realizuar punën në ekipe të vogla.				
		<b>6.1.3.</b> Mjedisi fizik lejon që nxënësit të shpallin në vende të dukshme punime individuale, të ekipeve të vogla apo të klasës.				

Nënfusha 7	Treguesit	Instrumente	Nivelet e vlerësimit			
			1	2	3	4
<b>Metodologjia</b>	1. Metodatat, teknikat dhe strategjitë e përdorura sigurojnë arritjen e objektivave të orës mësimore.	<b>7.1.1.</b> Mësuesi zhvillon në klasë metoda, teknika dhe strategji mësimore, të planifikuara në planin e tij.				
		<b>7.1.2.</b> Metodatat, teknikat dhe strategjitë mësimore krijojnë mundësi për punë individuale dhe në ekipe të nxënësve.				
		<b>7.1.3.</b> Metodatat, teknikat, strategjitë e përzgjedhura që zhvillohen, lidhen ngushtësisht me përmbajtjen dhe objektivat e orës së mësimin.				
		<b>7.1.4.</b> Mësuesi jep detyra që nxitin përfshirjen aktive të nxënësve.				
		<b>7.1.5.</b> Nxënësit punojnë në mënyrë individuale (në minuta, sekonda) në klasë.				
		<b>7.1.6.</b> Nxënësit punojnë në grupe (në minuta, sekonda).				
		<b>7.1.7.</b> Shpjegimi i mësuesit është i qartë, i kuptueshëm dhe i përshtatshëm për nxënësit.				
		<b>7.1.8.</b> Mësuesi shfrytëzon momente të ndryshme të orës mësimore për refleksione, për sqarime/instruktime për të lehtësuar të nxënët.				
		<b>7.1.9.</b> Ora mësimore rrjedh natyrshëm, me ritëm dhe pa shkëputje.				

		<b>7.1.10.</b> Ora mësimore është e hapur për pjesëmarrjen e të interesuarve, si: kolegë, prindër etj.				
		<b>7.1.11.</b> Mësuesi dhe nxënësit, në fund të orës mësimore, nxjerrin përfundimet ose japin "feedback".				

Nënfusha 8	Treguesit	Instrumente	Nivelet e vlerësimit			
			1	2	3	4
<b>Detyrat e shtëpisë</b>	1. Mësuesi planifikon detyrat e shtëpisë si vazhdim i procesit të nxënies së pavarur individuale ose në grup.	<b>8.1.1.</b> Mësuesi jep detyrë shtëpie dhe e sqaron atë në fund të orës së mësimi.				
		<b>8.1.2.</b> Mësuesi nuk i mbingarkon nxënësit te detyrat e shtëpisë (vëllim tejet i madh pune dhe kërkesa tepër të vështira).				
		<b>8.1.3.</b> Detyrat e shtëpisë nuk përmbajnë vetëm kërkesa për riprodhimin e njohurive të mësuara.				
		<b>8.1.4.</b> Detyrat e shtëpisë i jep në dy ose tri nivele.				
		<b>8.1.5.</b> Jep kërkesa për detyrë në shtëpi jo vetëm për punë të pavarur individuale por edhe për grupe të vogla nxënësish.				
		<b>8.1.6.</b> Detyrat e shtëpisë kanë, herë pas here, kërkesa për përdorimin e TIK-ut.				
		<b>8.1.7.</b> Nxënësve u jepet rregullisht mundësia të përzgjedhin vetë kërkesa për detyrë shtëpie.				
		<b>8.1.8.</b> Mësuesi qorton rregullisht fletoret e detyrave të shtëpisë.				

Nënfusha 9	Treguesit	Instrumente	Nivelet e vlerësimit			
			1	2	3	4
Aftësitë dhe temat ndërkurrikulare	1. Mësuesi ka parasysh kultivimin të nxënësit të aftësive ndërkurrikulare dhe trajtimin e temave ndërkurrikulare.	<b>Aftësia e menazhimit të informacionit</b>				
		<b>9.1.1.</b> Mësuesi, gjatë përgatitjes për mësim, përdor burime <sup>10</sup> plotësuese të informacionit përveç tekstit të nxënësit.				
		<b>9.1.2.</b> Planifikon vizita të nxënësve në institucione, ekspozita, muze, kompani biznesi etj.				
		<b>9.1.3.</b> Planifikon vëzhgime nga nxënësit të dukurive natyrore ose shoqërore.				
		<b>9.1.4.</b> U kërkon nxënësve dhe i ndihmon të pasurojnë dhe thellojnë përmbajtjen e tekstit duke përdorur burime të tjera të informacioni.				
		<b>9.1.5.</b> U kërkon nxënësve të analizojnë në klasë fragmente të tekstit të nxënësit ose të një materiali të shkruar për të kuptuar “termat-kyç”, konceptet kryesore dhe paqartësitë.				
		<b>Aftësia e të menduarit kritik</b>				
		<b>9.1.6.</b> Zbaton rregullisht strategjitë e kultivimit të nxënësit të aftësisë së të menduarit kritik (të menduarit analitik).				
		<b>9.1.7.</b> Nxënësit i gjykojnë idetë, dukuritë e ngjarjet nga këndvështrime të ndryshme.				
		<b>9.1.8.</b> Nxit frymën e debatit mes nxënësve.				
		<b>9.1.9.</b> U kërkon rregullisht nxënësve të argumentojnë mjaftueshëm përgjigjet e tyre.				
		<b>9.1.10.</b> Nxit nxënësit t’i drejtojnë pyetje.				
		<b>9.1.11.</b> Nxit nxënësit t’i drejtojnë pyetje njëri-tjetrit, ndërsa parashtrajnë zgjidhjet ose interpretimet e tyre.				
<b>Aftësia e të menduarit krijues</b>						
<b>9.1.12.</b> Zbaton rregullisht strategjitë e kultivimit të nxënësit të aftësisë së të menduarit krijues.						
<b>9.1.13.</b> I nxit nxënësit që për një kërkesë të gjejnë jo vetëm një zgjidhje.						

10) Përdor botimet në ndihmë të mësuesit, botime shkencore, shfrytëzon internetin, bisedon me specialistë që kanë të bëjnë me aspekte të përmbajtjes lëndore etj.

	<b>9.1.14.</b> U shtron rregullisht nxënësve kërkesa që kanë disa përgjigje të mundshme.				
	<b>9.1.15.</b> U krijon rregullisht nxënësve mundësinë të përballen me kërkesa që përmbajnë sfida të papritura.				
	<b>9.1.16.</b> U shtron rregullisht nxënësve kërkesa ku nevojitet gjykimi, opinioni a interpretimi vetjak.				
	<b>9.1.17.</b> Demonstron entuziazëm ndaj krijimtarive të nxënësve.				
	<b>Aftësia e punës së pavarur individuale dhe në grupe të vogla nxënësish</b>				
	<b>9.1.18.</b> Mësuesi është i aftë të organizojë punë produktive me grupe të vogla nxënësish brenda në klasë.				
	<b>9.1.19.</b> Gjatë orës mësimore, mësuesi organizon herë pas here punë në grupe të vogla nxënësish, duke filluar nga grupi i nxënësve të një banke/tryeze.				
	<b>9.1.20.</b> Zbaton strategjitë dhe metodat e aftësimit të nxënësve për punë të pavarur individuale brenda në klasë.				
	<b>9.1.21.</b> Është i aftë të përzgjedhë, sipas dobisë për nxënësit, midis punës individuale të nxënësve, punës së tyre me grupe të vogla dhe punës me të gjithë klasën.				
	<b>Aftësia e zgjidhjes së situatave problemore</b>				
	<b>9.1.22.</b> Mësuesi shtron rregullisht kërkesa, për të cilat nevojitet të zbatohen aspekte të teorisë së zgjidhjes së situatave problemore.				
	<b>9.1.23.</b> Mësuesi shtron rregullisht kërkesa, në të cilat zbatohen metoda të ndryshme të analizës së të dhënave sipas teorisë së zgjidhjes së situatave problemore.				
	<b>9.1.24.</b> Mësuesi shtron rregullisht kërkesa, në të cilat zbatohen metoda të ndryshme të hartimit të planit të zgjidhjes sipas teorisë së zgjidhjes së situatave problemore.				
	<b>9.1.25.</b> Mësuesi shtron rregullisht kërkesa, në të cilat përdoren metoda të ndryshme të zbatimit të planit të zgjidhjes sipas teorisë së zgjidhjes së situatave problemore.				
	<b>9.1.26.</b> Mësuesi shtron rregullisht kërkesa, në të cilat zbatohen metoda të ndryshme të vlerësimit të zgjidhjes sipas teorisë së zgjidhjes së situatave problemore.				

<b>Aftësia e qëndrimit etiko-social</b>				
9.1.27. Mësuesi i jep mundësinë secilit nxënës të ushtrohet që të mbajë qëndrim etik aktiv ndaj ngjarjeve, dukurive, pikëpamjeve e sjelljeve në klasë, shkollë dhe shoqëri.				
<b>Temat ndërkurrikulare</b>				
9.1.28. Mësuesi zhvillon temat ndërkurrikulare në lëndën e tij.				
<b>Aftësia e komunikimit në gjuhën shqipe</b>				
9.1.29. Mësuesi komunikon qartë, saktë dhe kuptueshëm me nxënësit, me një fjalor të pasur, me fjali të mirëstrukturuara dhe duke respektuar drejtshkrimin dhe drejtshqiptimin e gjuhës standarde.				
9.1.30. Qorton vazhdimisht sprovat me shkrim të nxënësve për nga saktësia e drejtshkrimit, fjalori i përdorur, struktura e fjalive dhe e shtjellimit.				
9.1.31. Qorton vazhdimisht përgjigjet me gojë të nxënësve për nga saktësia e drejtshqiptimit, fjalori i përdorur, struktura e fjalive dhe e shtjellimit.				
<b>Aftësia e përdorimit të matematikës</b>				
9.1.32. U jep mundësinë nxënësve të përdorin gjatë orës mësimore njohuritë matematike të nxëna në shkollë, për përvetësimin më të thellë të lëndës.				
9.1.33. Në detyrat e shtëpisë ka, herë pas here, kërkesa ku përdoret matematika.				
9.1.34. Në provimet me shkrim ka, herë pas here, kërkesa ku përdoret matematika				
9.1.35. Në projektet kurrikulare përdoret herë pas here matematika.				
<b>Aftësia e përdorimit të TIK-ut</b>				
9.1.36. U jep mundësinë nxënësve të përdorin gjatë orës mësimore njohuritë e TIK-ut të nxëna në shkollë, për përvetësimin më të thellë të lëndës.				
9.1.37. Në detyrat e shtëpisë ka, herë pas here, kërkesa ku përdoret TIK-u.				
9.1.38. Në provimet me shkrim ka, herë pas here, kërkesa ku përdoret TIK-u.				
9.1.39. Në projektet kurrikulare përdoret TIK-u.				

Nënfusha <sup>10</sup>	Treguesit	Instrumente	Nivelet e vlerësimit			
			1	2	3	4
Përsëritja	1. Mësuesi realizon një përsëritje efektive me në qendër nxënësin.	10.1.1. Mësuesi planifikon dhe realizon orë të përsëritjes së kapitujve.				
		10.1.2. Gjatë përsëritjes së një kapitulli, mësuesi ka parësore përvetësimin e thellë të koncepteve kryesore të kapitullit dhe zbulimin e lidhjeve mes tyre.				
		10.1.3. Gjatë përsëritjes së një kapitulli, mësuesi përqendron nxënësit në zbulimin prej tyre të lidhjeve të koncepteve të kapitullit me ato të kapitujve paraardhës të lëndës së asaj klase.				
		10.1.4. Gjatë përsëritjes së një kapitulli, mësuesi përqendron nxënësit në zbulimin prej tyre të lidhjeve të koncepteve të kapitullit me ato të lëndës në klasat paraardhëse.				
		10.1.5. Gjatë përsëritjes të një kapitulli, mësuesi përqendron nxënësit në zbulimin prej tyre të lidhjeve të koncepteve të kapitullit me ato të lëndëve të tjera.				
		10.1.6. Gjatë përsëritjes nxënësit marrin pjesë aktivisht në mënyrë të pavarur individuale dhe në grupe të vogla.				
		10.1.7. Mësuesi përdor metoda <sup>11</sup> të larmishme për një përsëritje cilësore.				
		10.1.8. Drejtori i shkollës zhvillon një provim vjetor <sup>12</sup> me shkrim në disa klasa për disa lëndë/module.				

11) Para orës (orëve) mësimore të përsëritjes dhe pas tyre u jep nxënësve individualisht a në grupe pune detyra shtëpie deri në detyra tematike ku nxënësit shfletojnë kapitullin, kapitujt paraardhës të asaj lënde dhe të lëndëve të tjera; ndërtimi i hartës së koncepteve të kapitullit etj.

12) Për këto provime, klasat duhet të përzgjidhen me short. Numri i provimeve nuk është më i vogël se 5% e numrit të lëndëve/moduleve për të gjitha paralelet e gjimnazit. Këtij provimi vjetor i nënshtrohen jo vetëm lëndët bërthamë, por edhe ato me zgjedhje të detyruar dhe të lirë.

Nënfusha11	Treguesit	Instrumente	Nivelet e vlerësimit			
			1	2	3	4
<b>Mjedisi i sigurtë për të nxënë</b>	1. Klima pozitive dhe besimi janë elemente të natyrshme të procesit mësimor.	<b>11.1.1.</b> Nxënësit ndihen të lirshëm për të shprehur idetë, mendimet dhe zgjidhjet e tyre.				
		<b>11.1.2.</b> Secili nxënës ndihet i sigurtë për të shprehur atë që mendon dhe mëson.				
		<b>11.1.3.</b> Secili nxënës është i lirë të lëvizë në klasë për nevojat e tij mësimore.				
		<b>11.1.4.</b> Mësuesi nuk qorton nxënësin para klasës.				
		<b>11.1.5.</b> Mësuesi nuk lavdëron para klasës në mënyrë të përsëritur nxënës të veçantë.				
		<b>11.1.6.</b> Mësuesi nuk mban qëndrim negativ ndaj gabimeve të nxënësve dhe favorizon diskutimet mes tyre për të gjetur përgjigjen e duhur.				
		<b>11.1.7.</b> Klima, që sundon në klasë, është pozitive dhe optimiste.				
		<b>11.1.8.</b> Mësuesi krijon në klasë një atmosferë të nxëni me emocione të këndshme.				
		<b>11.1.9.</b> Mësuesi shfaq entuziazëm te nxënësit për lëndën e tij.				
		<b>11.1.10.</b> Komunikimi mësues-nxënës dhe nxënës-nxënës është bashkëpunues, jo diskriminues për grupe të ndryshme nxënësish në klasë.				
		<b>11.1.11.</b> Konfliktet në klasë zgjidhen në mënyrë konstruktive dhe paqësore (mësues-nxënës, nxënës-nxënës).				
		<b>11.1.12.</b> Mësuesi nuk përdor dhunë verbale dhe fizike në klasë.				
		<b>11.1.13.</b> Mësuesi nuk paragjykon përgjigjet e nxënësve.				
		<b>11.1.14.</b> Mënyrat e vlerësimit që përdor mësuesi në klasë, motivojnë siguri për të nxënit.				
		<b>11.1.15.</b> Mësuesi dhe nxënësit zbatojnë në klasë rregulla të njohura më parë nga ata.				
		<b>11.1.16.</b> Zhurma që krijohet në klasë konsiderohet "zhurmë pune", normale për një komunikim që fokusohet në bashkëpunimin e punës në ekipe të vogla.				



Nënfusha <sup>12</sup>	Treguesit	Instrumente	Nivelet e vlerësimit			
			1	2	3	4
<b>Fëmijët me nevoja të veçanta</b>	1. Procesi mësimor mbështet fëmijët me nevoja të veçanta.	<b>12.1.1.</b> Mësuesi ka identifikuar nxënësit me nevoja të veçanta.				
		<b>12.1.2.</b> Mësuesi harton dhe zbaton programe mësimore të personalizuara për nxënës me aftësi të kufizuara dhe për nxënës me nevoja tejet të veçanta <sup>13</sup> .				
		<b>12.1.3.</b> Mësuesi përshtat mësimin sipas niveleve të të nxënësve.				
		<b>12.1.4.</b> Materialet mësimore që janë përzgjedhur për fëmijët me nevoja të veçanta, janë të përshtatshme për ta.				
		<b>12.1.5.</b> Kërkesat dhe detyrat që kryejnë fëmijët me nevoja të veçanta, janë në përputhje me aftësitë e tyre.				
		<b>12.1.6.</b> Mësuesi i lehtëson fëmijët me nevoja të veçanta gjatë procesit të nxënies.				
		<b>12.1.7.</b> Nxënësit me nevoja të veçanta mbështeten edhe nga nxënësit e tjerë.				
		<b>12.1.8.</b> Mësuesi bën komente dhe lavdërime për produktet dhe arritjet e fëmijëve me nevoja të veçanta.				
		<b>12.1.9.</b> Mësuesi jep detyra shtëpie përkatëse për fëmijët me nevoja të veçanta.				

---

13) Nxënës me nevoja tejet të veçanta nënkupton fëmijë të ardhur rishtas nga emigracioni, ata që kanë munguar për arsye shëndetësore etj.

Nënfusha13	Treguesit	Instrumente	Nivelet e vlerësimit			
			1	2	3	4
Vlerësimi	1. Vlerësimi i nxënësve është real dhe nxitës.	<b>13.1.1.</b> Mësuesi bën vlerësime të ndryshme, si: me fjalë, me komente, me notë, me shënime për produkte dhe veprimtari të ndryshme.				
		<b>13.1.2.</b> Mësuesi e bën vlerësimin, duke u bazuar tek objektivat e përcaktuara në planifikimin mësimor.				
		<b>13.1.3.</b> Mësuesi dhe nxënësit janë të qartë për peshën dhe rëndësinë që ka vlerësimi me gojë, vlerësimi i provimeve, i projekteve kurrikulare dhe i produkteve të ndryshme.				
		<b>13.1.4.</b> Vlerësimi i bërë nga mësuesi shërben si shtysë dhe nxitje për të nxënë.				
		<b>13.1.5.</b> Vlerësimi që bën mësuesi është real dhe në përputhje me arritjet e nxënësit sipas objektivave mësimorë.				
		<b>13.1.6.</b> Punimet/produktet më të mira të nxënësve shpallen para klasës ose në vende të posaçme të saj.				
		<b>13.1.7.</b> Mësuesi vlerëson me notë grupe të ndryshme nxënësish.				
		<b>13.1.8.</b> Mësuesi përdor një fletore të veçantë për vlerësimin e nxënësve.				
		<b>13.1.9.</b> Mësuesi dhe nxënësit bëjnë një përmbledhje të veprimtarive mësimore dhe arritjeve të tyre, në fund të orës mësimore.				

## **STANDARDI**

Mësuesi përgatit në mënyrë sistematike planin ditor, duke respektuar rekomandimet e udhëzuesve zyrtarë të MASH-it. Plani ditor është rrjedhojë organike e kërkesave që synon kurrikula lëndore përmes objektivave të saj. Mësuesi mbështetet thellësisht te parimet e të nxëniet që sugjeron kurrikula zyrtare dhe tek objektivat lëndorë. Ai zgjedh metoda, teknika mësimore të frytshme për tematikën e mësimit dhe siguron një bazë materiale e didaktike të nevojshme dhe të përshtatshme. Mësuesi e zhvillon vlerësimin e nxënësve jo vetëm si matje, por edhe si një proces nxitës gjatë gjithë mësimit. Procesi mësimor reflekton optimizëm, besim, siguri dhe larmi stileshe të nxëni. Mësuesi e organizon punën në klasë duke marrë parasysh specifikat e nxënësve. Ai ndërton marrëdhënie të qarta me ta duke gjeneruar qartësi shpjegimi dhe respektim të diversitetit të tyre. Nga ana tjetër, ai përpiket të kultivojë tek nxënësit aftësitë ndërkurrikulare. Ana shkencore e mësuesit është e një niveli të lartë. Mbështetja dhe lehtësimi i të nxëniet identifikohet qartë në mësim, pasi ky proces mbështetet në punën individuale dhe me ekipe. Planifikimi dhe zbatimi i planit ditor përmbushin më së miri synimet dhe objektivat e kurrikulës zyrtare.

### **NIVELI 1**

Mësuesi paraqet në planin ditor objektivat e arritjeve për tri nivele, të lidhura ngushtë me njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet që synohen në fund të orës mësimore.

Objektivat e arritjeve janë në përputhje me kërkesat e programit lëndor (standardeve). Metodat e përzgjedhura ndihmojnë nxënësit për arritjen e objektivave mësimore. Mësuesi diskuton me nxënësit qëllimet e veprimtarive që do të kryejnë dhe u jep shpjegimet e duhura për t'u lehtësuar procesin. Shpjegimet, ekspozimet, udhëzimet e mësuesve janë kurdoherë të qarta, të zgjedhura me kujdes dhe në përshtatje me nivelin e njohurive. Mësuesit bashkëveprojnë efektivisht me të gjithë klasën, grupet e nxënësve dhe individët. Diskutimet e mësuesit me nxënësit nxitin të menduarit krijues e kritik dhe krijojnë besim tek këta të fundit. Kur ndeshen vështirësi në të nxënë, bëhen përpjekje për të identifikuar dhe ndrequr gabimet. Mjedisi fizik i klasës është në përputhje me modelet mësimore të përzgjedhura (vendosja e bankave, paraqitja e mjeteve dhe e materialeve mësimore). Mësuesi përpiket të kultivojë te nxënësit aftësi ndërkurrikulare. Ana shkencore e tij është e mirë. Mësuesi dhe nxënësit janë të familjarizuar me përdorimin e saktë të mjeteve didaktike. Në klasë është krijuar një mjedis mësimor i tillë që inkurajon nxënësit të kryejnë punë me cilësi të lartë. Lavdërimi përdoret me efektivitet, për të inkurajuar dhe për të ndërtuar besimin te nxënësit. Nxënësit janë të motivuar për të punuar mirë dhe me entuziazëm.

Detyrat e shtëpisë janë kurdoherë të planifikuara mirë dhe synojnë në vazhdimësi rritjen e nivelit të nxënësit dhe lehtësojnë nxënien, sidomos për fëmijët me nevoja të veçanta..

Metodat e vlerësimit janë përcaktuar në përputhje me objektivat mësimore.

## NIVELI 2

Pasqyrimet në ditar japin ide të qarta për konceptimin e orës së mësimi. Objektivat e arritjeve për orën e mësimi, *përgjithësisht*, formulohen drejt. Metodatat e përdorura janë të larmishme dhe *përgjithësisht* mbajnë parasysh gjendjen e klasës dhe veçoritë e lëndës. Në përgjithësi shpjegimet, demonstrimet e mësuesit janë të qarta dhe të kuptueshme, por nuk diskutohen gjithnjë qëllimet e veprimtarive që nxënësit do të realizojnë. Mësuesit përpigën të bashkëveprojnë me efektivitet me të gjithë klasën, grupet dhe individët. Diskutimet e përbashkëta, mësues-nxënës, nxitin të mësuarit. Ka përpjekje të mira edhe për të nxitur kontributet e nxënësve, të cilat në përgjithësi vlerësohen. Duket se mësuesi njeh teknikat e të pyeturit dhe përgjithësisht i përdor ato. Përgjigjet e nxënësve dëgjohen me kujdes dhe vlerësohen me efektivitet. Përfshirja e nxënësve është e kënaqshme dhe bëhen përpjekje të mira për të identifikuar gabimet edhe për t'i riparuar ato.

Mjedisi fizik i klasës është në funksion të metodave të përzgjedhura (vendosja e bankave, paraqitja e mjeteve dhe materialeve mësimore). Mësuesi ka një formim të mirë shkencor, por ai nuk merr në konsideratë siç duhet trajtimin e situatave ndërkurrikulare.

Ka përpjekje për krijimin e mjedisit mësimor inkurajues që nxënësit të bëjnë punë me cilësi. Nxënësit *përgjithësisht* motivohen për arritjet e rezultateve të kërkuara. Mendimi i pavarur i nxënësve nuk nxitet në mënyrë të vijueshme dhe reflektimi i tyre ndaj ideve është rastësor. Nxënësit punojnë në grupe, por ata ende nuk kanë një fizionomi të kristalizuar mirë për rolet e tyre në grup.

Detyrat e dhëna në klasë dhe detyrat e shtëpisë janë në përgjithësi të planifikuara mirë dhe synojnë në vazhdimësi rritjen e niveleve të nxënësve.

Metodat e vlerësimit hartohen në përputhje me qëllimet e përcaktuara. Ka përpjekje për një spektër të gjerë dhe të përshtatshëm metodash vlerësimi, formale dhe joformale, për të bërë gjykime rreth progresit të nxënësit. Në *përgjithësi* mbahen parasysh objektivat dhe dokumentimi i vlerësimit është i rregullt.

## NIVELI 3

Shënimet në ditar pasqyrojnë strukturën e saktë, por nuk planifikojnë veprimtaritë mësimore, të detajuara për procesin e mësimdhënies. Objektivat e orës së mësimi nuk formulohen gjithnjë qartë dhe saktë. Janë bërë përpjekje për të hartuar objektivat e arritjeve (tri nivele), detyrat, veprimtaritë, por metodatat e mësimdhënies dhe të të nxënësit nuk janë të atilla që të ndihmojnë nxënësin për arritjen e objektivave mësimore. Ka një farë variacioni në metodatat e mësimdhënies, por shkalla e saj është e kufizuar dhe aktivizimi i nxënësit lë për të dëshiruar. Mësuesi nuk merr në konsideratë trajtimin e situatave ndërkurrikulare dhe ka raste të pasaktësive shkencore.

Metoda dhe teknikat nuk janë gjithnjë të përshtatshme me realizimin e objektivave të përcaktuara. Shpjegimet, udhëzimet e mësuesve shpesh kërkojnë qartësime të mëtejshme. Mësuesit në *përgjithësi* nuk ua

sqarojnë nxënësve qëllimin e veprimtarive që do të kryejnë. Mësuesi bashkëvepron herë pas here me të gjithë klasën, grupet dhe individët, por cilësia e dialogut mësues- nxënës në *përgjithësi* nuk nxit të mësuarit efektiv. Ka dobësi të tilla, si: mosdëshirë për të vlerësuar kontributet e nxënësve, shumica e pyetjeve që u drejtohen nxënësve kërkojnë prej tyre informacion faktesh, ka mungesë drejtimi dhe kontrolli për përgjigjet e nxënësve, si dhe pamjaftueshmëri për njohjen e vështirësive të të mësuarit. Ritmi i të mësuarit ose është shumë i ulët ose tepër i shpejtë dhe pengon nxënësin në arritjen e objektivave mësimore.

Mjedisi fizik i klasës nuk është përshtatur në funksion të modeleve të ndryshme mësimore (vendosja e bankave, paraqitja e mjeteve dhe materialeve mësimore).

Vetëm mësuesi përdor bazë materiale të rastësishme, në varësi të veprimtarive mësimore. Janë rastësore përpjekjet për të inkurajuar punën e mirë dhe për të përmirësuar motivimin e nxënësve. Nxënësit rrallë marrin përgjegjësi për të mësuarit e tyre. Ata nuk janë sistematikë dhe nuk punojnë mirë kur nuk janë nën kontroll të drejtpërdrejtë. Ata kryejnë atë që u kërkon mësuesi, por janë pjesëmarrës pasivë në proces, e si rrjedhojë, të shpërqendruar në mësim. Nxënësit punojnë rrallë në grupe. Tërësia e veprimtarive përputhet rastësisht me interesat dhe prirjet e nxënësve. Edhe pse jepen detyra shtëpie, ato nuk janë të studiuara si duhet, nuk janë të përzgjedhura për fëmijët me nevoja të veçanta. Qortimi i tyre është më shumë sporadik e nuk ndikon në orën pasardhëse. Nxënësit i përgjigjen me ndërjegje detyrave që u jep mësuesi, por puna e klasës është e karakterizuar nga mungesa e entuziazmit dhe nxënësit kanë pak mundësi për të ushtruar iniciativën.

Përdoret një shkallë e kufizuar metodash e procedurash vlerësimi dhe këto nuk janë kurdoherë të përshtatshme për vlerësimin e progresit drejt objektivave të kurrikulës. Informacioni i regjistruar është i papërshtatshëm dhe jo shumë i dobishëm.

#### **NIVELI 4**

Nuk ka asnjë përpjekje për të hartuar objektiva arritjeje me tri nivelet dhe për të planifikuar metodologji efektive në përgatitjen ditore të mësuesit. Objektivat e arritjeve nuk janë në përputhje me kërkesat e programit lëndor (standardeve) dhe metodat e punës nuk ndihmojnë nxënësit për arritjen e objektivave mësimore. Mësimdhënia është tepër monotone. Në shpjegimet dhe udhëzimet e mësuesve mungon qartësia e duhur. Nxënësve nuk u sqarohet paraprakisht se për çfarë do të punojnë. Mësuesi dhe nxënësit nuk japin një "feedback" për shkallën e arritjes së objektivave mësimore të vendosura. Ritmi i të mësuarit është shumë i ulët dhe tërësia e veprimtarive nuk përputhet me interesat e prirjet e nxënësve. Përgjithësisht nuk bashkëveprohet me grupe nxënësish dhe aktivizimi i individëve është i rastit dhe sporadik, pa një plan të menduar e perspektiv. Informacioni që vjen nga përgjigjet e nxënësve nuk përdoret me efektivitet për të ndërtuar mësimin. Mësuesi nuk bën asnjë përpjekje për të identifikuar dhe ndrequr gabimin që sjell vështirësi në realizimin e veprimtarive.

Mjedisi fizik i klasës nuk mundëson përdorimin lehtësisht të modeleve të ndryshme mësimore (vendosja

e bankave, paraqitja e mjeteve dhe materialeve mësimore). Nxënësit nuk kanë mjetet më të domosdoshme individuale për pjesëmarrje ndërvepruese në procesin mësimor.

Mungojnë përpjekjet për krijimin e një klime pozitive në klasë. Nxënësit nuk u përgjigjen me dëshirë kërkesave të mësuesit, shpesh u mungon inisiativa. Mësuesi vlerëson rrallë përpjekjet dhe arritjet e nxënësve, bën vlerësim, kryesisht, kur vendos notë.

Mungon motivimi i nxënësve për punë. Ata janë pasivë dhe thjesht riprodhues të njohurive që mësojnë. Nuk nxitet aktivizimi i tyre dhe as pavarësia e mendimit. Puna në grup është e panjohur për ta. Mësuesi nuk ka identifikuar nxënësit me nevoja të veçanta.

Detyrat e shtëpisë jepen rrallë dhe në mënyrë të pastudiuar. Detyrat e dhëna në klasë nuk synojnë nivele më të larta të formimit të nxënësit dhe lehtësim, sidomos për fëmijët me nevoja të veçanta. Ato nuk korrigjohen ose korrigjohen rastësisht dhe përciptazi.

Vlerësimi është rastësor dhe i pamjaftueshëm në planin sasior dhe i pasistemuar. Informacioni i grumbulluar është jo vetëm i pamjaftueshëm, por edhe i pavlefshëm për të përgjithësuar rezultatet e nxënësve.

### **FUSHA III. KLIMA DHE ETIKA NË SHKOLLË**

*Klima e shkollës* është një koncept shumë i gjerë që përfshin dimensionet fizike, psiko-sociale dhe të të nxënësit. Ajo përshkruan mjedisin që ndikon tek sjellja e mësuesve dhe e nxënësve, përfshin opinionet dhe besimet që ekzistojnë dhe karakterizojnë shkollën. Klima e shkollës i referohet organizimit në nivel shkollë dhe klase, i referohet "ndjesisë" së një shkollë dhe është e ndryshme nga njëra shkollë në tjetrën.

Shkolla luan një rol thelbësor në krijimin e klimës së saj. Ajo kujdeset për një klimë të mirë shkollë që karakterizohet nga një ekuilibër midis mbështetjes dhe nxitjes. Mbështetja nënkupton krijimin e një mjedisi të pastër, motivues dhe të sigurt brenda dhe jashtë klasave. Mësuesit tregojnë respekt ndaj nxënësve dhe nuk merren me dallimet individuale të nxënësve. Ata kujdesen që nxënësit të kuptojnë vlerën dhe respektin reciprok dhe e vënë theksin në sjelljet dhe qëndrimet e tyre pozitive.

Klima e shkollës reflekton idetë e përbashkëta, vlerat, vizionin dhe besimin, të cilat i japin shkollës identitetin dhe standardet për sjelljen e pritshme. Klima reflektohet në atmosferën e shkollës dhe kodin moral.

Klima në shkollë reflekton aspekte fizike dhe psikologjike që janë të ndryshme ndaj ndryshimit dhe sigurojnë parakushtet e nevojshme për zhvillimin e mësimdhënies dhe të të nxënësit.

Mjedisin fizik dhe psiko-social nuk veprojnë në mënyrë të pavarur nga njëri-tjetri. Një mjedis i mirë fizik nxit ndërveprimin social dhe anasjelltas, ndërveprimi social krijon një ambient të ngrohtë dhe afektiv.

Një mjedis fizik mikpritës dhe me synim të mësuarit është një nga elementet më të rëndësishme për zhvillimin e një sistemi arsimor me cilësi dhe barazi.

**Etika** përfshin artikullimin e sjelljeve të mira dhe të zakonave që profesionistët e arsimit kërkojnë, detyrat që ata duhet të ndjekin dhe rrjedhojat e mëvonshme të sjelljeve të tyre. Etika nënkupton të vepruarit në një mënyrë që tregon respekt për dinjitetin njerëzor dhe siguron një shërbim profesional të një cilësie të lartë. Nëse respektohet siç duhet kodi etik, cilësia e shërbimit në fushën e arsimit do të rritet ndjeshëm.

Ajo tenton të parandalojë sjellje që janë kundër normave etiko-morale dhe shërben si mjet mbrojtës për mësuesit-nxënësit-drejtuesit-komunitetin.

Kodi i etikës është një dokument i bazuar në tri vlera:

Ë integriteti profesional dhe personal,

Ë respekti,

Ë përgjegjshmëria.

*Si ndikon klima dhe etika në performancën e shkollës?*

Klima në shkollë është një element i rëndësishëm që ndikon në përmirësimin e performancës akademike dhe reformave të shkollës. Një klimë pozitive, e qëndrueshme në shkollë nxit zhvillimin e të rinjve dhe nevojën e të mësuarit për një jetë produktive dhe të kënaqshme në një shoqëri demokratike.

Një klimë e mirë në shkollë ndikon në arritjen e rezultateve të larta dhe të një shëndeti të mirë psiko-social. Ajo ndikon në rritjen e vetëvlerësimit, uljen e ankthit, depresionit të fëmijës dhe abuzimit me substancat alkoolike dhe narkotike, devijancat, uljen e mungesave dhe braktisjen e shkollës.

Mësuesit duhet të edukojnë nxënësit me virtyte qytetarie, si: integritet, zell, përgjegjshmëri, bashkëveprim, besnikëri dhe respekt për njerëzit, ligjin, për të tjerët dhe vetveten. Një klimë pozitive në shkollë siguron një mjedis të përshtatshëm për rritje personale dhe sukses akademik njëkohësisht.

### **Përshkrimi i nënfushave**

**Mjedisi fizik.** Një gjendje fizike e mirë e shkollës përfshin një ambient të pastër, të mirëmbajtur, tërheqës dhe motivues. Ai ka një efekt nxitës për të gjithë aktorët e përfshirë në procesin e mësimdhënies dhe të nxënies. Shkolla duhet të krijojë kushtet e nevojshme që mësuesit dhe nxënësit të punojnë me efikasitet. Kjo do të thotë që klasat të kenë kushte dhe pajisje shkollore të përshtatshme dhe funksionale, si: laboratorë, kabinete, palestra dhe hapësira të tjera. Shkolla duhet të sigurojë kushte të nevojshme që mësuesit të punojnë edhe gjatë kohës që nuk kanë mësim. Aspekte të tjera të rëndësishme të mjedisit fizik janë: siguria në shkollë, cilësia e ajrit, raporti hapësirë-nxënës, ndriçimi, ngrohja etj.

**Mjedisi psiko-social.** Stafit dhe nxënësit ndihen krenarë për shkollën e tyre ku promovohen vlera, si: ndershmëri, barazi dhe qytetari. Mjedisi është kurdoherë mikpritës dhe atmosfera pozitive është karakteristike

e shkollës. Puna e mësuesve në klasë shërben si bazë për të krijuar një klimë pozitive dhe mbështetëse. Parandalimi i diskriminimit është një aspekt i rëndësishëm i punës me nxënësit. Ata duhet të pranohen ashtu siç janë, duke respektuar prejardhjen e tyre. Disiplina në shkollë dhe në klasë është një tjetër faktor shumë i rëndësishëm. Ajo kërkon zbatimin e rregullores së brendshme të shkollës, të rregullave dhe kodit të sjelljes. Motivimi i nxënësve, mësuesve dhe prindërve prek të gjitha aspektet e jetës në shkollë. Nxënësit, mësuesit dhe prindërit nëpërmjet vendimmartjes kontribuojnë në zhvillimin pozitiv të shkollës.

**Mjedisi i të nxënësve.** Për arritjen e objektivave, detyrat, veprimtaritë mësimore, edukative zgjidhen në përshtatje me nevojat dhe prirjet e nxënësve. Në përputhje me kërkesat e programit, ritmi i të mësuarit ndihmon nxënësit në arritjen e objektivave dhe veprimtaria mësimore-edukative mban parasysht edhe interesat e zhvillimit të nxënësve.

Disa nxënës kanë nevojë për mbështetje dhe trajtim të veçantë sipas nevojave të tyre specifike. Shkolla duhet të njohë nevojat që ata kanë, të qartësojë natyrën e problemit dhe të ndërtojë një plan pune me objektiva dhe burime të nevojshme për realizimin e tyre. Komunikimi, bashkëpunimi dhe konfidencialiteti janë aspekte të rëndësishme që sigurojnë një klimë të mirë shkollë, e cila reflektohet në marrëdhëniet midis mësuesve dhe nxënësve gjatë situatave mësimore, si dhe midis stafit të shkollës dhe nxënësve jashtë mësimit. Midis nxënësve, mësuesve dhe drejtuesve të shkollës mbizotëron në çdo moment frymë bashkëpunimi dhe respekti reciprok. Nxënësit dhe mësuesit ndihmojnë dhe mbështesin njëri-tjetrin.

**Lidhja e shkollës me prindërit dhe komunitetin.** Është shumë e rëndësishme për shkollën që prindërit të kenë një përshtypje sa më të mirë dhe të ndihen të përfshirë në jetën e shkollës. Ajo duhet të bëjë maksimumin në përfshirjen e prindërve në shkollë nëpërmjet informacionit që u jep në takimet me prindërit. Prindërit informohen në mënyrë të qartë për të gjithë punën e shkollës dhe ecurinë e fëmijëve të tyre.

Shkolla gjithashtu kontribuon efektivisht në jetën e komunitetit dhe punon me të duke marrë pjesë në ngjarje e veprimtari lokale. Ajo realizon veprimtari në të cilat merr pjesë edhe komuniteti. Kur është e nevojshme, shkolla realizon veprimtari për të aftësuar anëtarët e komunitet për t'u angazhuar në punët e tyre.

**Lidhja e shkollës me institucionet e tjera, grupet e interesit dhe OJF-të.** Një shkollë, sado e mirë, nuk mund të zhvillohet e të rritet cilësisht në vijimësi duke mbetur brenda mureve të veta. Shkolla vendos lidhje me shkollat e tjera, institucionet arsimore, pushtetin vendor, grupe të tjera të interesit, si dhe me OJF-të, me qëllim përmirësimin e cilësisë së punës së saj, duke realizuar shkëmbimin e informacionit për nevojat e nxënësve. Kërkohet që shkolla të përdorë mirë përvojën e fituar nga ky bashkëpunim, në mënyrë që të përmirësojë cilësinë e saj.



Nënfusha1	Treguesit	Instrumente	Nivelet e vlerësimit			
			1	2	3	4
Mjedisi fizik	1. Shkolla mirëmban dhe kujdeset për higjienën në shkollë dhe klasa.	1.1.1. Shkolla pastrohet çdo ditë nga personeli mbështetës, por dhe mirëmbahet nga nxënësit dhe personeli i saj.				
		1.1.2. Shkolla ka dekorim tërheqës.				
		1.1.3. Klasat dhe mjediset e tjera kanë mjedis motivues për procesin mësimor.				
	2. Shkolla ka mjedis fizike të përshtatshme për zhvillimin e procesit mësimor.	1.2.1. Raporti nxënës-hapësirë është në përputhje me normat zyrtare të mjediseve fizike të shkollës.				
		1.2.2. Laboratorët, kabinetet e shkollës, palestra dhe hapësirat e tyre janë funksionale dhe në përputhje me normat zyrtare të mjediseve fizike të shkollës.				
		1.2.3. Cilësia e ndriçimit është brenda normave zyrtare për zhvillimin normal të procesit mësimor.				
		1.2.4. Shkolla siguron ngrohjen e mjediseve të saj.				
		1.2.5. Cilësia e ajrit në shkollë është brenda normave fizike dhe të përshtatshme për zhvillimin e procesit mësimor.				
		1.2.6. Shkolla ka mjedis të përshtatshme për tualetet e nxënësve dhe të personelit.				
	3. Shkolla zbaton udhëzimet zyrtare për numrin e nxënësve në klasa.	1.3.1. Është zbatuar ndarja territoriale e vendbanimit të nxënësve sipas miratimit të DAR/ZA-së.				
		1.3.2. Është zbatuar kriteri zyrtar për numrin e nxënësve në klasa.				
		1.3.3. Janë marrë parasysh nevojat e nxënësve në organizimin dhe krijimin e klasave.				
	4. Shkolla siguron mjedis të sigurt dhe të përshtatshme për nxënësit.	1.4.1. Nxënësit ndihen të sigurt në mjediset e shkollës.				
		1.4.2. Shkolla zbaton një plan edukativ me fokus veprimtaritë edukuese kundër dhunës dhe sjelljeve të rrezikshme.				

		<b>1.4.3.</b> Mjedisi i shkollës është në përputhje me standardet zyrtare për sigurinë fizike në shkollë (rrethimi i oborrit, kangjellat dhe gjerësia e shkallëve, shkallët e jashtme, fikëse zjarri, kutia e ndihmës së shpejtë).				
--	--	--	--	--	--	--

Nënfusha 2	Treguesit	Instrumente	Nivelet e vlerësimit			
			1	2	3	4
<b>Mjedisi psiko-social</b>	1. Shkolla ka krijuar identitetin dhe krenarinë e vet.	<b>2.1.1.</b> Shkolla ka hartuar edhe ekspozuar historikun e saj.				
		<b>2.1.2.</b> Shkolla ka këndin e krenarisë në vite.				
		<b>2.1.3.</b> Shkolla ka uniformën e saj				
		<b>2.1.4.</b> Nxënësit janë përfshirë në përzgjedhjen e uniformës që mbajnë.				
		<b>2.1.5.</b> Mësuesit përdorin uniformë pune në shkollë.				
	2. Shkolla ka plan edukativ me fokus veprimtaritë edukuese kundër dhunës dhe sjelljeve të rrezikshme.	<b>2.2.1.</b> Shkolla harton një plan edukativ me fokus veprimtaritë edukuese kundër dhunës dhe sjelljeve të rrezikshme.				
		<b>2.2.2.</b> Shkolla zbaton një plan edukativ me fokus veprimtaritë edukuese kundër dhunës dhe sjelljeve të rrezikshme.				
	3. Shkolla respekton diversitetin e grupeve.	<b>2.3.1.</b> Mësuesi respekton diversitetin e nxënësve në shkollë (gjinia, mosha, raca, etnia, feja, inteligjencat).				
		<b>2.3.2.</b> Mësuesi nuk përdor stigmatizim dhe shenja diferencimi negativ në trajtimin e nxënësve.				
	4. Shkolla ka rregullore të brendshme.	<b>2.4.1.</b> Shkolla zbaton rregulloren e saj të brendshme, e cila është në përputhje me aktet ligjore zyrtare.				
		<b>2.4.2.</b> Nxënësit, mësuesit dhe prindërit janë përfshirë në hartimin e rregullores së shkollës.				
		<b>2.4.3.</b> Këshilli i disiplinës i shkollës është funksional në zbatimin e rregullores së shkollës.				
	5. Nxënësit, mësuesit, drejtuesit dhe prindërit kontribuojnë në	<b>2.5.1.</b> Nxënësit, mësuesit dhe prindërit marrin pjesë në vendimmarrjen e shkollës.				
		<b>2.5.2.</b> Qeveria e Nxënësve është funksionale.				

	vendimmarrjen e shkollës.	<b>2.5.3.</b> Bordi i Prindërve funksionon.				
		<b>2.5.4.</b> Bordi i Shkollës dhe komuniteti ndikojnë në krijimin e një klime pozitive.				
	6. Shkolla identifikon mendimin dhe perceptimin e nxënësve, mësuesve dhe prindërve për shkollën.	<b>2.6.1.</b> Shkolla përdor teknika të shumëllojshme për një vlerësim të përgjithshëm të progresit dhe perceptimit të saj nga komuniteti.				

Nënfusha 3	Treguesit	Instrumente	Nivelet e vlerësimit			
			1	2	3	4
<b>Mjedisi i të nxënit</b>	1. Mësuesi respekton të drejtat, dinjitetin, konfidencialitetin e nxënësve.	<b>3.1.1.</b> Mësuesit janë të mirëinformuar rreth të drejtave të nxënësve.				
		<b>3.1.2.</b> Mësuesit dhe drejtuesit respektojnë të drejtat e nxënësve.				
	2. Mësuesi përdor komunikim të frytshëm me nxënësit.	<b>3.2.1.</b> Shkolla ka një komunikim të mirë midis mësuesve dhe nxënësve.				
		<b>3.2.2.</b> Mësuesit mbajnë qëndrim pozitiv ndaj pikëpamjeve të ndryshme të nxënësve.				
		<b>3.2.3.</b> Mësuesit janë të aftë të menazhojnë dhe të zgjidhin konfliktet në shkollë.				
	3. Mësuesi krijon marrëdhënie bashkëpunimi dhe respekti me kolegët e tij.	<b>3.3.1.</b> Mësuesit bashkëpunojnë midis tyre për nevoja profesionale duke treguar respekt ndaj njëri-tjetrit.				
		<b>3.3.2.</b> Mësuesit mbështetin mendimet e njëri-tjetrit në ekipet kurrikulare.				
		<b>3.3.3.</b> Mësuesit arrijnë të zgjidhin mosmarrëveshjet që lindin midis tyre.				
	4. Mësuesi respekton të drejtat dhe konfidencialitetin e kolegëve.	<b>3.4.1.</b> Mësuesit respektojnë të drejtat dhe konfidencialitetin e kolegëve dhe të drejtuesve të shkollës.				

Nënfusha 4	Treguesit	Instrumente	Nivelet e vlerësimit			
			1	2	3	4
<b>Lidhja e shkollës me prindërit dhe komunitetin</b>	1. Mësuesi bashkëpunon me prindërit dhe komunitetin.	<b>4.1.1.</b> Prindërit janë të mirëpritur në shkollë.				
		<b>4.1.2.</b> Prindërit janë të përfshirë në hartimin e planit vjetor të shkollës.				
		<b>4.1.3.</b> Prindërit janë pjesëmarrës në veprimtari mësimore dhe edukative në shkollë.				
	2. Mësuesi mban kontakte të vazhdueshme me prindërit për ecurinë e nxënësve.	<b>4.2.1.</b> Shkolla përdor forma të ndryshme për të informuar prindërit.				
		<b>4.2.2.</b> Metodatat që përdor shkolla për të informuar prindërit janë të frytshme.				
	3. Shkolla respekton vlerat, traditat, kulturën e komunitetit.	<b>4.3.1.</b> Shkolla mbështet kulturën e komunitetit, vlerat dhe traditat e saj.				
		<b>4.3.2.</b> Shkolla kontribuon në ruajtjen e traditës dhe kulturës së komunitetit që i takon.				
		<b>4.3.3.</b> Shkolla informon komunitetin për synimet dhe arritjet e saj.				

Nënfusha 5	Treguesit	Instrumente	Nivelet e vlerësimit			
			1	2	3	4
<b>Lidhja e shkollës me institucionet e tjera, grupet e interesit dhe OJF-të</b>	1. Shkolla bashkëpunon me institucione shtetërore të marrëdhënieve horizontale dhe vertikale.	<b>5.1.1.</b> Shkolla bashkëpunon me shkollat e tjera.				
		<b>5.1.2.</b> Shkolla bashkëpunon me qeverisjen lokale.				
		<b>5.1.3.</b> Shkolla bashkëvepron me organet e prore.				
		<b>5.1.4.</b> Shkolla bashkëpunon me universitetet.				
	2. Shkolla bashkëpunon me OJF-të dhe institucionet e tjera që ndikojnë në realizimin e vizionit të saj.	<b>5.2.1.</b> Shkolla bashkëvepron me OJF-të dhe me institucionet e tjera që ndikojnë në zhvillimin e arsimit.				
		<b>5.2.2.</b> Shkolla përdor forma të ndryshme bashkëpunimi me institucionet që krijon lidhje.				

## **STANDARDI**

Stafi dhe nxënësit janë krenarë për shkollën e tyre, puna e së cilës frymëzohet nga sensi i ndershmërisë dhe barazia në mundësi. Standardet e sjelljes së stafit dhe të nxënësve janë të larta, duke krijuar respekt dhe duke ruajtur konfidencialitetin e informacionit profesional dhe personal. Në shkollë punohet me ndërgjegje dhe frymë bashkëpunimi. Marrëdhëniet mësues-nxënës janë shumë të mira.

Për arritjen e objektivave mësuesi përzgjedh metoda në përshtatje me nevojat dhe prirjet e nxënësve. Ai respekton prejardhjen e ndryshme të grupeve, të drejtat dhe dinjitetin e nxënësve.

Shkolla kujdeset që mjediset e saj fizike, të brendshme dhe të jashtme, të jenë të pastra, të sigurta dhe funksionale. Mjedisi është kurdoherë mikpritës dhe në shkollë mbizotëron atmosfera pozitive.

Prindërit përfshihen në jetën e shkollës dhe mbështetin fëmijët në procesin e të mësuarit. Pikëpamjet dhe idetë e tyre vlerësohen dhe merren në konsideratë. Drejtuesit e shkollës vendosin lidhje të qëndrueshme me Bordin e Shkollës. Nga bashkëpunimi gjenerohen përfitime që vlerësohen nga të gjithë aktorët.

Shkolla vendos lidhje me shkolla të tjera dhe institucione arsimore me qëllim përmirësimin e cilësisë së punës së saj. Shkolla kontribuon në jetën e komunitetit dhe bashkëpunon me të.

### **NIVELI 1**

Mësuesit, nxënësit, drejtuesit dhe prindërit bashkëpunojnë efektivisht mes tyre. Morali i nxënësve dhe i stafit pedagogjik është i lartë, pasi gjenden forma të përshtatshme për nxitjen dhe stimulimin e tyre. Mësuesit dhe nxënësit janë krenarë për shkollën e tyre. Puna në të gjitha nivelet ndërtohet e drejtohet nga barazia në mundësi dhe sensi i ndershmërisë.

Metodat e përdorura për mësimdhënien dhe të nxënësve ndihmojnë nxënësit për arritjen e objektivave mësimorë. Veprimtaritë edukative përputhen me interesat dhe prirjet e nxënësve. Shkolla i kushton rëndësi vlerave dhe formimit qytetar të nxënësve.

Në shkollë mbizotëron rregull dhe një mjedis i pastër, komod dhe estetik. Krijohen kushte optimale të punës e të veprimtarisë së mësuesve dhe nxënësve. Ajo ofron mjedise të sigurta, në funksion të mirëqenies dhe sigurisë së nxënësve. Shkolla inkurajon prindërit për të njohur dhe për t'u përfshirë në jetën e saj.

Shkolla ka krijuar lidhje të mira dhe efektive me shkollat dhe institucione të tjera arsimore. Ajo luan rol të rëndësishëm në jetën e komunitetit dhe punon me të, duke marrë pjesë në ngjarje dhe veprimtari lokale. Bashkëpunimi i frytshëm ndërmjet grupeve të interesit gjeneron përfitime thelbësore dhe vlerësohet prej të gjithëve.

## **NIVELI 2**

Marrëdhëniet e nxënësve dhe të mësuesve për problemet e shkollës janë të mira. Në përgjithësi, nxënësit dhe mësuesit e ndiejnë veten krenarë dhe bëjnë përpjekje për të lartësuar emrin e shkollës së tyre. Barazia në mundësi dhe sensi i ndershmërisë shoqëron vazhdimisht punën e nxënësve dhe të mësuesve. Metodat e përdorura për mësimdhënien dhe të nxënësve, përgjithësisht, ndihmojnë nxënësit për arritjen e objektivave mësimore. Tërësia e veprimtarive edukative, jo gjithmonë, përputhet me interesat dhe prirjet e nxënësve. Punohet herë pas here për edukimin dhe formimin e vlerave qytetare, të nxënësve.

Shkolla bën përpjekje të mira për të vendosur rregull e pastërti dhe për të ofruar ambiente të sigurta. Kushtet e punës janë në përgjithësi të mira, gjithashtu, dhe fryma e komunikimit dhe e bashkëpunimit është e tillë.

Prindërit, përgjithësisht, mbështetin jetën e shkollës dhe janë të përfshirë edhe në të mësuarit e fëmijëve të tyre në shtëpi. Shkolla ndërmer hapa për t'i përfshirë ata në veprimtaritë jashtëshkollore dhe jashtëkurrikulare. Lidhjet e drejtuesve të shkollës me Bordin dhe këshillin e prindërve janë të mira.

Shkolla ka krijuar lidhje të kënaqshme me shkollat dhe me institucione të tjera arsimore. Shkolla kontribuon në jetën e komunitetit dhe punon me të duke marrë pjesë herë pas here në ngjarje dhe veprimtari lokale.

## **NIVELI 3**

Marrëdhëniet e nxënësve me stafin pedagogjik nuk janë shumë efektive. Krenaria dhe sensi i identitetit janë në nivel të ulët. Sjellja dhe disiplina e nxënësve ka një numër të konsiderueshëm dobësish. Organizmat e shkollës funksionojnë mjaftueshëm për vendosjen e rregullit dhe disiplinës. Metodat e përdorura të mësimdhënies dhe të të nxënësve nuk janë të përshtatshme për arritjen e objektivave. Veprimtaritë edukative jo gjithmonë janë në përputhje me interesat dhe prirjet e nxënësve.

Rregulli dhe pastërtia në shkollë nuk janë në nivel të kënaqshëm. Mjediset e shkollës lënë për të dëshiruar. Shkolla nuk ofron siguri të mjaftueshme dhe nuk punohet sa duhet me veprimtaritë edukative, në funksion të formimit të vlerave dhe të qytetarisë së nxënësve. Lidhjet me Bordin e Shkollës dhe këshillin e mësuesve janë sporadike dhe jopërfituese. Metodat e përdorura nga shkolla për informimin dhe komunikimin me prindërit nuk janë shumë efektive. Shkolla nuk bashkëpunon sa duhet me prindërit dhe komunitetin. Informacioni që merret nga ana e prindërve është i kufizuar. Shkolla bashkëpunon rrallë me institucione të tjera arsimore. Kontributi i saj në jetën e komunitetit është i kufizuar.

#### **NIVELI 4**

Marrëdhëniet në shkollë midis nxënësve dhe stafit pedagogjik nuk janë harmonike. Nxënësit dhe mësuesit nuk janë shumë optimistë në punën e tyre. Lavdërimet dhe format e tjera të nxitjes e të motivimit përdoren shumë rrallë. Metodot e mësimdhënies dhe të të nxënësve ndihmojnë pak nxënësit për arritjen e objektivave. Tërësia e veprimtarive edukative nuk përfshin interesat dhe prirjet e të gjithë nxënësve. Mungon sensi i identitetit dhe i krenarisë së shkollës. Funksionimi jo i mirë i organizmave brenda shkollës ndikon në menazhimin jo të mirë të konflikteve dhe problemeve të sjelljes dhe disiplinës. Shkolla nuk ofron veprimtari edukative në funksion të mirëqenies dhe sigurisë së nxënësve. Mjedisi i punës nuk krijon kushte normale pune. Në të mungon rregulli dhe pastërtia. Atmosfera e shkollës është pak mikpritëse, stimuluese dhe pozitive. Shkolla bën përpjekje të pakta për aktivizimin e prindërve në jetën e saj. Bashkëpunimi me institucionet e tjera arsimore dhe grupet e interesit është i rrallë.

#### **FUSHA IV. KUJDESI PËR NXËNËSIT**

Kujdesi për nxënësit duhet të jetë një proces i vazhdueshëm i jetës së shkollës. Të kujdesesh për nxënësit do të thotë të krijosh marrëdhënie të shumëllojshme që lidhen jo vetëm me procesin e mësimdhënies dhe nxënies, por edhe me njohjen, identifikimin, mbështetjen, lehtësimin dhe sigurinë që i duhet ofruar çdo nxënësi në mjediset e shkollës. Ky proces lidhet ngushtë me aspekte fiziologjike, psikologjike, emocionale, fizike, shëndetësore, moshore, me prirjet dhe talentin, me vështirësitë fizike mendore dhe ato në të nxënë, për të cilat shkolla duhet të sigurojë një kujdes të posaçëm për gjithsecilin. Çdo fëmijë duhet të ndihet i sigurtë në shkollë, të mbështetet kur kalon nga një cikël shkollimi në tjetrin, të jetojë në një mjedis komod dhe të përshtatshëm fizik, të ketë besim se klima sociale në shkollë është pozitive dhe optimiste, të ndiejë se është gjithnjë nën vëmendjen e mësuesve, drejtuesve të shkollës, psikologut, punonjësit social apo mjekut. Shkolla duhet të afrojë shërbime të veçanta, duke i trajtuar nxënësit në mënyrë individuale për problemet që ata kanë. Prindërit dhe komuniteti luajnë një rol të rëndësishëm, pasi ata janë aktorë në këtë proces.

Karakteret dhe tiparet e fëmijëve dhe nxënësve janë të ndryshme dhe të shumëllojshme. Problemet që ata shkaktojnë dhe krijojnë në mjediset e shkollës, kërkojnë një infrastrukturë të posaçme, të cilën një shkollë e mirë e ka të gatshme dhe aktive në çdo moment.

Kjo fushë duhet menduar dhe trajtuar me vëmendje profesionale nga shkollat. Është një proces kompleks, sa i dukshëm, aq edhe i padukshëm, pasi flitet për marrëdhënie sociale, njerëzore, të cilat *fshihin* shumë

elemente individuale, komunikuese etj. Shkolla përfaqëson një larmi kulturash, racash, familjesh, besimesh dhe vlerash, por dhe vetë nivelet e ndryshme të arritjeve të fëmijëve apo nxënësve përfaqësojnë një larmi personalitetesh, të cilat mbeten sfiduese për shkollën. Shkollat kanë rregullore që respektojnë dhe përmbushin të drejtat dhe detyrimet e fëmijëve apo nxënësve, por kujdesi ndaj tyre është shumë më tepër se kaq. Nuk janë vetëm rregullat apo organizmat e shkollës që mund ta lehtësojnë këtë proces, por ajo çka ndodh dhe duhet bërë është shumë më tepër se kaq. Kujdesi ndaj nxënësve synon të krijojë një komunikim të qartë, funksional, etik dhe optimist, i cili e bën dhe e mban shkollën një mjedis të ngrohtë, por dhe motivon e nxit gjithnjë interesat dhe dëshirat e fëmijëve për të nxënë e për t'u zhvilluar.

Kujdesi për nxënësin përfshin **nënfushat:**

- 1. Kujdesi për fëmijët që kalojnë nga kopshti në shkollë**
- 2. Kujdesi për këshillimin e karrierës së nxënësit**
- 3. Kujdesi për nxënësit në procesin e të nxënit**
- 4. Kujdesi për nxënësit me nevoja të veçanta**
- 5. Kujdesi për nxënësit me prirje të veçanta**
- 6. Roli i veprimtarive ekstrakurrikulare**
- 7. Kujdesi i psikologut dhe i mjekut të shkollës për nxënësit**

### ***1. Kujdesi për fëmijët që kalojnë nga kopshti në shkollë***

Momenti i kalimit nga kopshti në shkollë konsiderohet shumë i mirëpritur nga fëmija, por mund të krijojë dhe probleme individuale dhe psikologjike, të cilat ndikojnë thellë në personalitetin e tij. Kjo periudhë tranzitore e kalimit nga loja e mirëfilltë, si objekti themelor i të nxënit në institucionin shkollë, ku të nxënëtit është parësor, është sfidues dhe mund të shkaktojë stres e ankth. Që ky tranzicion të jetë sa më i lehtë dhe i natyrshëm, nevojitet një planifikim dhe përgatitje e kujdesshme. Pikësynimi kryesor i planifikimit tranzitor duhet të tentojë që të sigurojë se personeli i kopshtit dhe i shkollës fillore njih filozofinë, programin dhe pikësynimet për fëmijën. Mbi këto njohuri hartohen programet tranzitore. Çdo kopsht duhet të ketë një plan të shkruar tranzicioni, i cili hartohet nga stafi i mësuesve të kopshtit, prindërit dhe mësueset e fillores. Në këtë plan mund të parashikohen:

a. Organizimi i takimeve mes personelit të shkollës fillore dhe kopshtit për të përcaktuar informacionin e përshtatshëm për të dy programet.

b. Takimi me mësueset e shkollës fillore të zonës për të diskutuar për çdo fëmijë që do shkojë në ato shkolla. Në këto takime mund të marrin pjesë edhe prindërit. Mësuesit e klasës së parë pajisen me një kopje të vlerësimeve vëzhguese, si dhe të dhënat zhvillimore të fëmijës.



c. Nga fundi i vitit shkollor organizohet një mbledhje me prindërit për t'i sqaruar dhe për të diskutuar me ta për ciklin fillor, me qëllim që fëmijët ta presin natyrshëm dhe me qetësinë e duhur futjen në shkollë.

d. Fëmijët parashkollorë vizitojnë klasat e shkollës fillore për t'u njohur me mjedisin e klasës apo të shkollës apo vëshgojnë dhe orë mësimore.

## ***2. Kujdesi për këshillimin e karrierës së nxënësit***

Karriera e një nxënësi fillon me regjistrimin e tij në shkollë, me kalimin nga një klasë në tjetrën, veçanërisht, me kalimin nga shkolla 9-vjeçare në arsimin e mesëm dhe më tutje, në arsimin e lartë. Shkolla 9-vjeçare duhet të sigurojë një fillim të mbarë të veprimtarisë shkollore të nxënësit, prandaj duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë rregullave për formimin e klasave, sqarimit të nxënësve dhe prindërve për zgjidhjet dhe zgjedhjet që kanë bërë. Shkolla merr vendime për shpërndarjen e nxënësve në klasa, krijon mundësi që nxënësit të zgjedhin klasat, modulet, lëndët me zgjedhje etj. Transparenca e procedurave në këtë proces ka rëndësi, sepse vendimet që merren kanë ndikim të madh tek e ardhmja e nxënësve. Në këtë proces shkolla duhet të marrë në konsideratë interesat e nxënësve dhe të prindërve të tyre dhe të organizojë në mënyrë të përshtatshme ndarjen e nxënësve në klasa.

Nxënësit dhe prindërit duhet të informohen sistematikisht për përparimin në mësim dhe për problemet që lidhen me ta. Njihen prindërit me sistemin e konsultimeve të shkollës, frekuentimin në mësim, njihen me projektet e zhvilluara në klasa apo në nivel shkolle dhe synohet që, edhe prindërit të bëhen bashkëpunëtorë të zbatimit të tyre. Në përfundim të arsimit 9-vjeçar dhe të mesëm, shkolla duhet të jetë e gatshme të bëjë rekomandimet e duhura për shkollimin e mëtejshëm të nxënësve të saj. Shkolla, duke ofruar hollësi për potencialin e nxënësve, i ndihmon ata dhe prindërit e tyre për të marrë vendime sa më të drejta. Në rastin e zgjedhjeve shkolla duhet të jetë shumë mbështetëse për nxënësit dhe prindërit. Informacioni dhe veprimtaritë këshilluese të karrierës duhet të jenë pjesë e punës për ecurinë e mëtejshme të nxënësve. Ky është një moment vendimmarrës shumë i rëndësishëm, i cili duhet të bëhet me konsultim nga palët e interesuara. Kjo veprimtari duhet të shndërrohet në një proces të frytshëm dhe pjesë normale e punës së shkollës çdo vit. Nuk duhet lënë vetëm në përfundim të vitit shkollor, por duhet punuar me informimin e vijueshëm të nxënësve për ndryshimet që i presin kur kalojnë në klasat, ciklet apo në llojet e shkollave që do të vijojnë.

## ***3. Kujdesi për nxënësit në procesin e të të nxënësve***

Kujdesi në procesin e të nxënësve demonstron përmes marrëdhënieve mësues-nxënësi. Për të krijuar një klimë miqësore, mësuesi duhet të ofrojë një komunikim të natyrshëm, duhet të bëjë shpjegime të qarta dhe të kuptueshme për nxënësit. Në këtë proces, ai duhet të nxitë dialog, të dëgjuar aktiv të fëmijëve, reagime pozitive, përballje dhe zgjidhje paqësore të konflikteve dhe situatave problemore. Mësuesi tregon kujdes të menjëhershëm për problemet apo mangësitë që fëmijët apo nxënësit shfaqin gjatë mësimin, duke përdorur forma pune të përshtatshme me ta. Po ashtu, ai ndjek dhe raporton brenda shkollës, lidhur me mungesat e

nxënësve, zbulon shkakun e bashkëpunon jo vetëm me mësuesit kujdestarë, organizmat përkatëse dhe përgjegjëse të shkollës, por edhe me fëmijët apo nxënësit. Respektimi i diversitetit kulturor, trajtimi i të gjithë fëmijëve dhe nxënësve njëllë duhet të jenë pjesë e natyrshme e punës së mësuesve. Mësuesi tregon vlerësim për përpjekjet e nxënësve, nuk bën komente apo diskriminim që të dekurajojë nxënësit. Ai përdor kritere për vlerësimin e nxënësve, duke nxitur vetëvlerësimin dhe besimin tek ata. Shkolla demonstroi një kujdes të veçantë për fëmijët dhe nxënësit duke ofruar konsultime falas për parapërgatitjen e nxënësve për Provimet e Lirimit dhe të Maturës Shtetërore.

#### ***4. Kujdesi për nxënësit me nevoja të veçanta***

Një shkollë konsiderohet e mirë atëherë kur ka dhe nxënës me nevoja të veçanta, për të cilët ajo kujdeset, i mbështet, i përfshin natyrshëm në procesin mësimor dhe arrin rezultate e progres në zhvillimin e tyre. Shkolla bashkëpunon ngushtë me Komisionin Vlerësues të Fëmijëve me Nevoja të Veçanta që ngrihet pranë qeverisjes lokale arsimore, nga i cili merr gjithë informacionin e duhur për fëmijët që do të jenë nxënës në shkollën e tyre. Nevojat e veçanta nënkuptojnë vështirësitë fizike, mendore, emocionale, vështirësitë e ndryshme që fëmija shfaq në procesin e të nxënës. Shkolla kujdeset për një shpërndarje të balancuar të këtyre fëmijëve në klasa, me qëllim që ata të integrohen sa më natyrshëm në klasat e zakonshme bashkë me fëmijët e tjerë. Bashkëpunimi midis psikologut, mësuesit, mjekut, drejtorisë së shkollës e prindërve është një mundësi për t'u ardhur në ndihmë këtyre fëmijëve. Të gjithë mësuesit planifikojnë dhe zbatojnë programe lëndore të përshtatshme për këta fëmijë, kërkojnë mbështetje nga prindërit, fëmijët, kolegët, psikologu, mjeku apo nga të tjerë të interesuar për shkollën, duke synuar që ata të progresojnë hap pas hapi në një linjë me kërkesat e kurrikulës. Mësuesi diskuton dhe miraton me ekipin lëndor programe të përshtatshme zhvillimore për ecurinë e fëmijëve. Mësuesi dhe shkolla kryejnë evidentimin sistematik të të dhënave për nxënësit, duke i vendosur gjithmonë në dosjen personale të zhvillimit të fëmijës. Në të vendosen analizat e rregullta që i bëhen fëmijës, testet diagnostikuese, produktet e ndryshme që vetë fëmija ka përgatitur. Shkolla harton një plan pune për ecurinë e këtyre fëmijëve, i cili diskutohet dhe me prindërit. Shkolla sipas mundësive krijon dhe një qendër të veçantë për këta fëmijë, në të cilin mund të kontribuojnë të gjithë aktorët e interesuar.

Një grup tjetër i nxënësve që kanë nevojë për mbështetje, janë dhe ata që paraqesin vështirësi në të nxënë, që lidhen me llojet e vështirësive në të lexuar, në të shprehur, me vështirësi të ndryshme për të përballuar trysinë që mbart në vetvete lënda mësimore apo vështirësi të të mbajturit mend, të mospërqendrimit etj. Këto vështirësi krijojnë shpeshherë stres, i cili reflektohet tek fëmijët apo nxënësit e mbyllur në vetvete dhe ata me një temperament agresiv e shpërthyes. Mësuesi duhet që të parashikojë metoda pune të përshtatshme për këta nxënës, duke u përpjekur vijimësisht për të siguruar një përfshirje në mënyrë të vullnetshme në të nxënë.

Për çdo rast, mësuesit dhe shkolla duhet të hartojnë dhe të zbatojnë një plan të posaçëm pune për të

identifikuar dhe mbështetur nxënësit me nevoja të veçanta, të mbajnë lidhje të rregullta me prindërit duke i informuar për progresin e nxënësve me vështirësi të ndryshme, si dhe të zhvillojnë veprimtari shtesë.

### **5. Kujdesi për nxënësit me prirje të veçanta**

Nxënësi me prirje të veçanta nënkupton një fëmijë që shfaq dukshëm parapëlqime dhe rezultate të larta në arte, sporte, por dhe në studimin e fushave apo lëndëve të shkencave natyrore, shoqërore, gjuhët e huaja apo në fushën e teknologjive të komunikimit. Shkolla duhet të sigurojë mundësi që këta nxënës të zhvillojnë prirjet e tyre përtej objektivave të kurrikulës. Shkolla planifikon, në ekipe kurrikulare, plane vjetore lëndore për të talentuarit, sipas programeve zyrtare dhe i zbaton ato në varësi të mundësive dhe grupimeve që mund të krijojë. Këta nxënës zakonisht janë "elita", si dhe kontigjente që e përfaqësojnë shkollën në veprimtari zonale, lokale, rajonale, kombëtare dhe ndërkombëtare. Ky është një stimul i fuqishëm për zhvillimin e tyre. Një shkollë e mirë zbaton një plan të posaçëm veprimtarish për këta nxënës, duke krijuar dhe aktivizuar grupime apo rrethe për ta, sipas prirjeve që ata shfaqin, p.sh.: grupi apo rrethi shkencor, i matematikës, i biologjisë, i arteve, i sportit, i gjuhëve të huaja etj. Shkolla përpiket që interesave të fëmijëve t'u përgjigjet me zhvillimin e aktiviteteve me personalitete të njohura të fushave ku ata demonstrojnë prirje apo dhe të krijojë mundësi që atyre t'u sigurohet literaturë, pajisje mësimore për thellimin e vijueshëm të tyre. Binjakëzimi me shkolla të tjera, brenda dhe jashtë, vendit është një mundësi për të përdorur dhe zhvilluar më shumë prirjet individuale të tyre. Në bashkëpunim me qeverisjen lokale dhe atë arsimore, shkolla realizon motivimin moral dhe financiar të fëmijëve të talentuar të fushave të ndryshme. Shkolla mund t'i shfrytëzojë këta nxënës edhe si lehtësues dhe mbështetës të nxënësve të tjerë, me qëllim që të bëhen kontribues në mbarëvajtjen e moshatarëve të tyre dhe i përfshin më shumë në situata sociale dhe bashkëpunuese.

### **6. Roli i veprimtarive ekstrakurrikulare**

Shkolla zbaton një plan veprimtarish mësimore dhe jashtë procesit mësimor. Këto veprimtari, që ndryshe quhen dhe jashtëshkollore, i ndihmojnë nxënësit të krijojnë përvoja në një sërë drejtimesh të nevojshme për të ardhmen. Kujdesi i shkollës në këtë rast është përzgjedhja e tematikave dhe veprimtarive të tilla, të cilat duhet të jenë në përputhje me interesat dhe zhvillimin real të fëmijës. *Së pari*, kjo tematikë duhet të mbështesë më tej nevojat e fëmijëve dhe të nxënësve në drejtim të formimit të tyre, bazuar në kërkesat e fushave të studimit të kurrikulës, por dhe të zhvillojë më tej thellimin e nxënësve me prirje të ndryshme. *Së dyti*, kjo tematikë duhet të marrë parasysh dhe mjedisin social apo kërkesat e tregut të punës, në të cilin ndodhet shkolla, p.sh.: nëse në një mjedis social është problem siguria rrugore, shkolla mund të japë një kontribut të madh në edukimin e fëmijëve me aftësitë e domosdoshme për sigurinë e tyre në rrugë etj. Shembuj të tillë ka plot. Çelësi i identifikimit të tyre është njohja e mirë e mjedisit social dhe interesave të komunitetit. *Së treti*, veprimtari të tilla duhet të marrin parasysh dhe dëshirat e fëmijëve për të udhëtuar në vende historike, turistike brenda dhe jashtë vendit, për të shkëmbyer përvojat me moshatarë të tjerë të rinj në shkolla të tjera, si dhe

për të zhvilluar veprimtari artistike dhe sportive. Në veprimtaritë jashtëshkollore, nxënësit duhet të punojnë në ekipe, duke e shfrytëzuar këtë si një mundësi për të krijuar besim në vetvete, si dhe të nxisë dëshirën për të qenë të suksesshëm në jetë. Veprimtaritë ekstrakurrikulare duhet të krijojnë mundësi për të përfshirë në to prindërit, përfaqësuesit e komunitetit, të qeverisjes lokale, të biznesit lokal apo të personaliteteve të artit, kulturës e shkencës, por dhe të vendimmarrësve të zonës ku shkolla funksionon.

### ***7. Kujdesi i psikologut dhe mjekut të shkollës për nxënësit***

Çdo shkollë duhet të krijojë mundësi që të ofrojë shërbim psikologjik ndaj fëmijëve dhe nxënësve të saj. Ky shërbim duhet të jetë i planifikuar dhe i zbatueshëm. Psikologu ka mjedisin përkatës të punës dhe e zhvillon veprimtarinë e tij në mënyrë profesionale, duke identifikuar saktë shkaqet e problemeve dhe të çrregullimeve që shfaqin nxënësit, përmes komunikimit dhe ruatjes së konfidencialitetit, por dhe të krijimit të një marrëdhënieje dhe komunikimi të frytshëm me secilin fëmijë apo nxënës. Psikologu përgatit për çdo nxënës kartelën përkatëse dhe evidenton përmirësimin e sjelljeve të tij. Ai bashkëpunon ngushtë me prindërit, me mësuesin kujdestar dhe atë lëndor, duke synuar që ata të plotësojnë dhe harmonizojnë njëri-tjetrin në ndihmën që i duhet dhënë fëmijës apo nxënësit për përmirësimin e çrregullimeve që demonstroi apo nevojave që ka. Një rol të posaçëm psikologu mund të luajë dhe në këshillimin e karrierës për nxënësit. Edhe mjeku, kur është pjesë e stafit të shkollës, ka rolin e tij në drejtim të kujdesit ndaj fëmijës apo nxënësit.

Mjeku zbaton planin e tij vjetor, i cili parashikon identifikimin e problemeve shëndetësore për secilin fëmijë apo nxënës. Ai ka të gjitha kartelat shëndetësore të nxënësve, ku pasqyrohen të dhënat e duhura për ta. Mjeku ndjek në vijimësi shëndetin e fëmijëve për probleme të ndryshme të shëndetit, të aspekteve stomatologjike dhe ndikon fort në raste të epidemive të sëmundjeve ngjitëse. Mjeku kontribuon në fushën e edukimit shëndetësor në shkollë për çështje të ndjeshme që lidhen me zhvillimin seksual, me informimin për parandalimin e HIV/AIDS, të sëmundjeve seksualisht të transmetueshme, të parandalimit të drogave, duhanit, alkoolit, obezitetit etj. Mjeku analizon në vijimësi dhe situatën sanitare të institucionit, duke informuar rregullisht drejtorinë e shkollës. Ashtu si dhe psikologu, mjeku mban lidhje të ngushta me prindërit, mësuesit dhe drejtorinë e shkollës.

Nënfusha 1	Treguesit	Instrumente	Nivelet e vlerësimit			
			1	2	3	4
<b>Kujdesi për fëmijët që kalojnë nga kopshti në shkollë</b>	1. Shkolla zbaton programe tranzitore për kalimin e fëmijëve nga kopshti në shkollë.	<b>1.1.1.</b> Shkolla organizon takime mes mësuesve të ciklit fillor dhe kopshtit, për të transmetuar informacionin e programeve tranzitore.				
		<b>1.1.2.</b> Mësuesit e klasës së parë pajisen me një kopje të vlerësimeve vëzhguese, si dhe të dhënat zhvillimore të fëmijës.				
		<b>1.1.3.</b> Shkolla organizon takime me prindërit, për t'i sqaruar dhe për të diskutuar me ta për ciklin fillor.				
		<b>1.1.4.</b> Fëmijët parashkollorë vizitojnë klasat e shkollës fillore për t'u njohur me mjedisin dhe marrin pjesë në orë mësimore.				

Nënfusha 2	Treguesit	Instrumente	Nivelet e vlerësimit			
			1	2	3	4
<b>Kujdesi për këshillimin e karrierës së nxënësit</b>	1. Shkolla zbaton programe për këshillimin e karrierës së nxënësve.	<b>2.1.1.</b> Shkolla harton një plan për këshillimin e karrierës së nxënësve.				
		<b>2.1.2.</b> Plani parashikon këshillim për kalimin e nxënësve nga një cikël shkollor në tjetrin.				
		<b>2.1.3.</b> Klasat krijohen duke mbajtur parasysh parapëlqimet e nxënësve.				
	2. Shkolla informon prindërit, në mënyrë të planifikuar, për rezultatet e nxënësve.	<b>2.2.1.</b> Prindërit dhe nxënësit informohen për zgjedhjet e ndryshme, për të cilat nxënësit duhet të marrin vendime në shkollë.				
		<b>2.2.2.</b> Prindërit janë gjithnjë të përfshirë në vendimmarrjet e fëmijëve të tyre në shkollë.				
		<b>2.2.3.</b> Shkolla ofron informacion të saktë dhe të kuptueshëm për karrierën e nxënësit.				
		<b>2.2.4.</b> Shkolla kujdeset dhe ka një sistem të frytshëm pune për të informuar rregullisht prindërit për arritjet e nxënësve.				

Nënfusha 3	Treguesit	Instrumente	Nivelet e vlerësimit			
			1	2	3	4
<b>Kujdesi për nxënësit gjatë procesit të nxënës</b>	1. Procesi mësimor reflekton kujdesje dhe klimë miqësore për nxënësit.	<b>3.1.1.</b> Komunikimi i ndërsjellë mësues-nxënës reflekton siguri dhe besim.				
		<b>3.1.2.</b> Komunikimi mësues-nxënës realizohet përmes shpjegimeve, të dëgjuarit, shkëmbimeve pyetje-përgjigje dhe diskutimeve.				
		<b>3.1.3.</b> Respektimi i diversitetit kulturor është i natyrshëm në marrëdhëniet mësues-nxënës dhe nxënës-nxënës.				
		<b>3.1.4.</b> Vlerësimi i nxënësve nxit dhe stimulon të nxënët.				
		<b>3.1.5.</b> Shkolla ofron konsultime falas për nxënësit përpara Provimeve të Lirimit dhe të Maturës Shtetërore.				

Nënfusha 4	Treguesit	Instrumente	Nivelet e vlerësimit			
			1	2	3	4
<b>Kujdesi për nxënësit me nevoja të veçanta</b>	1. Shkolla harton dhe zbaton një plan pune për nxënësit me nevoja të veçanta.	<b>4.1.1.</b> Shkolla bashkëpunon me Komisionin e Vlerësimit të Fëmijëve me Nevoja të Veçanta, për të identifikuar fëmijët që do të përfshihen në shkollën e tyre.				
		<b>4.1.2.</b> Shkolla shfaq interes për të regjistruar fëmijët me nevoja të veçanta në shkollën e tyre.				
		<b>4.1.3.</b> Shkolla i shpërndan këta fëmijë nëpër klasa, sipas kriterëve.				
		<b>4.1.4.</b> Shkolla zbaton programe lëndore të përshtatshme, të hartuara nge ekipet lëndore, sipas nevojave të secilit fëmijë.				
		<b>4.1.5.</b> Secili fëmijë me nevoja të veçanta ka dosjen e tij të zhvillimit individual, të plotësuar me materialet e domosdoshme.				

		<b>4.1.6.</b> Mësuesit përdorin forma pune të përshtatshme për të mbështetur nxënësit në vështirësitë e tyre të të nxënës.				
		<b>4.1.7.</b> Shkolla përfshin prindërit në trajtimin dhe kujdesin ndaj fëmijëve me nevoja të veçanta dhe me vështirësi në të nxënë.				
		<b>4.1.8.</b> Shkolla mundëson dhe një mjedis të posaçëm për trajtimin individual të fëmijëve.				

Nënfusha 5	Treguesit	Instrumente	Nivelet e vlerësimit			
			1	2	3	4
<b>K u j d e s i për nxënësit me prirje të veçanta</b>	1. Shkolla harton dhe zbaton një plan pune për nxënësit me prirje të veçanta.	<b>5.1.1.</b> Shkolla identifikon prirjet e veçanta të nxënësve.				
		<b>5.1.2.</b> Shkolla zbaton programe të avancuara zhvillimore sipas prirjeve të nxënësve.				
		<b>5.1.3.</b> Programet e avancuara zhvillimore hartohen nga ekipet lëndore dhe janë rrjedhojë e programeve zyrtare.				
		<b>5.1.4.</b> Shkolla promovon nxënësit me prirje të veçanta në veprimtari të ndryshme lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare.				
		<b>5.1.5.</b> Shkolla i mbështet këta nxënës, duke krijuar grupe apo rrethe shkollore për zhvillimin e tyre sipas prirjeve.				
		<b>5.1.6.</b> Shkolla bashkëpunon qëllimshëm me personalitete, me institucione, me binjakëzime për të mbështetur prirjet e nxënësve.				
		<b>5.1.7.</b> Shkolla i përdor këta nxënës si mbështetës dhe lehtësues për moshatarët e tyre.				
		<b>5.1.8.</b> Shkolla promovon nxënësit me prirje të veçanta në veprimtari të ndryshme lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare.				

Nënfusha 6	Treguesit	Instrumente	Nivelet e vlerësimit			
			1	2	3	4
<b>Roli i veprimtarive ekstra-kurrikulare</b>	1. Shkolla zbaton një plan të posaçëm me veprimtari jashtë-shkollore.	<b>6.1.1.</b> Shkolla përfshin gjithë stafin e mësuesve në zhvillimin e veprimtarive jashtëshkollore.				
		<b>6.1.2.</b> Tematika e veprimtarive bazohet në interesat dhe nevojat reale të fëmijëve, për t'u thelluar më shumë rreth fushave dhe lëndëve të kurrikulës.				
		<b>6.1.3.</b> Tematika e veprimtarive jashtëshkollore merr parasysh interesat e mjedisit social, në të cilin ndodhet shkolla.				
		<b>6.1.4.</b> Tematika e veprimtarive jashtëshkollore merr parasysh dëshirat e fëmijëve.				
		<b>6.1.5.</b> Veprimtaritë zhvillohen në shkollë, në mjedise të tjera, brenda dhe jashtë vendit.				
		<b>6.1.6.</b> Puna në ekipe është në thelb të zhvillimit të aktiviteteve të tilla.				
		<b>6.1.7.</b> Në këto veprimtari përfshihen prindërit, komuniteti, biznesi lokal, përfaqësues nga qeverisja lokale dhe arsimore.				

Nënfusha 7	Treguesit	Instrumente	Nivelet e vlerësimit			
			1	2	3	4
<b>K u j d e s i ndaj nxënësve i psikologut dhe i mjekut të shkollës</b>	1. Shkolla ofron shërbimin e psikologut dhe të mjekut.	<b>7.1.1.</b> Shkolla planifikon shërbimin që ofron psikologu dhe mjeku gjatë gjithë vitit.				
		<b>7.1.2.</b> Psikologu dhe mjeku kanë mjedis të posaçëm pune në shkollë.				
		<b>7.1.3.</b> Psikologu dhe mjeku punojnë individualisht me çdo nxënës.				



		<b>7.1.4.</b> Psikologu ruan konfidencialitetin e çdo fëmije që ai trajton.				
		<b>7.1.5.</b> Psikologu dhe mjeku plotësojnë rregullisht kartelat përkatëse të fëmijëve.				
		<b>7.1.6.</b> Psikologu dhe mjeku bashkëpunojnë dhe përfshijnë në punën e tyre: prindërit, kolegët dhe mësuesit kujdestarë.				

## STANDARDI

Shkolla kujdeset në mënyrë të vazhdueshme për nxënësit. Kujdesi konsiderohet si një proces jetik dhe i domosdoshëm për arritjet e shkollës, pasi në qendër të saj janë nxënësit dhe mirëqenia e tyre. Kujdesi është i planifikuar dhe shtrihet gjatë gjithë shkollës duke filluar me ciklin 9-vjeçar e deri në mbarimin e shkollës së mesme. Shkolla mbështet çdo nxënës, kur kalon nga një klasë në tjetrën, nga një cikël shkollor në tjetrin, duke i ofruar asistencë dhe këshillim. Shkolla ofron informacionin e duhur dhe të qartë për karrierën e nxënësve të saj. Në këtë proces përfshihen prindërit dhe të gjithë aktorët që lidhen ngushtë me shkollën, si: qeverisja lokale, qeverisja arsimore, komunitet etj. Shkolla i mirëpret fëmijët me nevoja të veçanta dhe zbaton plane pune të frytshme për progresin e tyre, duke iu siguruar komoditet dhe përkrahje. Shkolla ka të gjitha mekanizmat për të identifikuar dhe për të zbatuar plane mbështetëse për nxënësit me prirje të veçanta. Ajo mundëson zhvillimin e mëtejshëm të tyre edhe duke i promovuar në veprimtari të ndryshme jashtëshkollore. Shkolla ofron shërbimin psikologjik dhe mjekësor për çdo nxënës.

### NIVELI 1

Shkolla tregon kulturë të kujdesit dhe të përkushtimit ndaj secilit nxënës. Ajo zbaton rregullisht plane për informimin dhe këshillimin e karrierës. U jep informacion të rregullt prindërve për arritjet dhe rezultatet e fëmijëve në procesin mësimor. Nxënësi ndihet i sigurtë në mjedisin e shkollës. Ai gjen lehtësi dhe mbështetjen e duhur, pasi është i lirë të përfshihet aktivisht në diskutime, në shkëmbime pyetje-përgjigjesh. Nxënësi ndihet i respektuar, pavarësisht, përkatësisë së tij kulturore. Shkolla mbështet me programe dhe asistencën e duhur, fëmijët me nevoja të veçanta. Nxënësit me prirje gjejnë hapësira dhe materiale për të thelluar më tej talentin e tyre. Veprimtaritë jashtëshkollore zhvillohen rregullisht sipas një planifikimi që ka marrë në konsideratë interesat dhe dëshirat e nxënësve, si dhe nevojat e mjedisit social të shkollës. Shërbimi psikologjik dhe mjekësor në shkollë është i frytshëm dhe i vijueshëm, në funksion të çdo nxënësi.

## **NIVELI 2**

Shkolla ofron kujdes ndaj nxënësve në shkollë. Kujdesi është i planifikuar dhe përfshin nxënësit me nevoja të veçanta dhe ata me prirje, por jo gjithmonë zbatohet me korrektësi ky planifikim. Shkolla bashkëpunon me komunitetin, por ky bashkëpunim nuk është efektiv gjithmonë. Shkolla ofron këshillime për karrierën. Dëshirat e nxënësve në përzgjedhjen e tyre respektohen në pjesën më të madhe të rasteve. Nxënësit mbështeten kur kalojnë nga një cikël shkollor në tjetrin. Shkolla zhvillon veprimtari jashtëshkollore që mbështesin interesat e fëmijëve. Ajo ofron shërbimin psikologjik, i cili merr në konsideratë të gjithë nxënësit si individë në problemet e tyre. Shërbimi mjekësor është i pranishëm dhe mbështet shëndetin e nxënësve.

## **NIVELI 3**

Shkolla bën përpjekje për t'u kujdesur për nxënësit, por në këtë proces nuk janë të përfshirë të gjithë aktorët. Shkolla nuk tregon interes për të përfshirë fëmijët me nevoja të veçanta. Nxënësit me prirje mbështeten pak dhe kujdesi ndaj tyre është spontan dhe jo i organizuar. Shkolla ofron këshillime për karrierën, por përzgjedhja e nxënësve në të shumtën e herës mbetet pa u respektuar. Nxënësit ndiejnë nevojën që të respektohen dhe të mbështeten për karrierën e tyre. Bashkëpunimi me prindërit dhe komunitetin është i pakoordinuar dhe nuk është i frytshëm në kujdesin ndaj nxënësve. Veprimtaritë jashtëshkollore që zhvillohen, nuk marrin në konsideratë interesat dhe nevojat e fëmijëve. Shërbimi psikologjik dhe ai mjekësor nuk është në nivelin e duhur, për të mbështetur secilin nxënë.

## **NIVELI 4**

Shkolla ofron kujdes të pamjaftueshëm për nxënësit. Kujdesi ofrohet në mënyrë spontane dhe nuk është i planifikuar. Shkolla nuk tregon interes për fëmijët me nevoja të veçanta dhe shfaq qëndrime jokorrekte ndaj kulturave dhe vlerave të ndryshme. Këshillimi i karrierës zhvillohet i paplanifikuar dhe nuk arrin të mbështesë nevojat e nxënësve. Prindërit përfshihen në mënyrë rastësore në problemet e shkollës dhe nuk janë pjesë e lehtësimit apo e kujdesjes në shkollë. Shkolla nuk disponon një plan të rregullt për planifikimin e veprimtarive jashtëshkollore. Edhe kur ato zhvillohen, janë të rastësishme dhe jo në mbështetje të fëmijëve. Nxënësit me prirje nuk identifikohen dhe nuk mendohet për ta. Në planifikimin e orëve mësimore të çdo mësuesi nuk parashikohen veprimtari për nxënësit me vështirësi në të nxënë. Shërbimi psikologjik dhe ai mjekësor që ofrohet në shkollë, është formal dhe shumë prej veprimtarive të tyre janë të padokumentuara

## FUSHA V. MENAZHIMI I SHKOLLËS

Çdo shkollë vepron si një organizëm që i ofron shoqërisë dhe komunitetit shërbime të caktuara në bashkëveprim me të, duke synuar zgjidhjen hap pas hapi të problemeve për të realizuar në vazhdimësi ndryshimet pozitive që ajo i planifikon. Shkolla jeton në një mjedis të caktuar dhe si organizatë të nxëni duhet të respektojë mjedisin social të saj, pasi aty burojnë idetë, janë politikat dhe partnerët. Është e natyrshme që marrëdhëniet mes tyre mund të ndryshojnë. Te këto marrëdhënie qëndron edhe fati i suksesit të shkollës.

Një shkollë cilësore dallohet që në planifikim me zbatimin e disa parimeve, si:

Ë Prirja për të vënë në lëvizje gjithë trupën mësimore,

Ë Aftësia për të punuar në grup ose me grupin për të marrë vendime sa më të mira,

Ë Përdorimi i kohës për të planifikuar, për të kryer dhe për të analizuar një punë të rëndësishme.

Pra, një menazhim i mirë është kur ka:

1. Bashkëpunim brenda shkollës,
2. Punë me prindërit dhe komunitetin,
3. Bashkëpunim me Bordin e Shkollës.

Zbulimi themelor është se aleancat janë menazhimi më i mirë i organizatave të të nxënit, sepse:

*Së pari*, problemet sot janë tepër komplekse dhe të vështira për t'u zgjidhur nga çdo lloj grupi,

*Së dyti*, në çështjet e arsimit, çdonjëri nga përfituesit këmbëngul t'i dëgjohet zëri për gjërat që ndodhin.

Menazhimi është një përdorim efektiv dhe ekonomik i burimeve, për të arritur rezultate në shkollë me dhe përmes përpjekjeve të njerëzve të tjerë.

Në mënyrë më të detajuar, veprimtaritë e përmbajtjes kanë të bëjnë me gjendjen tërësore të shkollës, synimet e saj, objektivat e shkollës dhe veprimtaritë për realizimin e tyre, si dhe me aspektet administrative të jetës së shkollës. Menazhim i mirë i shkollës do të thotë që shkolla të njohë të gjithë faktorët që ndikojnë në jetën e saj. Ka faktorë që janë të përbashkët për të gjitha shkollat dhe këto i përkasin kryesisht nivelit vertikal të menazhimit. Këtu bëjnë pjesë kryesisht dokumentacioni bazë i kurrikulës shkollore, aktet ligjore dhe nënligjore, si dhe udhëzimet e ndryshme të MASH-it apo qeverisjes lokale arsimore. Çdo shkollë ka kushtet dhe rrethanat e saj. Këto specifika ndikojnë në mënyrën si shkolla identifikon pikat e forta dhe të dobëta të saj. Disa nga këta faktorë janë: dallimet në aftësi të nxënësve, përfshi këtu edhe nxënësit me nevoja të veçanta, arritjet e nxënësve, gjendja fizike e shkollës dhe cilësia e mjedisit të saj, pajisjet e shkollës, niveli i stafeve mësimore, aspiratat mësimore të prindërve, bashkëpunimet e shkollës në planin horizontal.

Veprimtaritë që kanë të bëjnë me aspektet administrative të jetës së shkollës prekin jo vetëm drejtimet

e rutinës së përditshme të administrimit në shkollë, por në veçanti, edhe çështjet kryesore ku fokusohet planifikimi afatmesëm dhe vjetor i shkollës, si është komunikimi brenda saj, si realizohet ndarja e detyrave të stafit mësimor, procedurat e regjistrimit dhe transferimit të nxënësve, bashkëpunimi me të gjitha grupet e interesit etj.

Në këtë kuptim, fusha e menazhimit të shkollës përfshin në vetvete 8 nënfusha, të cilat mundësojnë funksionimin tërësor të menazhimit të shkollës.

### **Nënfushat:**

- 1. *Plani afatmesëm i shkollës*** është një planifikim 4-vjeçar aktivitetesh të shkollës, që ka në fokus nxënësin dhe në themel të tij qëndron përmirësimi i mëtejshëm i procesit të nxënies. Në të paraqitet një njohje e thellë dhe e detajuar e mjedisit fizik të shkollës, e situatës sociale të komunitetit rreth shkollës, e bashkëpunimeve të shkollës, por në veçanti, trajtohen problemet reale që lidhen me arritjet e nxënësve.
- 2. *Plani vjetor i shkollës*** është i ndërtuar në përputhje me formatin zyrtar dhe ai mundëson një përfshirje organike të gjithë punës mësimore-edukative të shkollës. Objektivat e planit vjetor ndërtohen duke marrë parasysh arritjet e vitit të mëparshëm mësimor.
- 3. *Plani i vëzhgimit të orëve mësimore*** realizohet në përputhje me udhëzimet zyrtare të MASH-it. Drejtuesit bëjnë vëzhgime, mbajnë shënime të detajuara për gjetjet në planin ditor të mësuesit, bëjnë miniteste, provime për të evidentuar progresin e nxënësve. Në fund, drejtuesit e shkollës bashkë me mësuesin ose me ekipin kurrikular lëndor analizojnë gjetjet e orëve të vëzhguara dhe japin rekomandime dhe sugjerime për përmirësimin e cilësisë së procesit mësimor.
- 4. *Plani i monitorimit të dokumentacionit shkollor*** përfshin vëzhgimin e plotësimit të dokumentacionit zyrtar (plan lëndor/modul/projekt kurrikular, regjistri, amza, dëftesat, inventarin).
- 5. *Statistikat e shkollës, regjistrimi dhe transferimi i nxënësve*** ka të bëjë me procedurën e regjistrimit në klasën e parë të shkollës 9-vjeçare, që kryhet me anë të certifikatës së lindjes, çerfitikatës së vaksinimit, si dhe me dosjen e progresit të fëmijës në kopsht; regjistrimi në klasat e shkollës 9-vjeçare që bëhet me anë të dëftesës; regjistrimi në klasat e gjimnazit i cili bëhet me anë të dëftesës së lirimimit të arsimit 9-vjeçar, por duke u bazuar dhe në zgjedhjet e lëndëve të konfirmuara me shkrim nga nxënësi dhe prindi.
- 6. *Vlerësimi i brendshëm i shkollës*** ka të bëjë me analizën e realizimit të treguesve të vetë shkollës, duke përdorur instrumente standarde dhe ku është i përfshirë i gjithë stafi mësimor.
- 7. *Gjithëpërfshirja*** nënkupton të gjitha organizmat e saj sipas Dispozitave Normative, si: Këshilli i klasës, Këshilli i disiplinës, Këshilli i mësuesve, Këshilli i prindërve, Qeveria e nxënësve, Bordi i Shkollës.
- 8. *Puna në ekip*** është nxitja që shkolla ta menazhojë punën e saj me ekipe të personelit të vet për hartimin dhe zbatimin e planeve afatmesme, planeve vjetore dhe planeve mujore.

Nënfusha 1	Treguesit	Instrumente	Nivelet e vlerësimit			
			1	2	3	4
<b>Plani afatmesëm i shkollës</b>	1. Shkolla zhvillohet përmes planit afatmesëm.	<b>1.1.1.</b> Shkolla zbaton planin afatmesëm të saj.				
		<b>1.1.2.</b> Plani afatmesëm ka marrë miratimin e DAR-it dhe të Bordit të Shkollës.				
		<b>1.1.3.</b> Plani afatmesëm është ndërtuar sipas formatit të rekomanduar.				
		<b>1.1.4.</b> Plani paraqet qartë analizën e thellë të gjendjes së shkollës.				
		<b>1.1.5.</b> Plani afatmesëm paraqet një njohje të thellë dhe të detajuar të mjedisit fizik të shkollës, të situatës sociale të komunitetit rreth shkollës, të bashkëpunimeve të shkollës dhe, në veçanti, problemet reale që lidhen me arritjet e nxënësve.				
		<b>1.1.6.</b> Prioritetet e planit afatmesëm përputhen me nevojat reale të shkollës për përmirësim dhe progres.				
		<b>1.1.7.</b> Planifikimi 4-vjeçar mundëson arritjen e objektivave.				
		<b>1.1.8.</b> Stafii pedagogjik dhe grupet e interesit janë të përfshirë në procesin e hartimit të planit afatmesëm.				
		<b>1.1.9.</b> Zbatimi i planit afatmesëm vëzhgohet nga ekipi mbikëqyrës.				
		<b>1.1.10.</b> Plani afatmesëm zbatohet përmes planit vjetor të shkollës.				
		<b>1.1.11.</b> Objektivat e plani vjetor zhvillojnë prioritetet e planit afatmesëm.				
		<b>1.1.12.</b> Plani vjetor është rrjedhojë e natyrshme e planit afatmesëm të shkollës.				
		<b>1.1.13.</b> Drejtuesit dhe personeli i shkollës shpjegojnë lehtësisht dallimet midis planit afatmesëm dhe planit vjetor.				
		<b>1.1.14.</b> Personeli i shkollës është i motivuar për zbatimin cilësor të planin afatmesëm.				

Nënfusha 2	Treguesit	Instrumente	Nivelet e vlerësimit			
			1	2	3	4
<b>Plani vjetor i shkollës</b>	1. Shkolla zbaton planin vjetor.	<b>2.1.1.</b> Plani vjetor i shkollës është i ndërtuar në përputhje me formatin zyrtar.				
		<b>2.1.2.</b> Personeli i shkollës dhe grupet e interesit janë përfshirë në hartimin e planit vjetor.				
		<b>2.1.3.</b> Është analizuar gjendja e shkollës sipas udhëzimit përkatës.				
		<b>2.1.4.</b> Objektivat dhe veprimtaritë e planit janë hartuar saktë dhe në përshtatje me gjendjen e shkollës.				
		<b>2.1.5.</b> Objektivat e planit vjetor kanë marrë parasysh arritjet e vitit të kaluar.				
		<b>2.1.6.</b> Objektivat dhe veprimtaritë e planit janë të njohura dhe mbështeten nga mësuesit dhe prindërit.				
		<b>2.1.7.</b> Plani vjetor mundëson një përfshirje organike të gjithë punës mësimore-edukative të shkollës.				
		<b>2.1.8.</b> Plani vjetor është i zbatueshëm.				
		<b>2.1.9.</b> Plani vjetor është miratuar edhe nga Bordi i Shkollës.				
		<b>2.1.10.</b> Plani vjetor është rrjedhojë e planit afatmesëm të shkollës.				
		<b>2.1.11.</b> Plani vjetor është i zërthyer në plane mujore.				
		<b>2.1.12.</b> Plani vjetor ruhet në shkollë për 2 vjet.				

Nënfusha 3	Treguesit	Instrumente	Nivelet e vlerësimit			
			1	2	3	4
<b>Plani i vëzhgimit të orëve mësimore</b>	1. Drejtoria e shkollës kryen vëzhgime sistematike të orëve mësimore, për të nxitur progresin e nxënësve.	<b>3.1.1.</b> Drejtoria e shkollës zbaton planin e vëzhgimit të orëve mësimore, si pjesë integrale të planit të saj të punës.				
		<b>3.1.2.</b> Plani i vëzhgimit të orëve mësimore zbatohet në përputhje me sasinë zyrtare të orëve mësimore për drejtuesit e shkollës.				
		<b>3.1.3.</b> Drejtuesit e shkollës e kanë realizuar planin e vëzhgimit të orëve mësimore.				
		<b>3.1.4.</b> Orët mësimore të vëzhguara lidhen drejtpërdrejt me objektivat e planin vjetor të shkollës.				
		<b>3.1.5.</b> Drejtuesit e shkollës shqyrtojnë planifikimin e orës mësimore, si dhe planin ditor të mësuesit.				
		<b>3.1.6.</b> Plani ditor/planifikimi i orës mësimore shqyrtohet sipas një formati standard.				
		<b>3.1.7.</b> Drejtuesit e shkollës mbajnë shënime të detajuara për gjetjet në planin ditor të mësuesit.				
		<b>3.1.8.</b> Drejtuesit e shkollës përdorin format standard për vëzhgimin e orëve mësimore.				
		<b>3.1.9.</b> Drejtuesit e shkollës zhvillojnë miniteste dhe provime të ndryshme për të evidentuar progresin e nxënësve.				
		<b>3.1.10.</b> Drejtuesit e shkollës bashkë me mësuesin ose me ekipin kurrikular/ ekipin lëndor analizojnë gjetjet e orëve të vëzhguara.				
		<b>3.1.11.</b> Drejtuesit e shkollës japin rekomandime dhe sugjerime tek mësuesit për përmirësimin e cilësisë së procesit mësimor, duke u bazuar në gjetjet e vëzhguara.				
		<b>3.1.12.</b> Drejtuesit e shkollës identifikojnë përvojat e suksesshme dhe i ndajnë ato me personelin mësimor.				
		<b>3.1.13.</b> Drejtuesit e shkollës përgatitin raportet e vëzhgimit dhe i analizojnë ato me personelin e shkollës ose me ekipet lëndore/ ekipi kurrikular.				
		<b>3.1.14.</b> Drejtuesit e shkollës i përdorin të dhënat e vëzhgimeve për të bërë vlerësimin e performancës vjetore të mësuesit.				

Nënfusha 4	Treguesit	Instrumente	Nivelet e vlerësimit			
			1	2	3	4
<b>Plani i monitorimit të dokumentacionit shkollor</b>	1. Drejtoria e shkollës monitoron gjatë gjithë vitit shkollor plotësimin e dokumentacionit zyrtar.	<b>4.1.1.</b> Drejtoria e shkollës zbaton një plan pune për vëzhgimin e plotësimin të dokumentacionit zyrtar (plan lëndor/modul/projekt kurrikular, regjistra, amza, dëftesa, inventar).				
		<b>4.1.2.</b> Plani i monitorimit të dokumentacionit shkollor zbatohet brenda orëve mësimore të ngarkesës së drejtuesve të shkollës.				
		<b>4.1.3.</b> Plani i monitorimit të dokumentacionit shkollor është realizuar nga drejtuesit e shkollës.				
		<b>4.1.4.</b> Planet lëndore/moduli, projekti kurrikular miratohen nga drejtoria e shkollës, pasi të kenë marrë aprovimin e tyre nga ekipi lëndor kurrikular përkatës apo DAR/ZA-ja.				
		<b>4.1.5.</b> Planet lëndore/moduli, projekti kurrikular miratohen dhe për një semestër të vitit shkollor.				
		<b>4.1.6.</b> Shkolla i ruan planet lëndore/modulet, projektet kurrikulare deri në fund të vitit shkollor.				
		<b>4.1.7.</b> Regjistrat plotësohen në përputhje me kriteret zyrtare.				
		<b>4.1.8.</b> Regjistrat ruhen në shkollë për 8 vjet.				
		<b>4.1.9.</b> Drejtuesit e shkollës identifikojnë gjetjet në plotësimin e regjistrave dhe i përpunojnë ato në raporte vlerësimi.				
		<b>4.1.10.</b> Gabimet, korrigjimet ose shënimet jokorrekte në regjistra qortohen dhe siglohen nga drejtuesit e shkollës tek rubrika "Shënime të veçanta".				
		<b>4.1.11.</b> Drejtuesit i diskutojnë gjetjet në regjistra me personelin e shkollës dhe rekomandojnë përmirësimet e duhura.				
		<b>4.1.12.</b> Drejtuesit e shkollës i përdorin të dhënat e gjetjeve në regjistra edhe për të bërë vlerësimin vjetor të performancës së mësuesve.				



		<b>4.1.13.</b> Drejtuesit e shkollës sigurojnë amzat për institucionin e tyre.				
		<b>4.1.14.</b> Amza plotësohet sipas kritereve zyrtare.				
		<b>4.1.15.</b> Amza ruhet në shkollë gjithmonë.				
		<b>4.1.16.</b> Amza plotësohet nga një nëndrejtor i shkollës.				
		<b>4.1.17.</b> Shkolla mund të hartojë amzën elektronike të saj.				
		<b>4.1.18.</b> Shkolla bashkëpunon me DAR/ZA-në dhe APRIAL-in për plotësimin e të dhënave dhe të amzës, për nxënësit e saj që përfundojnë Maturën Shtetërore.				
		<b>4.1.19.</b> Shkolla ka plotësuar sipas kritereve dhe Indeksit alfabetik të amzës.				
		<b>4.1.20.</b> Renditja e nxënësve në Indeksit alfabetik ka përputhje me renditjen në amzë.				
		<b>4.1.21.</b> Drejtorja e shkollës siguron dëftesat për nxënësit e saj.				
		<b>4.1.22.</b> Dëftesat që u lëshohen nxënësve janë sipas formatit standard, të miratuar nga MASH-i.				
		<b>4.1.23.</b> Dëftesat janë plotësuar sipas kritereve zyrtare dhe rubrikave të saj.				
		<b>4.1.24.</b> Dëftesat lëshohen të nënshkruara nga mësuesi kujdestar e drejtori dhe janë të vulosura me vulën e shkollës.				
		<b>4.1.25.</b> Dëftesa përdoret nga nxënësi për regjistrimin në klasën pasuese.				
		<b>4.1.26.</b> Shkolla ka inventarin e saj të dokumentuar.				
		<b>4.1.27.</b> Shkolla e bën inventarin çdo vit shkollor, nga një komision i posaçëm.				
		<b>4.1.28.</b> Inventari i shkollës paraqitet në Librin e inventarit.				

		<b>4.1.29.</b> Libri i inventarit për çdo vit shkollor ruhet 10 vjet në shkollë.				
		<b>4.1.30.</b> Libri i inventarit të shkollës plotësohet dhe menazhohet nga një nëndrejtor i shkollës.				
		<b>4.1.31.</b> Libri i inventarit përfshin të gjithë pronën e shkollës (ndërtes/ën,-at, muret rrethuese, orenditë, biblioteka, pajisjet e laboratorëve, kabinetet informatike, mjetet didaktike, palestrën, bazën prodhuese, këndet sportive, punishtet, tokën, aparate telefonike, vegla pune etj.).				
		<b>4.1.32.</b> Shkolla bashkëpunon me qeverisjen lokale dhe me DAR/ZA-në për plotësimin e inventarit.				
		<b>4.1.33.</b> Drejtori i shkollës ushtron përgjegjësinë e tij juridike për ruajtjen e inventarit.				
		<b>4.1.34.</b> Zhdëmtimet e pajisjeve apo materialeve të ndryshme bëhen sipas ligjit.				
		<b>4.1.35.</b> Dorëzimi i librit të inventarit nga një drejtues shkolle tek tjetri bëhet me procesverbal.				
		<b>4.1.36.</b> Libri i inventarit është dokument transparent për shkollën dhe komunitetin.				

Nënfusha 5	Treguesit	Instrumente	Nivelet e vlerësimit			
			1	2	3	4
<b>Statistikat e shkollës, regjistrimi dhe transferimi i nxënësve</b>	1. Shkolla ka statistika të sakta dhe përdor procedura korrekte për regjistrimin dhe transferimin e nxënësve.	<b>5.1.1.</b> Shkolla ka të përcaktuara nga DAR/ZA-ja se nga cilat kopshte apo shkolla i vijnë nxënësit për regjistrim.				
		<b>5.1.2.</b> Shkolla bashkëpunon zyrtarisht me zyrën e gjendjes civile në qeverisjen lokale, si dhe me përfaqësuesin ligjor të zonës që ajo mbulon, lidhur me regjistrimet dhe detyrimin shkollor.				

		<b>5.1.3.</b> Regjistrimet në shkollë kryhen 2 javë përpara fillimit të vitit të ri shkollor.				
		<b>5.1.4.</b> Regjistrimi në klasën e parë të shkollës 9-vjeçare kryhet me anë të certifikatës së lindjes, certifikatës së vaksinimit, si dhe me dosjen e progresit të fëmijës në kopsht.				
		<b>5.1.5.</b> Regjistrimi në klasat e shkollës 9-vjeçare bëhet me anë të dëftesës.				
		<b>5.1.6.</b> Regjistrimi në klasat e gjimnazit bëhet me anë të dëftesës së lirimt të arsimit 9-vjeçar, bazuar dhe në zgjedhjet e lëndëve që nxënësi dhe prindi konfirmojnë me shkrim.				
		<b>5.1.7.</b> Regjistrimi i nxënësve që vijnë nga vende të tjera ose azilantë, bëhet me anë të dokumentit shkollor të sigluar nga DAR/ZA-ja, për klasën që vijon ose klasën pasardhëse, kur fillon viti i ri shkollor.				
		<b>5.1.8.</b> Shkolla ruan dokumentacionin e regjistrimit të nxënësit deri në përfundim të vitit shkollor.				
		<b>5.1.9.</b> Shkolla zbaton kriterin e moshës për lirimt e nxënësit nga detyrimi shkollor.				
		<b>5.1.10.</b> Shkolla zbaton procedura të rregullta për transferimet, pranimet apo largimet e nxënësve nga shkolla.				
		<b>5.1.11.</b> Shkolla përpunon të dhënat statistikore sipas formateve të DAR/ZA-së e MASH-it dhe i dërgon zyrtarisht në institucionet e prore.				
		<b>5.1.12.</b> Shkolla raporton në qeverisjen lokale dhe në DAR për nxënësit braktisës.				

Nënfusha 6	Treguesit	Instrumente	Nivelet e vlerësimit			
			1	2	3	4
<b>Vetëvlerësimi/ vlerësimi i brendshëm i shkollës</b>	1. Shkolla realizon vlerësimin e brendshëm.	<b>6.1.1.</b> Shkolla kryen vlerësimin e brendshëm.				
		<b>6.1.2.</b> Shkolla përdor të njëjtat fusha, tregues, instrumente vlerësimi, siç përdor dhe IKAP-i.				

		<b>6.1.3.</b> Shkolla realizon vlerësimin e brendshëm vjetor për 2-3 fusha, të cilat lidhen ngushtë me objektivat e planit të saj vjetor.				
		<b>6.1.4.</b> Secili mësues bën vetëvlerësimin e tij, duke përdorur instrumente standarde.				
		<b>6.1.5.</b> Ekipi kurrikular bën vlerësimin e punës së tij, duke përdorur instrumente standarde.				
		<b>6.1.6.</b> Shkolla përgatit çdo vit raportin e saj të vlerësimit të brendshëm sipas formatit standard.				
		<b>6.1.7.</b> Stafi mësimor është i përfshirë në procesin e vetëvlerësimit.				
		<b>6.1.8.</b> Raportet individuale të ekipeve lëndore dhe ai i shkollës paraqesin fushat dhe problemet që synohen të përmirësohen.				
		<b>6.1.9.</b> Dokumentacioni i mbledhur gjatë procesit të vetëvlerësimit identifikon përvojat e suksesshme.				
		<b>6.1.10.</b> Procesi i vetëvlerësimit në shkollë është karakterizuar nga ndershmëria dhe sinqeriteti.				
		<b>6.1.11.</b> Informacioni i mbledhur nga procesi i vetëvlerësimit është realist.				
		<b>6.1.12.</b> Në procesin e vetëvlerësimit janë marrë parasysh sugjerimet e Qeverisë së Nxënësve, Këshillit të Prindërve dhe Bordit të Shkollës.				
		<b>6.1.13.</b> Në procesin e vetëvlerësimit janë marrë në konsideratë sugjerimet e organeve të qeverisjes lokale dhe partnerëve të tjerë të shkollës.				
		<b>6.1.14.</b> Të dhënat e raportit të vetëvlerësimit paraqesin realisht gjendjen dhe problemet e shkollës.				
		<b>6.1.15.</b> Të dhënat e raportit të vetëvlerësimit përputhen në mënyrë të kënaqshme me vlerësimin e jashtëm të bërë nga IKAP-i.				

		<b>6.1.16.</b> Raporti vjetor i vetëvlerësimit ruhet në shkollë, aq sa zgjat dhe zbatimi i planit afatmesëm.				
		<b>6.1.17.</b> Shkolla e publikon raportin vjetor të vetëvlerësimit në faqen e saj të internetit, pas miratimit nga Bordi i Shkollës.				
		<b>6.1.18.</b> Raporti vjetor i vetëvlerësimit dërgohet në DAR/ZA dhe në IKAP.				

Nënfusha 7	Treguesit	Instrumente	Nivelet e vlerësimit			
			1	2	3	4
<b>Gjithëpërfshirja</b>	1. Drejtoria e shkollës përfshin të gjithë organizmat e saj në menazhimin e jetës së shkollës.	<b>7.1.1.</b> Në shkollë funksionojnë sipas Dispozitave Normative, të gjithë organizmat e saj: Këshilli i klasës, Këshilli i disiplinës, Këshilli i mësuesve, Këshilli i prindërve, Qeveria e Nxënësve, Bordi i Shkollës.				
		<b>7.1.2.</b> Secili organizëm ushtron të drejtat dhe detyrat e tij.				
		<b>7.1.3.</b> Nxënësit, mësuesit, prindërit dhe aktorë të tjerë të interesuar janë të përfshirë në veprimtaritë e organizmave të shkollës.				
		<b>7.1.4.</b> Drejtoria e shkollës nuk ndërhyr në zhvillimin e veprimtarive të secilit organizëm.				
		<b>7.1.5.</b> Secili organizëm në shkollë e zhvillon veprimtarinë e vet sipas një plani të caktuar.				
		<b>7.1.6.</b> Drejtoria e shkollës kërkon herë pas herë mendime dhe ide për çështje të menazhimit të shkollës.				
		<b>7.1.7.</b> Secili organizëm është i pavarur në shkollë.				
		<b>7.1.8.</b> Drejtoria e shkollës lehtëson zbatimin e veprimtarive të secilit organizëm të shkollës.				

Nënfusha 8	Treguesit	Instrumente	Nivelet e vlerësimit			
			1	2	3	4
<b>Puna në ekip</b>	1. Shkolla nxit punën në ekipe të personelit të saj.	<b>8.1.1.</b> Drejtoria e shkollës krijon ekipe pune për hartimin dhe zbatimin e planeve afatmesme, vjetore, mujore për menazhimin e saj.				
		<b>8.1.2.</b> Ekipet e punës në shkollë apo ekipet lëndore/ ekipi kurrikular punojnë bashkë për probleme të ndryshme të shkollës.				
		<b>8.1.3.</b> Ekipet lëndore/ ekipi kurrikular zhvillojnë vizita reciproke në orët e tyre mësimore.				
		<b>8.1.4.</b> Ekipet e mësuesve, drejtuesve, nxënësve përgatitin produkte pune që i shërbejnë menazhimit të shkollës.				
		<b>8.1.5.</b> Puna në ekip është pjesë e kulturës së punës në shkollë.				

## STANDARDI

Shkolla demonstroi kulturë të menazhimit profesional të saj. Ajo zbaton plane afatmesme dhe vjetore, të cilat përputhen me nevojat e saj reale për zhvillim dhe sigurim të cilësisë së arritjeve për nxënësit. Stafi i mësuesve, prindërit, komuniteti, Bordi i Shkollës dhe të gjitha organet e ndryshme vendimmarrëse brenda shkollës janë përfshirë në menazhimin e shkollës. Drejtoria e shkollës monitoron në mënyrë të vazhdueshme orët mësimore dhe plotësimin e dokumentacionit zyrtar shkollor. Shkolla ka një komunikim të brendshëm, kryen në kohë dhe me shpejtësi regjistrimin dhe transferimin e nxënësve të saj, duke përdorur një statistikë të rregullt dhe duke respektuar udhëzimet përkatëse. Shkolla realizon çdo vit vlerësimin e brendshëm, duke nxjerrë problemet, arritjet dhe nevojat për përmirësim, përmes një raporti të posaçëm.

Puna në ekip stimulohet dhe është pjesë organike e jetës profesionale të shkollës.

### NIVELI 1

Shkolla shfaq dukshëm një kulturë profesionale të menazhimit të saj. Ajo harton dhe zbaton, sipas formateve dhe kritereve të duhura profesionale, plane afatmesme dhe plane vjetore për zhvillimin e saj. Shkolla ka të identifikuar realisht nevojat e saj dhe përcakton synime dhe objektiva të qarta dhe të arritshme për

nxënësit. Arritjet e nxënësve janë objektiva parësorë të shkollës. Drejtorja e shkollës mbikëqyr vazhdimisht dhe realizon në përputhje me normat zyrtare planin e orëve të vëzhguara dhe monitoron procesin e plotësimit të saktë të dokumentacionit shkollor. Regjistrimi i nxënësve dhe transferimi i tyre është i dokumentuar dhe pjesë e përhershme e statistikave zyrtare të shkollës. Shkolla zotëron një kulturë pune për vlerësimin e brendshëm, duke përdorur forma dhe procedura profesionale, arrin të paraqesë gjendjen reale të shkollës në raportin vjetor të vetëvlerësimit. Puna në ekip dhe përfshirja e të gjithë stafit të shkollës, prindërve, përfaqësuesve të organizmave të tjerë të shkollës, si dhe bashkëpunimi me bordin e saj, qeverisjen vendore lokale apo arsimore janë pjesë e natyrshme e funksionimit të shkollës.

## **NIVELI 2**

Shkolla zbaton plane afatmesme dhe vjetore. Ato hartohen sipas formateve rekomanduese dhe synojnë ta zhvillojnë atë. Drejtorja e shkollës përmbush vazhdimisht planin e vëzhgimit të orëve mësimore dhe mbikëqyr në vijimësi plotësimin e dokumentacionit zyrtar (amza, regjistra etj.). Regjistrimi dhe transferimi i nxënësve kryhet me rregullsi; statistikën plotësohen në kohë dhe janë të sakta. Shkolla inicion vetëvlerësimin e saj, por ajo ka nevojë për mbështetje në realizimin e tij, sidomos në përgatitjen e raportit vjetor. Puna në ekip ka nevojë që të përmirësohet dhe duhet punuar më shumë për këtë proces. Prindërit dhe të gjitha grupet e interesit të shkollës ftohen të jenë pjesë e menazhimit të shkollës, por ky bashkëpunim nuk është i vazhdueshëm. Bordi i Shkollës dhe organizma të tjerë brenda shkollës përfshihen në jetën e shkollës, por ky proces nuk planifikohet dhe nuk ndiqet me përparësi.

## **NIVELI 3**

Shkolla përpaket të hartojë dhe të zbatojë plane afatmesme dhe plane vjetore. Ka shmangie dhe paqartësi në hartimin e tyre sipas kritereve dhe rekomandimeve. Shkolla nuk i ka të identifikuar qartë nevojat e saj. Ndihet nevoja e përfshirjes së të gjithë aktorëve socialë, si: prindërit, organizmat e shkollës, komuniteti, Bordi i Shkollës etj. që të kontribuojnë në menazhimin e saj. Kryhet plani i vëzhgimit të orëve mësimore, si dhe monitorohet plotësimi i dokumentacionit shkollor, por identifikohen në to mangësi dhe gjetje që bien ndesh me normat zyrtare. Vetëvlerësimi i shkollës është një proces që paraqet shumë vështirësi në realizimin e tij nga shkolla. Raporti vjetor i vetëvlerësimit është i mangët dhe nuk dëshmon realisht situatën dhe problematikën e shkollës. Puna në ekip është spontane dhe shkolla nuk bën përpjekje për të stimuluar këtë klimë bashkëpunimi. Shkolla ka nevojë për një plan emergjent të përmirësimit të fushës së menazhimit të saj.

#### **NIVELI 4**

Shkolla dëshmon dobësi të theksuara për hartimin e planeve afatmesme dhe vjetore të saj. Shkolla bën përpjekje për të zbatuar planin vjetor, por ka shumë mangësi në këtë proces. Kultura e bashkëpunimit është individuale dhe nuk arrihet që të identifikohen nevojat e saj për zhvillim. Drejtorja e shkollës është autoritare në menazhimin e saj. Shkolla përdor planin e vëshgimit të orëve mësimore apo të plotësimit të dokumentacionit zyrtar vetëm si mjet kontrolli për mësuesit. Shkolla nuk mban statistika të rregullta. Regjistrimet dhe transferimet nuk dokumentohen me rregull. Procesi i vetëvlerësimit nuk kryhet, madje shkolla nuk arrin të ketë raportin e saj vjetor të vlerësimit të brendshëm. Organizmat e shkollës apo aktorë të tjerë të interesuar për shkollën marrin pjesë shumë rrallë në jetën dhe zgjidhjen e problemeve të shkollës. Në gjendjen që është kjo fushë, duhet ndërhyrje e menjëhershme me një plan për mbështetjen e saj.

#### **FUSHA VI. ZHVILLIMI I BURIMEVE NJERËZORE**

*"Strukturat menazhuese të shkollave ekzistojnë për të ndihmuar shkollat që të realizojnë standardin më të mirë të mundshëm të edukimit të të gjithë nxënësve". Ato do t'i trajtojmë në dy drejtime: menazhimin e burimeve njerëzore dhe menazhimin financiar.*

##### **Menazhimi i burimeve njerëzore**

Zhvillimi social dhe edukativ i një shkolle varet nga zhvillimi i burimeve njerëzore të arsimuara dhe të kualifikuara, prandaj menazhimi i burimeve njerëzore duhet të jetë një nga elementet kyç të planifikimit strategjik për çdo shkollë. Shkollat dhe institucionet e tjera arsimore duhet të ndërtojnë infrastrukture të nevojshme të burimeve njerëzore që mbështetin dhe përmirësojnë sistemin arsimor. Personeli i një shkolle ka rëndësi jetësore në suksesin dhe mbarëvajtjen e mësimdhënies. Pa punonjës të efektshëm, çdo shkollë do të rrezikonte mbijetesën e saj.

Planifikimi i nevojave për burime njerëzore synon të përcaktojë nevojat e tashme dhe të ardhme të institucionit arsimor për to, si dhe t'u përgjigjet kërkesave që ky institucion ka ndaj komunitetit. Është e rëndësishme që planifikimi të kryhet sa më mirë, bazuar edhe në analizën e detajuar të vendeve të punës. Një planifikim i mirë i ndihmon punonjësit të parashikojnë sa më mirë mundësitë e tyre për karrierë.

Trajnimi dhe kualifikimi i mësuesve është një faktor i pandarë nga të gjitha strategjitë e zhvillimit të arsimit në vend. Trajnimet janë mjet zhvillimi profesional, bazuar në gjithëpërfshirjen e palëve të interesuara për të kontribuar në motivimin dhe nxitjen e mësuesve dhe drejtuesve për trajnim dhe certifikim, duke aplikuar titujt e karrierës profesionale. Mësuesi i kualifikuar punon me efektivitet për të përmirësuar cilësinë e arsimit.



Çdo politikë kualifikimi mbështetet mbi një analizë të programit të ndjekur më parë, nga ku dalin rezultatet, efektshmëria e metodave dhe formave të përdorura dhe gjenden format dhe metodat e reja të kualifikimit, në përputhje me ndryshimet e reja.

Trajnimi i mësuesve sipas profileve, cikleve dhe lëndëve, si dhe kualifikimi i tyre është një proces i vazhdueshëm i kuadrit mësimdhënës. Seancat e trajnimit dhe të kualifikimit të mësuesve konceptohen me një shtrirje gjithëvjetore, duke i kombinuar si teoriko-praktike.

### **Menazhimi i burimeve financiare**

Procesi i menazhimit të burimeve financiare për sistemin arsimor është tërësia e përgjegjësive të menazhimit që ushtrojnë njësitë e qeverisjes, për miratimin dhe zbatimin e rregullave dhe procedurave që sigurojnë përdorimin efektiv dhe ekonomik të burimeve financiare në dispozicion.

Burimet financiare janë kapitali që institucionet arsimore përdorin për të financuar si operacionet aktuale, edhe ato në të ardhmen për plotësimin e nevojave të tyre. Burimet për financimin e arsimit parauniversitar janë:

- a) Buxheti i shtetit;
- b) Burimet e qeverisjes vendore;
- c) Dhurimet dhe sponsorizimet;
- ç) Të ardhurat e përftuara nga shkollat;
- d) Tarifat e arsimit për institucionet arsimore private;
- dh) Të ardhura të tjera nga burime të ligjshme.

Krahas detyrave kryesore të mësimdhënies, shkollat e arsimit të detyruar e të mesëm publik mund të kryejnë edhe veprimtari ekonomike me përfitime financiare në fushat që kanë lidhje me zbatimin e programeve mësimore, në përputhje me dispozitat ligjore. Shkollat profesionale publike me qendra të përgatitjes praktike veprojnë si njësi ekonomike për realizimin e veprimtarisë prodhuese, të shërbimeve etj., duke kontaktuar me persona juridikë shtetërorë e privatë.

Procedura e grumbullimit, ruajtjes dhe e përdorimit të të ardhurave nga dhurimet e prindërve shpjegohet në Udhëzimin Nr. 29, datë. 25.09.2007.

### **Struktura Organizative**

Mësuesit e një shkolle do të kooperojnë në mënyrë efektive për realizimin e objektivave dhe planeve, në qoftë se ata i dinë mirë detyrat dhe rolet që do të luajnë, si dhe mënyrën se si lidhen midis tyre këto detyra e këto role. Pra, që të përdoren me efektivitet burimet e një institucioni arsimor, duhet fillimisht të bëhet ai që quhet organizim i punës.

Organizimi është procesi i identifikimit të detyrave të nevojshme, të cilat duhet të kryhen në mënyrë që institucioni arsimor të arrijë objektivat e marra, si dhe të funksionojë në mënyrën më të mirë.

### **Vlerësimi dhe motivimi**

Pasi është përzgjedhur dhe është marrë në punë personeli i një shkolle, duhet bërë vlerësimi dhe motivimi i tij. Vetëm kur ndihen të vlerësuar dhe të motivuar, mësuesit mund të punojnë me efektivitet. Vlerësimi i mësuesve është një proces që ndodh vazhdimisht.

Sistemet e vlerësimit përcaktohen si aktivitete të planifikuara, të organizuara dhe të kontrolluara, të bëra me qëllim që të vrojtohet, të matet, të gjykohet dhe të përmirësohet kontributi i mësuesve në objektivat e shkollës. Një sistem vlerësimi duhet të përmbajë: objektivat e vlerësimit, kriteret dhe normat e vlerësimit, si dhe metodat që do të përdoren.

### **Aktorët përgjegjës për drejtimin dhe menazhimin e burimeve njerëzore dhe financiare në shkollë**

#### **a) Drejtori i shkollës**

Drejtorët e shkollave të arsimit parauniversitar publik emërohen nga strukturat përkatëse të dekoncentruara të Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës. Ata janë drejtues mësimorë dhe administrues të institucioneve arsimore.

Lidhur me këtë fushë, drejtorët kryejnë këto detyra:

- Organizojnë, planifikojnë dhe administrojnë aktivitetet e institucioneve parashkollore ose shkollave;
- Administrojnë punën e stafit mësimor;
- Bashkëpunojnë me Bordin e Shkollës në përmbushjen e roleve të tij;
- Inkurajojnë trajnimin e mësuesve;
- Mbikëqyrin punën e stafit ndihmës (psikologut të shkollës, punonjësit social e shëndetësor);
- Përkrahin bashkëpunimin mes shkollës dhe prindërve etj.

#### **b) Bordi i Shkollës**

Misioni i Bordit të Shkollës synon të sigurojë që shërbimi shkollor të kryhet sipas politikave arsimore kombëtare e lokale dhe interesave të komunitetit të shkollës. Bordi i Shkollës përbëhet nga prindër të nxënësve dhe nxënës të asaj shkolle, përfaqësues të komunitetit shkollor që nuk janë prindër të nxënësve të asaj shkolle (të jashtëm), përfaqësues të Drejtorisë Arsimore/Zyrës Arsimore përkatëse, përfaqësues të qeverisë vendore përkatëse, mësues të asaj shkolle. Përgjegjësinë për ngritjen e Bordit të Shkollës e ka Drejtoria Arsimore Rajonale ose Zyra Arsimore përkatëse. Numri i anëtarëve të bordit varet nga numri i nxënësve të shkollës dhe përcaktohet si më poshtë:

Kur numri i nxënësve të shkollës është më i vogël se 300 nxënës, atëherë numri i anëtarëve të bordit është 7; nga 300 deri në 999 nxënës, numri i anëtarëve është 9 dhe me më shumë se 1000 nxënës, numri i anëtarëve të bordit është 11.

Bordi i Shkollës ngrihet menjëherë pas ngritjes së qeverive të nxënësve, këshillave të prindërve të klasave dhe këshillit të prindërve të shkollës.

Bordi ka si detyra kryesore:

- Miratimin e planit afatmesëm të shkollës;
- Miratimin e planit vjetor të shkollës;
- Miratimin e buxhetit të shkollës (fondet publike, kontributet e komunitetit ose të donatorëve, të ardhurat nga veprimtaritë e shkollës);
- Miratimin e rregullores së brendshme të shkollës;
- Miratimin e kurrikulës në nivel shkolle;
- Miratimin e raportit vjetor dhe raportit financiar të shkollës.

### **Përfshirja e Bordit në hartimin e planit të shkollës (vjetor/afatmesëm).**

Një ndër detyrat kryesore të bordit është miratimi i planit afatmesëm e vjetor të shkollës.

Miratimi i planit vjetor të shkollës kalon në dy faza.

*Faza e parë:*

Plani kalon për miratim në Bordin e Shkollës. Nëse Bordi nuk e miraton versionin e parë të planit, atëherë ai duhet rishikuar derisa bordi ta miratojë. Kryetari i Bordit e firmos planin e miratuar nga Bordi.

*Faza e dytë:*

Me firmën e drejtorit të shkollës dhe kryetarit të Bordit të Shkollës, plani kalon për miratim në DAR. DAR-i mund ta kthejë për rishikim planin, nëse argumenton se nuk ka pasqyruar mirë politikën qendrore dhe lokale arsimore ose ka objektiva me pretendime të ulëta.

Për vlerësimin e fushës së "Zhvillimit të burimeve njerëzore dhe financiare", janë përdorur **katër nënfusha:**

- 1. Trajnimi dhe kualifikimi i personelit arsimor,**
- 2. Efektiviteti i personelit,**
- 3. Efektiviteti i përdorimit të financave,**
- 4. Marrëdhëniet e shkollës me të tretët,**

ku secila prej tyre do të matet me anë të treguesve respektivë.

### **Nënfushat**

#### **1. Trajnimi dhe kualifikimi i personelit arsimor**

Stafi drejtues ka përgjegjësi të qartë dhe njëkohësisht edhe angazhim për trajnimin dhe kualifikimin e stafit të shkollës. Nevojat për trajnim dhe kualifikim për të gjithë stafin identifikohen në kohë dhe marrin parasysh, në mënyrë të ekuilibruar, raportet në të gjithë shkollën, ekipet kurrikulare, si dhe nevojat individuale.

Për këtë punohet në sistem në të gjitha nivelet për identifikimin e sukseseve dhe të kërkesave, duke hartuar një plan trajnimi të specifikuar për çdo grup interesi dhe për personat/subjektet që do të bëjnë supervizionin e tyre. Stafit është plotësisht i ndërgjegjshëm për qëllimet dhe prioritetet e trajnimit dhe kualifikimit. Aktivitetet e planifikuara në planin vjetor të shkollës ose dhe atë afatmesëm të saj (mbi trajnimet dhe kualifikimet) ndiqen dhe vlerësohen, ndërsa arritjet përdoren për të ndikuar në planet e së ardhmes.

Shkolla krijon mundësitë për trajnimin dhe kualifikimin profesional të secilit anëtar të stafit mësimor. Një mënyrë për realizimin e tij është edhe trajnimi i brendshëm, i cili ndikon në rritjen e profesionalizmit të mësuesve, duke angazhuar mësuesit që të ndajnë përvojat e tyre, të fituara nga trajnimet e kualifikimet, por edhe nga eksperiencia personale. Gjithashtu, trajnimi i brendshëm i mësuesve në shkollë është një faktor i rëndësishëm për një mësimdhënie të suksesshme. Trajnimi brenda shkollës zhvillohet në dy drejtime:

- a) Me anën e vetëtrajnitimit (trajnitimit të organizuar),
- b) Me kualifikim sipas specialitetit (kualifikimin e përgjithshëm).

Për të parën e ka në dorë vetë mësuesi. Ai është i interesuar që këtë ta bëjë duke menduar që nuk i shërben vetëm vetes, por më shumë, ky trajnim do të reflektohet në punën e tij me nxënësit.

Sa më i kualifikuar të jetë një mësues, aq më shumë hapësira gjen ai për të zbatuar metoda efikase në drejtim të mësimin e të edukimit.

Kualifikimi i mësuesve sipas specialitetit realizohet pranë institucioneve të licensuara, të cilat i pajisin në fund me një dëshmi që shihet me përparësi nga institucionet arsimore. Për kualifikimin e mësuesve sipas shkallëve në bazë të profilit, fillimisht jepet literatura përkatëse, si tekstet, programet etj., më pas mësuesi i nënshtrohet provimit që nëse e merr, fiton një shkallë më lart, në rast të kundërt rri aty ku është. Përmbajtja e programeve për formim profesional fillestar dhe në vazhdim, duhet të pasqyrojë rëndësinë e rrugëve të bashkëpunimit ndërdisiplinor mësimor dhe metodologjik.

Kriteret ku bazohet kualifikimi i mësuesve janë:

- a) Përgatitja profesionale,
- b) Përgatitja shkencore.

Për mësuesit e rinj planifikohet një punë e veçantë dhe e integruar, për t'í familjarizuar me të gjitha aspektet e programit shkollor, rregulloret e MASH-it dhe krijimin e lidhjeve profesionale me kolegët.

Qëllimet e trajnimit dhe të kualifikimit të mësuesve janë:

- Përmirësimi i cilësisë dhe efektshmërisë së sistemit të arsimit;
- Sigurimi i qasjes në informata dhe teknologji informative;
- Shfrytëzimi më i mirë i burimeve njerëzore dhe financiare;
- Krijimi i një mjedisi të hapur për nxënie dhe stimulim;
- Përkrahje për qytetari aktive;

- Hapja e sistemit të arsimit dhe të trajnimit drejt botës së jashtme;
- Përmirësimi i bashkëpunimit midis anëtarëve të stafit pedagogjik.

## **2. Efektiviteti dhe efienca e personelit**

Mësuesit japin ndihmesë efektive në punën e shkollës dhe të ekipeve lëndore. Ata punojnë së bashku në grup për realizimin e programit edukativ-mësimor dhe përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së shkollës.

Drejtorja e shkollës siguron përfshirjen e stafit në hartimin e planit të punës dhe në këtë mënyrë arrihet mbështetja e atyre që duhet ta zbatojnë këtë plan. Koherenca në organizimin e punës dhe realizimi i ndryshimeve presupozon se mësuesit punojnë bashkarisht. Prandaj, drejtorja e shkollës nxit kooperimin me anë të formave organizative që kërkojnë punë në grup të mësuesve.

Bashkëpunimi për problemet e klasës përfshin jo vetëm ato me karakter mësimor, por edhe ato edukative dhe të kujdesit shëndetësor.

Detyrat e stafit ndihmës (shëndetësor, psikologjik etj.) përcaktohen me kujdes në mënyrë që të kuptohen dhe realizohen plotësisht prej tij. Asistenca shëndetësore ndihmon efektivisht për një edukim të gjerë të nxënësve. Shkolla, gjithashtu, mban lidhje efektive edhe me psikologë e punonjës socialë. Këshillat dhe ndihma e tyre janë mjaft të rëndësishme në ecurinë e mbarëvajtjes së nxënësve në shkollë.

## **3. Efektiviteti dhe efienca e përdorimit të financave**

Funksioni i shkollës është të aftësojë nxënësit për të mësuar. Por, për arritjen e këtij objektiv, përveç të tjerave, duhen siguruar burimet e nevojshme. Shkolla përdor me eficiencë burimet materiale dhe financiare duke menazhuar efektivisht kontributet e marra nga komuniteti, bizneset dhe autoritetet lokale. Shkollat e arsimit të detyruar e të mesëm publik financohen nga buxheti i shtetit, si dhe të ardhurat që sigurojnë nga kontributet e komunitetit, biznesit, donatorëve të ndryshëm, si dhe projekteve të aplikuara nga shkolla tek MASH-i, DAR/ZA-ja, qeveria lokale, OJF-të etj. Shkollat mund të kryejnë edhe veprimtari ekonomike me përfitime financiare në fushat që kanë lidhje me zbatimin e programeve mësimore në përputhje me dispozitat ligjore. Arsimi dhe formimi profesional publik financohet nga Buxheti i Shtetit, buxheti i pushtetit vendor, programet kombëtare dhe ndërkombëtare për arsimin dhe formimin profesional, kontributet e shoqatave të punëdhënësve dhe të punëmarrësve, kontributet e dhuruesve, sponsorizimet dhe burime të tjera të lejuara nga ligji. Shkollat profesionale publike me qendra të përgatitjes praktike veprojnë si njësi ekonomike për realizimin e veprimtarisë prodhuese, të shërbimeve etj., duke kontraktuar me persona juridikë shtetërorë e privatë, të cilët u krijojnë kushte të përshtatshme për kryerjen e këtyre praktikave, sipas specialiteteve të nxënësve. Marrëdhëniet që rrjedhin nga ky bashkëpunim, rregullohen me marrëveshje ndërmjet palëve të interesuara drejtpërsëdrejti ose institucioneve përfaqësuese të tyre. Shkolla realizon përdorimin me efektivitet të financave të siguruar për pasurimin e mjeteve didaktike, pasurimin e literaturës së bibliotekës së shkollës, mirëmbajtjen e ambienteve dhe organizimin e veprimtarive të ndryshme të karakterit mësimor-edukativ, në përputhje me

planin vjetor të miratuar prej saj. Shkolla, me qëllim përdorimin efikas të parave të mbledhura nga të gjithë donatorët, ngre Komisionin e Blerjeve të shkollës, të përbërë nga kryetari, i cili është drejtori i shkollës, 2-4 mësues si anëtarë, të cilët votohen në Këshillin Pedagogjik, si dhe një përfaqësues i qeverisë së nxënësve. Blerjet kryhen nga anëtarët e Komisionit të Blerjeve dhe shoqërohen me faturat përkatëse, të cilat ruhen në dokumentacionin e shkollës për 3 vjet. Për të gjitha shpenzimet e bëra prej saj, shkolla disponon dokumentacionin përkatës dhe afishon në një mjedis të dukshëm Tabelën e Transparencës të shpenzimeve kyç, në mënyrë që të gjithë të interesuarit të njihen me mënyrën e menazhimit të të ardhurave të grumbulluara dhe të përdorura prej saj. Një nga detyrat e Bordit të Shkollës është dhe miratimi i buxhetit të shkollës dhe menazhimi i burimeve financiare (fondeve publike, kontributet e komunitetit ose të donatorëve, të ardhurat nga veprimtaritë e shkollës etj.). Në këtë rast, Bordi i Shkollës përgatit një plan veprimtarish që aprovohet nga ky bord.

#### **4. Marrëdhëniet e shkollës me të tretët**

Shkolla si institucion ka lidhje dhe bashkëpunon në radhë të parë me DAR/ZA-në, sipas zonës ku ajo ndodhet, por dhe me qeverisjen lokale, bashki apo komunë. Veç këtyre, ajo bashkëpunon me komunitetin, biznesin dhe donatorë të tjerë, si dhe me shoqata dhe organizata të ndryshme jofitimprurëse që veprojnë në fushën e edukimit. Ajo mund të bashkëpunojë me universitete për nevoja të caktuara të saj, por edhe të bëjë binjakëzime me shkolla analoge. Studimet kanë provuar se shkollat veprojnë më mirë nëse komuniteti, prindërit në veçanti, janë të përfshirë në funksionimin e shkollës. Nëpërmjet bashkëpunimit dhe partnershipit me prindërit gjenerohen përfitime që vlerësohen nga të gjithë. Kontributet e komunitetit, biznesit dhe donatorëve mund të jenë në lekë, materiale dhe me punë vullnetare. Bashkëpunimet e shkollës me OJF-të konsistojnë kryesisht në këto drejtime:

- Trajnimi dhe kualifikimi i stafit pedagogjik, me qëllim përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies;
- Mbështetja financiare e projekteve të parashikuara në planin e punës së shkollës;
- Trajnimi i stafit të mësuesve që punojnë me fëmijët me vështirësi në të nxënë, si dhe me aftësi të kufizuara mendore dhe fizike;
- Mbështetja me bazë materiale e mjedisit ku mësojnë dhe edukohen fëmijët me vështirësi në të nxënë, si dhe me aftësi të kufizuara mendore dhe fizike;
- Binjakëzimi me shkollat analoge, për zhvillimin e veprimtarive të përbashkëta me përfitim reciprok.

Nënfusha 1	Treguesit	Instrumente	Nivelet e vlerësimit			
			1	2	3	4
<b>Kualifikimi dhe trajnimi i stafit</b>	1. Shkolla identifikon nevojat e stafit për trajnim.	<b>1.1.1.</b> Mësuesit e dëshirojnë trajnimin.				
		<b>1.1.2.</b> Është bërë identifikimi i nevojave reale të stafit për trajnime.				
		<b>1.1.3.</b> Janë përcaktuar drejtimet dhe kërkesat e mësuesve për trajnim.				
		<b>1.1.4.</b> Nuk ka ndryshime mes nevojave për trajnim të identifikuar nga drejtoria dhe atyre të kërkuara nga mësuesit.				
		<b>1.1.5.</b> Shkolla ka të dhëna të sakta të shkallëve të kualifikimit, të fituara nga personeli i saj mësimor.				
		<b>1.1.6.</b> Shkolla komunikon me institucionin e DAR/ZA-së për nevojat e identifikuar.				
	2. Shkolla realizon planifikimin e trajnimit dhe mbështet kualifikimin e stafit.	<b>1.2.1.</b> Shkolla zhvillon trajnime për stafin e saj, sipas një plani të posaçëm.				
		<b>1.2.2.</b> Shkolla përcakton grupe mësuesish për trajnime, sipas nevojave të tyre.				
		<b>1.2.3.</b> Shkolla bashkëpunon me specialistë apo institucione që ofrojnë ndihmë në drejtim të trajnimit të stafit.				
		<b>1.2.4.</b> Shkolla mbështet me përparësi mësuesit që do t'i nënshtrohen kualifikimit për fitimin e një shkalle më të lartë.				
		<b>1.2.5.</b> Shkolla zhvillon programe trajnime në bashkëpunim me DAR/ZA-në, donatorë të arsimit, universitetet ose OJF-të e akredituara.				

	3. Shkolla kujdeset për shkëmbimin e përvojës së trajnimit dhe të kualifikimit të personelit.	<b>1.3.1.</b> Shkolla ka plan pune për shkëmbimet e përvojave profesionale të mësuesve midis dhe brenda ekipeve lëndore.				
		<b>1.3.2.</b> Shkolla nxit dhe organizon veprimtari profesionale midis mësuesve të shkollë.				
		<b>1.3.3.</b> Shkolla kujdeset që mësuesit e rinj gjatë vitit të parë të punës, të udhëhiqen nga tutorë, mentorë, anëtarë të drejtorisë apo dhe mësues me përvojë.				

Nënfusha 2	Treguesit	Instrumente	Nivelet e vlerësimit			
			1	2	3	4
<b>Efektiviteti dhe eficientia e personelit</b>	1. Shkolla bën planifikimin e nevojave të saj për burime njerëzore.	<b>2.1.1.</b> Shkolla identifikon çdo vit nevojat e saj për personel mësimor.				
		<b>2.1.2.</b> Shkolla identifikon çdo vit nevojat e saj për staf ndihmës (psikolog, punonjës shëndetësor).				
		<b>2.1.3.</b> Shkolla mbulon dhe plotëson në çdo kohë mungesat e stafit, duke e parandaluar humbjen e orëve mësimore.				
		<b>2.1.4.</b> Shkolla komunikon me DAR/ZA-në dhe siguron personelin e nevojshëm për zhvillimin normal të procesit mësimor.				
	2. Shkolla mundëson përfshirjen e stafit në hartimin e planit vjetor.	<b>2.2.1.</b> I gjithë personeli arsimor i shkollës është i përfshirë në hartimin e planit vjetor.				
	3. Shkolla realizon ndarjen e qartë të roleve dhe detyrave të personelit.	<b>2.3.1.</b> Shkolla i ka të përcaktuara qartë detyrat për personelin e saj.				
		<b>2.3.2.</b> Shkolla i ka të dokumentuara detyrat e personelit të saj.				



		<b>2.3.3.</b> Mësuesi është pjesë aktive e ekipit lëndor dhe e këshillit të mësuesve.				
		<b>2.3.4.</b> Mësuesit, në bashkëpunim me ekipin lëndor, vendosin prioritetet lëndore (objektivat) dhe praktikën e punës për realizimin e tyre.				
		<b>2.3.5.</b> Mësuesi stimulon dhe është pjesëmarrës aktiv në veprimtaritë kroskurrikulare që organizon ekipi i tij dhe shkolla në tërësi.				
		<b>2.3.6.</b> Mësuesi harton dhe zbaton me përgjegjësi planin e punës edukative me klasën e vet.				
	4. Shkolla mundëson përfshirjen e stafit ndihmës në jetën e saj.	<b>2.4.1.</b> Shkolla mundëson bashkëpunimin e psikologut dhe punonjësit shëndetësor me nxënësit.				
		<b>2.4.2.</b> Shkolla zbaton plane veprimi për shkëmbimet profesionale të psikologut dhe punonjësit shëndetësor me mësuesit kujdestar.				
		<b>2.4.3.</b> Shkolla krijon kushtet e domosdoshme për mbështetjen e punës së psikologut dhe personelit shëndetësor.				

Nënfusha 3	Treguesit	Instrumente	Nivelet e vlerësimit			
			1	2	3	4
<b>Efektiviteti dhe eficientia e përdorimit të financave</b>	1. Shkolla realizon përdorimin efektiv të financave të saj.	<b>3.1.1.</b> Komisioni i blerjeve kryen blerje transparente.				
		<b>3.1.2.</b> Përdorimi i financave i shërben prioritetëve të përcaktuara në planin vjetor të shkollës.				
	2. Shkolla disponon dokumentacionin e përdorimit të fondeve të saj.	<b>3.2.1.</b> Shkolla e ka të dokumentuar përdorimin e fondeve.				
		<b>3.2.2.</b> Shkolla disponon urdhërpagesa për shpenzimet e kryera.				
		<b>3.2.3.</b> Shkolla disponon fatura tatimore për blerjet e bëra.				
	3. Tabela e transparencës për shpenzimet e kryera afishohet në mjediset e shkollës.	<b>3.3.1.</b> Shkolla ka të ekspozuar transparencën e shpenzimeve financiare të buxhetit, në një mjedis të dukshëm për të gjitha grupet e interesit.				

	4. Shkolla bën planifikimin e nevojave të saj për materiale.	<b>3.4.1.</b> Shkolla identifikon çdo vit mësimor nevojat e saj për bazë materiale mësimore apo mjete.				
		<b>3.4.2.</b> Shkolla përcakton çdo vit mësimor listën e mjeteve didaktike mësimore që i nevojitet dhe ia dërgon DAR/ZA-së.				
		<b>3.4.3.</b> Shkolla përcakton çdo vit mësimor listën e literaturës artistike, profesionale, didaktike dhe shkencore që i nevojitet dhe ia dërgon DAR/ZA-së.				
	5. Bordi i Shkollës është i përfshirë në hartimin e planit vjetor/afatmesëm.	<b>3.5.1.</b> Bordi i Shkollës përfshihet në hartimin e planit vjetor dhe afatmesëm të saj.				
		<b>3.5.2.</b> Bordi i Shkollës miraton planin afatmesëm dhe atë vjetor të shkollës.				
	6. Bordi i Shkollës është i përfshirë në menazhimin e burimeve financiare.	<b>3.6.1.</b> Bordi i Shkollës miraton shpenzimet financiare të buxhetit të shkollës.				
<b>3.6.2.</b> Bordi i Shkollës monitoron procesin e blerjeve të kryera nga shkolla.						

Nënfusha 4	Treguesit	Instrumente	Nivelet e vlerësimit			
			1	2	3	4
<b>Marrëdhënia me të tretët</b>	1. Shkolla mundëson përfshirjen e komunitetit në jetën e saj.	<b>4.1.1.</b> Shkolla planifikon veprimtari për përfshirjen e komunitetit në jetën e shkollës.				
		<b>4.1.2.</b> Shkolla informon rregullisht prindërit për problemet e shkollës.				
		<b>4.1.3.</b> Shkolla ofron mjediset dhe materialet e saj për nevojat e komunitetit.				
	2. Shkolla bashkëpunon me shkolla të tjera dhe institucione që ofrojnë trajnime e kualifikime.	<b>4.2.1.</b> Shkolla bashkëpunon me DAR/ZA-në për trajnimet dhe kualifikimet e stafit.				
		<b>4.2.2.</b> Shkolla bashkëpunon me institucione që ofrojnë trajnime (OJF, universitete, agjenci të akredituara).				

3. Shkolla bashkëpunon me institucione që ndihmojnë në përmirësimin dhe zhvillimin e saj.	4.3.1. Shkolla bashkëpunon me institucionet e qeverisjes lokale.				
	4.3.2. Shkolla është e binjakëzuar me shkolla analoge brenda apo jashtë vendit.				
	4.3.3. Shkolla ka të dokumentuara të gjitha bashkëpunimet e saj me të tretët.				

## STANDARDI

Shkolla bën identifikimin dhe planifikimin e nevojave për burime njerëzore dhe për kualifikimin në nivel individual, ekipi lëndor dhe shkollë. Ajo ka një staf mësimor që realizon programin e kurrikulës për të gjithë nxënësit. Anëtarët e stafit në tërësi kanë kualifikimet e duhura, aftësitë dhe trajnimet që lidhen me nevojat e shkollës dhe të nxënësve të. Mësuesit japin kontribute efektive në punën e shkollës apo të ekipit lëndor. Bashkëpunimi ndërmjet anëtarëve të stafit është shumë i mirë (shkëmbim eksperience, punë në grup). Mësuesit, në punën e tyre, mbështeten nga një staf i mjaftueshëm ndihmës, si: punonjësi shëndetësor dhe psikologu.

Shkolla realizon përdorimin efektiv dhe transparent të financave, në mbështetje të punës së saj dhe të ekipeve lëndore. Prioritetet për harxhimin dhe përdorimin e burimeve financiare lidhen në mënyrë të qartë me prioritetet e planit të punës së shkollës dhe reflektojnë objektivat mësimorë të saj. Konsideratat për vlerat monetare merren parasysh gjatë marrjes së vendimeve për shpenzime. Shkolla ka në dispozicion për përdorim burimet materiale të nevojshme, si: librat, materialet praktike, burimet audiovizive, kompjuterat etj.

Drejtori ndërton lidhje me Bordin e Shkollës dhe nxit aktivisht anëtarët e bordit për t'u njohur dhe për t'u përfshirë në jetën e shkollës. Bashkëpunimi gjeneron përfitime thelbësore dhe vlerësohet nga të gjithë. Kryhen hapa pozitiv për verifikimin e pikëpamjeve të komunitetit, prindërve për aspektet e punës së shkollës dhe ndërmerren veprime të përshtatshme në përgjigje të tyre. Shkolla organizon një sërë aktivitetesh ku merr pjesë edhe komuniteti. Kur është e nevojshme, shkolla aftëson anëtarët e komunitetit për t'u angazhuar në veprimtari mësimore.

Shkolla bashkëpunon me shkolla dhe institucione të tjera arsimore, të cilat ofrojnë trajnime me qëllim përmirësimin dhe zhvillimin e arsimit.

## NIVELI 1

Shkolla bën identifikimin dhe planifikimin e nevojave për burime njerëzore dhe për kualifikimin në nivel individual, ekipi lëndor dhe shkollë. Ajo ka një staf të mjaftueshëm mësimor, i cili realizon programin e kurrikulës

për të gjithë nxënësit. Anëtarët e stafit kanë kualifikimet e duhura, aftësitë dhe trajnimet që kanë lidhje me nevojat e shkollës dhe të nxënësve. Mësuesit japin kontribute efektive në punën e shkollës apo të ekipit lëndor. Bashkëpunimi ndërmjet anëtarëve të stafit është shumë i mirë (shkëmbim eksperience, punë në grup). Mësuesit, në punën e tyre, mbështeten nga një staf i mjaftueshëm ndihmës, si: punonjësi shëndetësor dhe psikologu. Shkolla përdor me efektivitet dhe transparencë financat që zotëron. Prioritetet për harxhimin dhe përdorimin e burimeve financiare lidhen në mënyrë të qartë me prioritetet e planit të punës së shkollës dhe reflektojnë objektivat mësimorë të saj. Konsideratat për vlerat monetare merren parasysh gjatë marrjes së vendimeve për shpenzime. Burime materiale të nevojshme, si: librat, materialet praktike, burimet audiovizive, kompjuerat etj., janë në dispozicion për përdorim. Drejtori krijon lidhje me Bordin e Shkollës dhe inkurajon aktivisht anëtarët e bordit për t'u njohur dhe për t'u përfshirë në jetën e shkollës. Bëhen hapa pozitiv për verifikimin e pikëpamjeve të komunitetit, prindërve për aspektet e punës së shkollës dhe ndërmerren veprime të përshtatshme në përgjigje të tyre. Shkolla organizon një sërë aktivitete, në të cilat merr pjesë komuniteti. Kur është e nevojshme, shkolla aftëson anëtarët e komunitetit për t'u angazhuar në veprimtari mësimore.

Shkolla bashkëpunon me shkolla dhe institucione të tjera arsimore, të cilat ofrojnë trajnime me qëllim përmirësimin dhe zhvillimin e arsimit.

## **NIVELI 2**

Shkolla bën identifikimin dhe planifikimin e nevojave për burime njerëzore dhe për kualifikimin në nivel individual, ekipi lëndor dhe shkolle. Stafit mësimor realizon programin e kurrikulës për të gjithë nxënësit. Anëtarët e stafit kanë kualifikime, aftësi dhe trajnime. Mësuesit japin kontribute në punën e shkollës apo të ekipit lëndor. Mësuesit mbështeten në punën e tyre nga një staf ndihmës, si: punonjësi shëndetësor dhe psikologu.

Shkolla përdor me efektivitet financat e saj, por procesi nuk është transparent për të gjithë të interesuarit. Prioritetet për harxhimin dhe përdorimin e burimeve financiare lidhen kryesisht me prioritetet e planit të punës së shkollës. Vlerat monetare merren parasysh gjatë marrjes së vendimeve për shpenzime. Shkolla ka në dispozicion për përdorim një pjesë të mirë të burimeve materiale të nevojshme, si: librat, materialet praktike, burimet audiovizive, kompjuerat etj. Drejtori krijon lidhje me Bordin e Shkollës dhe bën përpjekje për inkurajimin e anëtarëve të tij, për t'u përfshirë në jetën e shkollës. Shkolla organizon disa aktivitete ku përfshihet komuniteti dhe bashkëpunon me shkolla dhe institucione të tjera arsimore për përmirësimin dhe mbarëvajtjen e saj.

### **NIVELI 3**

Shkolla nuk ka burime njerëzore të mjaftueshme për të plotësuar në çdo kohë mungesat e stafit, për parandalimin e humbjeve të orëve mësimore dhe realizimin e kurrikulës për të gjithë nxënësit. Një pjesë e anëtarëve të stafit nuk kanë kualifikimin e nevojshëm dhe nuk përfshihen në trajnime që kanë lidhje me nevojat e shkollës dhe të nxënësve. Shkolla nuk nxit bashkëpunimin dhe shkëmbimin e përvojave profesionale ndërmjet mësuesve. Efektiviteti i veprimtarisë së stafit ndihmës, si: punonjësi shëndetësor dhe psikologu nuk është eficient. Përdorimi i financave të shkollës nuk është në funksion të mbështetjes së punës së saj apo të ekipit lëndor. Konsideratat për vlerat monetare nuk merren parasysh gjatë marrjes së vendimeve për shpenzime. Shkolla ka në dispozicion për përdorim disa prej burimeve materiale të nevojshme, si: librat, materialet praktike, burimet audiovizive, kompjuerat etj. Bordi i Shkollës rezulton i ngritur si strukturë, por nuk përfshihet në veprimtaritë dhe vendimmarrjet e shkollës. Shkolla nuk ka një plan aktivitetesh ku të përfshihet komuniteti. Shkolla synon krijimin e lidhjeve dhe bashkëpunimin me shkolla dhe institucione të tjera arsimore, por ato nuk rezultojnë efektive.

### **NIVELI 4**

Shkolla nuk ka bërë identifikimin dhe planifikimin e nevojave të shkollës për burime njerëzore dhe për kualifikim. Stafi mësimor nuk është eficient në realizimin e kurrikulës. Mungon bashkëpunimi ndërmjet anëtarëve të stafit, për shkëmbimin e eksperiencës dhe punën në grup. Shkolla nuk ofron staf ndihmës, si: punonjësin shëndetësor dhe psikologun. Shkolla nuk realizon përdorimin efektiv dhe transparent të financave të saj, në mbështetje të punës së shkollës dhe ekipeve lëndore. Ajo nuk ka në dispozicion për përdorim burimet materiale të nevojshme, si: materialet praktike, burimet audiovizive, kompjuerat etj. Mungon struktura e Bordit të Shkollës. Shkolla nuk ka një plan aktivitetesh ku të përfshihet komuniteti dhe nuk ka krijuar lidhje bashkëpunimi me institucione të tjera arsimore, me qëllim përmirësimin dhe zhvillimin e saj.

## **FUSHA VII. VLERËSIMI I NXËNËSVE DHE ARRITJET**

Vlerësimi i nxënësve përshkon gjithë procesin mësimor dhe tregon dy anë të mësimdhënies: nevojat dhe aftësitë e nxënësve.

Vlerësimi mbështetet tërësisht te objektivat e programit lëndor, pra shkolla dhe mësuesi vlerësojnë nxënësit për ato objektiva të arritjes që janë përshkruar në program.

*Objekt i vlerësimit* janë njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet e nxënësit. Mësuesi vlerëson kompetencat e

nxënësit në komunikimin me shkrim e me gojë, duke “parë” hap pas hapi çdo aftësi e arritje të tij.

Vlerësimi i nxënësit është një proces i vazhdueshëm dhe gjithëpërfshirës që kërkon një planifikim të kujdesshëm dhe zbatim sistematik, të mbështetur në parametra bashkëkohorë.

Vlerësimi drejton të nxënit e nxënësve dhe nuk ka për qëllim të vetëm notën e as përfundon me vendosjen e saj.

Vlerësimi bazohet te “Udhëzuesi për vlerësimin e nxënësit”, Dispozitat Normative dhe udhëzimet zyrtare të MASH-it.

*Vlerësimi përdoret:*

- për të siguruar informacionin e nevojshëm dhe shumë të rëndësishëm për përparimin e nxënësve, motivimin e tyre drejt të mësuarit, si dhe për të përcaktuar mundësitë reale të nxënësve për nxënie të mëtejshme;

- për të vlerësuar përparësitë, dobësitë në arritjet e nxënësve dhe për të zbuluar shkaktarët e situatës së dhënë;

- për të nxjerrë të dhëna mbi arritjet përfundimtare të nxënësve gjatë të mësuarit.

*Vlerësimi kërkon:*

- objektiva të qartë mësimorë; njohjen e përvojës dhe të aftësive të nxënësve;

- kërkesa të qarta ndaj nxënësve;

- përdorimin e metodave dhe teknikave mësimore efikase;

- motivimin e nxënësve.

Vlerësimi mbështetet në parime që e bëjnë atë të jetë një aktivitet i planifikuar, i vazhdueshëm dhe pjesë integrale e praktikave më të mira të procesit të mësimdhënies dhe të nxënies.

*Vlerësimi mbështetet në:*

a) *Matje të bazuara në norma* të cilat krahasojnë të dhënat vlerësuese me të dhënat që janë tipike. Ky vlerësim tregon gjendjen përkundrejt normës.

b) *Matje të bazuara në kritere* të vendosura nga jashtë ose brenda shkollës.

Vlerësimi i nxënësit realizohet përmes disa proceseve, si:

**1. Kontrolli** lidhet me rrugën e përfutimit të informacionit mbi atë që ka arritur dhe atë që nuk ka arritur nxënësi gjatë të mësuarit. Kontrolli realizohet në forma të ndryshme dhe në çdo moment të të mësuarit.

**2. Matja** është procesi me anë të cilit mundësohet grumbullimi i informacionit për përvetësimin e programit mësimor nga nxënësi, krahasuar me një standard të caktuar. Matja është një proces krahasimi. Kjo do të thotë që matja nuk është e mundshme pa një standard të përcaktuar dhe të vlerësuar qartë, i cili mund të përdoret si bazë e krahasimit.

**3. Vlerësimi** është procesi gjatë të cilit përcaktohen vlerat mbi bazën e informacionit të grumbulluar

nga procesi i matjeve ose i vrojtimit. Vlerësimi në klasë është procesi që kryejnë mësuesit kur mbledhin, sintetizojnë dhe interpretojnë informacionin që u shërben atyre për të marrë vendime.

Procesi i vlerësimit ndodh para, gjatë dhe pas procesit mësimor. Para fillimit të procesit mësimor mësuesit e kryejnë vlerësimin për dy arsye:

- a) të njohin karakteristikat, nevojat dhe aftësitë e nxënësve;
- b) të planifikojnë mësimin.

Gjatë procesit mësimor mësuesit e përdorin vlerësimin për të marrë vendime që lidhen me zbatimin e programit mësimor, me të nxënë, me drejtimin e klasës dhe për të vlerësuar përparimin e nxënësve.

Vlerësimi që kryhet pas përfundimit të procesit mësimor synon të japë përfundimet lidhur me arritjet e nxënësve, me përparimin e tyre, me vendimet për përmirësimin e mësimin në vitin e ardhshëm.

Katër llojet më të përdorshme të vlerësimit në klasë janë:

1. *Vlerësimi me qëllim klasifikimi, vendosjeje*, i cili ndihmon në kategorizimin e nxënësve para fillimit të procesit mësimor.

2. *Vlerësimi diagnostikues*, që synon të zbulojë shkaqet njohëse, fizike, emocionale, shoqërore të problemeve që kanë nxënësit në mënyrë që të përcaktohen teknikat korrigjuese.

3. *Vlerësimi formues*, i cili mbikëqyr përparimin gjatë procesit të të nxënë, siguron një feedback për të lehtësuar të nxënë dhe për të korrigjuar gabimet e mësimdhënies.

4. *Vlerësimi përmbledhës*, që përcakton arritjet në përfundim të kapitullit, të kursit për të vendosur notat dhe certifikimin. Vlerësimi përmbledhës mund të përdoret edhe për të gjykuar efektshmërinë e mësimdhënies dhe të programit mësimor.

Për të realizuar matjen, mësuesit përdorin instrumentet e matjes që përfshijnë testet e llojeve të ndryshme dhe mjetet për vrojtimit.

Vlerësimi bazohet në një evidencë e cila ka si burime: pikët e testeve (test për mësimin e ditës, test kapitulli, test semestri, test vjetor) projektet, detyrat e shtëpisë, punën në klasë, punën në laborator, punën praktike, provimin.

Arritjet e nxënësve shihen në dy këndvështrime: a) sa nxënës e kalojnë klasën dhe b) sa mirë i kanë përvetësuar nxënësit objektivat e të nxënëit përkundrejt programit mësimor.

Arritjet në këndvështrimin e parë përfshijnë numrin e nxënësve që kalojnë klasën, numrin e nxënësve që diplomohen, notën mesatare të klasës.

Arritjet në këndvështrimin e dytë përfshijnë arritjet akademike të nxënëve në lëndët mësimore sipas planit mësimor, aftësitë e nxënësve për të zbatuar njohuritë në situata të jetës reale, zhvillimin social të nxënësve si rezultat i arsimimit.

Nënfusha 1	Treguesit	Instrumente	Nivelet e vlerësimit			
			1	2	3	4
<b>Llojet e vlerësimit</b>	1. Mësuesi vlerëson me notë nxënësit.	<b>1.1.1.</b> Vlerësimi me notë motivon nxënësin në procesin e të nxënit.				
		<b>1.1.2.</b> Nota e vënë është në përputhje me nivelin e arritjeve të nxënësit.				
		<b>1.1.3.</b> Mësuesi e përdor notën vetëm për të vlerësuar veprime të nxënësit që lidhen me njohuritë, aftësitë, qëndrimet e lëndës.				
		<b>1.1.4.</b> Mësuesi argumenton vlerësimin e bërë, duke filluar nga anët pozitive.				
		<b>1.1.5.</b> Mësuesi vlerëson ritmikisht me notë.				
		<b>1.1.6.</b> Mësuesi bën vlerësimin përfundimtar të nxënësit duke respektuar udhëzimet e MASH-it.				
	2. Mësuesi vlerëson me fjalë (gojë) nxënësit.	<b>1.2.1.</b> Mësuesi vlerëson me fjalë (gojë <sup>14</sup> ) vazhdimisht nxënësit.				
		<b>1.2.2.</b> Vlerësimi me gojë motivon nxënësin gjatë të nxënit.				
		<b>1.2.3.</b> Mësuesi përdor fjalë inkurajuese për të nxitur nxënësin gjatë nxënies.				
		<b>1.2.4.</b> Mësuesi përdor vetëm fjalë të etikës gjatë vlerësimit me gojë.				
		<b>1.2.5.</b> Vlerësimi me gojë mund të shoqërohet edhe me gjuhën e gjesteve për të plotësuar vlerën pozitive të tij.				
	3. Mësuesi vlerëson me shkrim nxënësit.	<b>1.3.1.</b> Mësuesi vlerëson me shkrim produktet e nxënësit.				
		<b>1.3.2.</b> Vlerësimi me shkrim fillon <i>gjithmonë</i> nga nxjerrja në pah e anëve pozitive të punimit/detyrës së nxënësit.				
		<b>1.3.3.</b> Mësuesi përdor një gjuhë të qartë dhe të kuptueshme për nxënësin.				
		<b>1.3.4.</b> Mësuesi nuk përdor fjalë fyese, diskriminuese.				
		<b>1.3.5.</b> Mësuesi e shkruan qartë dhe bukur vlerësimin e tij.				

14). Vlerësimi me gojë është vlerësimi me fjalë që i bëhet nxënësit nga mësuesi gjatë procesit mësimor.



Nënfusha 2	Treguesit	Instrumente	Nivelet e vlerësimit			
			1	2	3	4
<b>Veprimtari-të që vlerësohen</b>	1. Mësuesi vlerëson përgatitjen ditore të nxënësit.	2.1.1. Mësuesi vlerëson ritmiksht përgatitjen ditore të nxënësit.				
		2.1.2. Mësuesi i parapërgatit pyetjet që nxënësi u përgjigjet me gojë.				
		2.1.3. Pyetjet hartohen me një gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme për nxënësin.				
		2.1.4. Pyetjet hartohen në përputhje me objektivat lëndorë.				
		2.1.5. Pyetjet përfshijnë kontrollin e tri niveleve të arritjes.				
		2.1.6. Mësuesi bën pyetje diagnostikuese, formuese, përmbledhëse sipas formatit të përcaktuar.				
		2.1.7. Mësuesi respekton rregullat e etikës kur i drejton pyetje nxënësit.				
		2.1.8. Mësuesi nuk paragjykon përgjigjet e nxënësit.				
		2.1.9. Mësuesi bën vlerësim të paanshëm.				
	2. Mësuesi vlerëson punën në grup.	2.2.1. Mësuesi vlerëson aftësinë e nxënësit për të punuar me të tjerë.				
		2.2.2. Mësuesi vlerëson aftësinë e nxënësit për të ndarë materialet me të tjerë, me dëshirën e tij.				
		2.2.3. Mësuesi vlerëson aftësinë e nxënësit për të dëgjuar dhe respektuar mendimet e të tjerëve.				
		2.2.4. Mësuesi vlerëson nxënësin për mënyrën e respektimit të rregullave të përcaktuara nga grupi.				
		2.2.5. Mësuesi vlerëson sjelljen e nxënësit që demonstroi gjatë punës në grup.				
		2.2.6. Mësuesi vlerëson pjesëmarrjen e nxënësit në diskutime gjatë kohës së punës në grup.				
		2.2.7. Mësuesi përcakton qartë qëllimin e vlerësimit të punës në grup: a) të njëjtin vlerësim gjithë grupi, b) progresi individual i nxënësit brenda grupit, c) notë mbi bazë grupi apo individuale.				
		2.2.8. Mësuesi qartëson nxënësit për mënyrën e vlerësimit të punës në grup.				

Nënfusha 3	Treguesit	Instrumente	Nivelet e vlerësimit			
			1	2	3	4
<b>Produktet që vlerësohen</b>	1. Mësuesi harton provime me shkrim/teste për të vlerësuar përvetësimin e koncepteve dhe të lidhjeve mes tyre.	<b>3.1.1.</b> Mësuesi zhvillon mesatarisht 1 orë provim me shkrim për 18 orë mësimore. (gj)				
		<b>3.1.2.</b> Mësuesi zhvillon provime me shkrim më pak se njëorëshe, rreth 20-minutëshe, pa paralajmërim për pak tema mësimore të sapomësuar.				
		<b>3.1.3.</b> Mësuesi zhvillon, herë pas here, miniteste për temën e ditës, për objektiva të një kapitulli.				
		<b>3.1.4.</b> Mësuesi përcakton qartë qëllimin e zhvillimit të testit.				
		<b>3.1.5.</b> Çdo nxënës i ka provimet me shkrim/testet në një fletore të veçantë.				
		<b>3.1.6.</b> Testi shkruhet në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme për nxënësin.				
		<b>3.1.7.</b> Testi/provimi me shkrim përmban pyetje të llojeve të ndryshme: të tipit objektiv, subjektiv ose të kombinuara.				
		<b>3.1.8.</b> Testi nuk ka pyetje me përgjigje të diskutueshme.				
		<b>3.1.9.</b> Testi nuk ka pyetje të diskriminit social, gjinor, racor etj.				
		<b>3.1.10.</b> Renditja e pyetjeve në test bëhet sipas shkallës së vështirësisë, duke filluar nga më e ulëta.				
		<b>3.1.11.</b> Përmbajtja e testit planifikohet në përputhje me kohën e përcaktuar.				
		<b>3.1.12.</b> Testi ka një pikëzim të qartë për çdo pyetje/kërkesë.				
		<b>3.1.13.</b> Testi ka tabelë vlerësimi.				
		<b>3.1.14.</b> Mësuesi ka hartuar skemën e qortimit të testit.				
		<b>3.1.15.</b> Kërkesat e testeve/provimeve me shkrim janë në përputhje me objektivat përkatës të programit lëndor.				
		<b>3.1.16.</b> Testi ka kërkesa në tri nivele vështirësie.				
		<b>3.1.17.</b> Testi nuk ka kërkesa me përgjigje të gatshme që janë zhvilluar në orën mësimore ose janë dhënë në detyrat e shtëpisë.				
		<b>3.1.18.</b> Testi ka kërkesa për: -konceptet themelore të kapitullit dhe lidhjet midis tyre;				

		- aftësitë kryesore lëndore të kapitullit; - aftësitë ndërkurrikulare.				
		<b>3.1.19.</b> Testi përmban kërkesa për lidhjen ndërmjet: - koncepteve të kapitullit me kapitujt paraardhës të asaj klase; - koncepteve të kapitullit me konceptet e kësaj lënde të klasave paraardhëse; - këtij kapitulli dhe koncepteve të lëndëve të tjera.				
		<b>3.1.20.</b> Testi përmban kërkesa që matin thellësinë e përvetësimit të koncepteve për notat 8, 9, 10.				
		<b>3.1.21.</b> Në provimet me shkrim/teste ka, herë pas here, kërkesa ku përdoret matematika.				
		<b>3.1.22.</b> Njohuritë që testohen zënë peshë specifike të njëjtë me atë të programit.				
	2. Mësuesi vlerëson punë të ndryshme me shkrim, ese, veprimtari praktike profesionale etj.	<b>3.2.1.</b> Mësuesi vlerëson vijueshmërinë e nxënësit në përgatitjen e detyrave me shkrim.				
		<b>3.2.2.</b> Mësuesi vlerëson përmbajtjen, aftësitë dhe qëndrimet e nxënësit kundrejt detyrës së dhënë.				
		<b>3.2.3.</b> Mësuesi vlerëson proceset e të nxënësit, të pasqyruara në detyrën me shkrim/modulin praktik/projektin e të nxënësit, duke përdorur listëkontrolli ose shkallë vlerësuese.				
		<b>3.2.4.</b> Mësuesi merr parasysh edhe vlerësimet që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit apo vetëvlerësimin, kur vlerëson një detyrë me shkrim/moduli praktik/projekt të nxënësit.				
		<b>3.2.5.</b> Mësuesi vlerëson aspekte teknike të detyrës, në lëndë të ndryshme, por edhe në veprimtari të tjera praktike, të cilat reflektojnë saktësi dhe përshtatshmëri (struktura e fjalisë, pikësimi, shkrimi, informacioni i përfshirë etj.).				
		<b>3.2.6.</b> Mësuesi vlerëson realizimin e objektivave dhe të rezultateve mësimore të punës me shkrim/projektit/esesë.				
		<b>3.2.7.</b> Mësuesi vlerëson respektimin e formatit sipas llojit të punës me shkrim.				
		<b>3.2.8.</b> Mësuesi në arsimin e mesëm zhvillon detyra me shkrim, në përputhje me dokumentet kurrikulare.				

	3. Mësuesi vlerëson dosjen e nxënësit.	3.3.1. Mësuesi vlerëson progresin e nxënësit nëpërmjet dosjes së tij.				
		3.3.2. Mësuesi vlerëson punët dhe produktet e realizuara, prezantimet e ndryshme individuale dhe në grup, të përfshira në dosje.				
		3.3.3. Mësuesi dhe nxënësi vendosin bashkarisht për punimet që do të futen në dosje.				
	4. Mësuesi vlerëson nxënësit në Provimet Përfundimtare të Nivelit I, II dhe III në Arsimin Profesional.	3.4.1. Testet e teorisë profesionale të integruar përfshijnë tri nivelet e arritjes në fusha të ndryshme të arsimit të mesëm profesional.				
		3.4.2. Testet e teorisë profesionale të integruar janë në përputhje me programet orientuese për lëndët profesionale.				
		3.4.3. Testet e teorisë profesionale të integruar janë formuluar me gjuhë të qartë.				
		3.4.4. Testet e praktikës profesionale të integruar janë në përputhje me programet orientuese për praktikën profesionale.				
		3.4.5. Testet e praktikës profesionale të integruar formulohen me gjuhë të qartë, duke përfshirë udhëzimet për veprimtaritë që do të kryejë nxënësi.				

Nënfusha 4	Treguesit	Instrumente	Nivelet e vlerësimit			
			1	2	3	4
<b>Procesi i vlerësimit</b>	1. Mësuesi ka një program të qartë për vlerësimin e nxënësve.	4.1.1. Mësuesi ka një program të qartë dhe të plotë për vlerësimin e nxënësve, i cili është hartuar në bazë të objektivave dhe rezultateve mësimore.				
		4.1.2. Mësuesi qartëson nxënësit dhe prindërit për programin e tij të vlerësimit.				
		4.1.3. Mësuesi përfshin në programin e vlerësimit, përdorimin e teknikave të ndryshme të vlerësimit, si: detyra kontrolli, kuice, teste, lista kontrolli për vlerësimin e procedurës së punës, lista kriteresh vlerësimi për cilësinë e produkteve etj.				

		4.1.4. Mësuesi mban një evidencë të veçantë për vlerësimin dhe e përdor atë për të parë ecurinë e nxënësit.				
		4.1.5. Mësuesi përdor të dhënat e papërpunuara <sup>15</sup> për të bërë vlerësimin e nxënësit.				
		4.1.6. Mësuesi publikon para klasës ose në vende të posaçme të saj, punimet e nxënësve.				
		4.1.7. Mësuesi përdor teknika që nxënësit të vlerësojnë veten dhe njëri-tjetrin.				
		4.1.8. Mësuesi bën vlerësim me notë në regjistër për grupe të ndryshme nxënësish.				
	2. Mësuesi bën vlerësimin e nxënësve për qëllime të ndryshme.	4.2.1. Mësuesi bën vlerësime me qëllim diagnostikimin e njohurive, aftësive dhe qëndrimeve të nxënësit.				
		4.2.2. Mësuesi bën vlerësim formues me qëllim mbikëqytjen e përparimit të nxënësit.				
		4.2.3. Mësuesi bën vlerësim përmbledhës të arritjeve të nxënësit.				
4.2.4. Mësuesi bën vlerësim motivues për të nxitur interesin e nxënësit.						

Nënfusha 5	Treguesit	Instrumente	Nivelet e vlerësimit			
			1	2	3	4
<b>Arritjet</b>	1. Rezultatet e nxënësve në Provimet e Lirimit përputhen në nivele të kënaqshme me vlerësimin e bërë nga vetë shkolla.	5.1.1. Shkolla analizon rezultatet e nxënësve në Provimet e Lirimit, për të tri nivelet e arritjes.				
		5.1.2. Shkolla analizon përputhjen e testeve të Provimeve të Lirimit me programet e lëndëve përkatëse.				
		5.1.3. Shkolla analizon qartësinë dhe shkallën e të kuptuarit nga nxënësit të pyetjeve/kërkesave të testeve të Provimeve të Lirimit.				

15). Të dhëna të papërpunuara janë shënimet që mban mësuesi për çdo nxënës në lidhje me arritjet e tij.

		<b>5.1.4.</b> Rezultatet tregojnë një përputhje të kënaqshme të vlerësimit të bërë nga vetë shkolla me vlerësimin e jashtëm të Provimeve të Lirimit.				
		<b>5.1.5.</b> Shkolla zbaton, në mënyrë efektive, rregulloren zyrtare për procesin e zhvillimit të Provimeve të Lirimit.				
		<b>5.1.6.</b> Shkolla relatton pranë institucioneve përkatëse për problematikën e arritjeve të nxënësve në Provimet e Lirimit.				
2. Rezultatet e nxënësve në Maturën Shtetërore përputhen në nivele të kënaqshme me vlerësimin e bërë nga vetë shkolla.		<b>5.2.1.</b> Shkolla analizon rezultatet e nxënësve në Provimet e Maturës Shtetërore, për të tri nivelet e arritjes.				
		<b>5.2.2.</b> Shkolla analizon përputhjen e testeve të Provimeve të Maturës Shtetërore me programet e lëndëve përkatëse.				
		<b>5.2.3.</b> Shkolla analizon qartësinë dhe shkallën e të kuptuarit nga nxënësit të pyetjeve/kërkesave të testeve të Provimeve të Maturës Shtetërore.				
		<b>5.2.4.</b> Rezultatet tregojnë një përputhje të kënaqshme të vlerësimit të bërë nga vetë shkolla me vlerësimin e jashtëm të Provimeve të Maturës Shtetërore.				
3. Rezultatet e nxënësve në Provimet Përfundimtare të Nivelit I, II dhe III në Arsimin Profesional përputhen me vlerësimin e bërë gjatë vitit mësimor.		<b>5.3.1.</b> Shkolla analizon rezultatet e nxënësve në Provimin e Teorisë Profesionale të integruar të Nivelit përkatës të kualifikimit, për të tri nivelet e arritjes.				
		<b>5.3.2.</b> Shkolla analizon rezultatet e nxënësve në Provimin e Praktikës Profesionale të integruar të Nivelit përkatës të kualifikimit, për përmbushjen e kompetencave që testohen.				
		<b>5.3.3.</b> Shkolla menazon në mënyrë efektive rregulloren zyrtare për procesin e zhvillimit të provimeve përfundimtare të Nivelit I, II dhe III.				
		<b>5.3.4.</b> Rezultatet e nxënësve në Provimet Përfundimtare të Teorisë Profesionale dhe të Praktikës Profesionale të integruar tregojnë një përputhje të kënaqshme me vlerësimin e brendshëm të vetë shkollës dhe të përfaqësuesve të biznesit.				
4. Nota vjetore në gjimnaz dhe në arsi-		<b>5.4.1.</b> Nota vjetore llogaritet e ponderuar sipas udhëzimeve zyrtare.				

min e mesëm profesional llogaritet sipas udhëzimeve zyrtare.	<b>5.4.2.</b> Mësuesi i ka të evidentuara saktë notat e nxënësve sipas llojeve të tyre.				
	<b>5.4.3.</b> Mësuesi zbaton me korrektësi peshën e secilit vlerësim në llogaritjen e notës vjetore të ponderuar.				
	<b>5.4.4.</b> Mësuesi zbaton me korrektësi peshën e secilit vlerësim në llogaritjen e notës vjetore për modulet profesionale dhe projektet e të nxënësve.				
5. Kreditet e përfituara nga nxënësi përlllogariten sipas rregullores së vlerësimit në gjimnaz dhe në arsimin e mesëm profesional.	<b>5.5.1.</b> Shkolla informon nxënësit dhe prindërit për mënyrën e përfitimit të krediteve dhe pikëve.				
	<b>5.5.2.</b> Kreditet dhe pikët llogariten sipas një formule të përcaktuar.				
	<b>5.5.3.</b> Mësuesi zbaton me korrektësi kriteret për përlllogaritjen e krediteve dhe të pikëve të përfituara nga nxënësi.				

## STANDARDI

Mësuesi ka një program të qartë për vlerësimin, të cilin ua bën të ditur nxënësve dhe prindërve.

Vlerësimi është i argumentuar dhe fillon duke nxjerrë në pah anët pozitive, të shprehura këto me një gjuhë të qartë dhe të kuptueshme, pa përdorur fjalë fyese apo diskriminuese. Mësuesi e përdor vlerësimin si mjet për të nxitur nxënësit drejt përmirësimit të rezultateve. Mësuesi vlerëson veprimtaritë individuale të nxënësve dhe ato të punës në grup, duke përdorur vlerësimin me shkrim, me gojë dhe me notë. Mësuesi dhe shkolla vlerësojnë produkte të ndryshme, duke parë si anën teknike të detyrës, edhe atë përmbajtjesore. Vlerësimi i produkteve është i paanshëm. Nxjerrja e rezultateve vjetore bëhet sipas udhëzimeve zyrtare, duke marrë parasysh vlerësimin e bërë për produkte e veprimtari të ndryshme gjatë procesit mësimor. Vlerësimi përfundimtar, në përfundim të ciklit apo nivelit në arsimin profesional përputhet me vlerësimin e Provimeve Kombëtare apo Provimet Përfundimtare të Nivelit.

Mësuesi llogarit kreditet dhe pikët e përfituara nga nxënësi sipas rregullores së vlerësimit në gjimnaz dhe në arsimin profesional, duke respektuar kriteret e përcaktuara.

## NIVELI 1

Mësuesi ka një program vlerësimi me objektiva të qarta. Ai mban një evidencë të veçantë për vlerësimin dhe e përdor atë për të parë ecurinë e nxënësit. Mësuesi e përdor *gjithmonë* vlerësimin si mjet për të nxitur

nxënësit drejt përmirësimit të rezultateve. Ai përdor me *efikasitet* vlerësimin me shkrim, me gojë, të kombinuar, vlerësimin me fjalë dhe me notë, duke bërë *gjithmonë* argumentimin e tij. Vlerësimi është i paanshëm dhe bëhet *gjithnjë* nga nxjerrja në pah e anëve pozitive.

Gjatë procesit mësimor, mësuesi përdor *vazhdimisht* teknika të ndryshme, me qëllim që nxënësit të vlerësojnë veten dhe njëri-tjetrin. Mësuesi vlerëson në *vijimësi* dhe *ritmikisht* përgatitjen ditore dhe veprimtaritë e tjera të nxënësve. Ai vlerëson përmbajtjen, aftësitë dhe qëndrimet e nxënësit kundrejt detyrës së dhënë, të cilat janë *gjithmonë* në përputhje me objektivat e programit. Mësuesi vlerëson progresin e nxënësit nëpërmjet portofolit të tij. Nxjerrja e rezultateve vjetore bëhet *gjithnjë* sipas udhëzimeve zyrtare, duke marrë parasysh vlerësimin e bërë për produkte e veprimtari të ndryshme gjatë procesit mësimor.

Vlerësimi përfundimtar, në përfundim të ciklit apo nivelit në arsimin profesional, përputhet *në mënyrë të kënaqshme* me vlerësimin e Provimeve Kombëtare apo Provimet Përfundimtare të Nivelit. Mësuesi llogarit kreditet dhe pikët e përfituara nga nxënësi sipas *Rregullores se vlerësimit* në gjimnaz dhe në arsimin profesional, duke respektuar *të gjitha* kriteret e përcaktuara.

## **NIVELI 2**

Mësuesi ka një program vlerësimi me objektiva të përcaktuara. Ai mban një evidencë të veçantë për vlerësimin. Mësuesi e përdor vlerësimin si mjet për të nxitur nxënësit drejt përmirësimit. Ai përdor vlerësimin me shkrim, me gojë, me notë, dhe, *përgjithësisht* e argumenton atë. Vlerësimi është i paanshëm dhe bëhet duke nxjerrë në pah anët pozitive të nxënësit. Mësuesi e bën vlerësimin me një gjuhë të qartë dhe të kuptueshme për nxënësit. Mësuesi vlerëson përgatitjen ditore dhe veprimtaritë e tjera të nxënësit. Ai vlerëson produktet e nxënësit, të cilat janë në përputhje me objektivat e programit. Mësuesi e vlerëson progresin e nxënësit nëpërmjet portofolit. Nxjerrja e rezultateve vjetore bëhet sipas udhëzimeve zyrtare, duke marrë parasysh vlerësimin e bërë për produkte e veprimtari të ndryshme gjatë procesit mësimor. Vlerësimi përfundimtar, në përfundim të ciklit apo nivelit në arsimin profesional *shpesh* përputhen me vlerësimin e Provimeve Kombëtare apo Provimet Përfundimtare të Nivelit. Mësuesi llogarit kreditet dhe pikët e përfituara nga nxënësi sipas *rregullores se vlerësimit* në gjimnaz dhe në arsimin profesional, duke respektuar *të gjitha* kriteret e përcaktuara

## **NIVELI 3**

Mësuesi ka një program vlerësimi, por nuk ka objektiva të qartë. Ai mban një evidencë vlerësimi e cila nuk pasqyron të dhëna të plota për ecurinë e nxënësit. Vlerësimi përdoret thjesht si një element i procesit mësimor.

Mësuesi përdor vlerësimin me shkrim, me gojë, të kombinuar, me fjalë dhe me notë, por *rrallë* bën argumentimin e tij. Shpesh vlerësimi bëhet duke nxjerrë në pah mangësitë e nxënësit. Mësuesi vlerëson përgatitjen ditore të nxënësit dhe veprimtaritë e tjera.



Ai vlerëson detyra të dhëna në mënyrë rastësore dhe të pamotivuara.

Nxjerrja e rezultateve vjetore bëhet duke respektuar *përgjithësisht* kërkesat zyrtare. Nuk janë të pakta rastet kur këto vlerësime nuk tregojnë rezultatet reale të nxënësit. Vlerësimi përfundimtar, në përfundim të ciklit apo nivelit në arsimin profesional, *herë pas here*, përputhet me vlerësimin e Provimeve kombëtare apo Provimet Përfundimtare të Nivelit. Mësuesi llogarit kreditet dhe pikët e përfituara nga nxënësi sipas rregullores së vlerësimit në gjimnaz dhe arsimin profesional, duke respektuar kriteret e përcaktuara

#### **NIVELI 4**

Mësuesi nuk ka një program vlerësimi, ndaj në të shumtën e rasteve ia lë rastësisë. Ai e sheh vlerësimin, thjeshtë, si një element të procesit mësimor. Mësuesi përdor vlerësimin me shkrim, me gojë, të kombinuar, me fjalë dhe me notë, por është konfuz në vlerësimin e tij. Mësuesi nuk argumenton vlerësimin, por thekson më shumë mangësitë e nxënësit. *Shpesh* mësuesi paragjykon përgjigjet dhe krijon paqartësi e pakënaqësi tek nxënësi. Mësuesi bën vlerësime *sporadike* për përgatitjen ditore dhe veprimtaritë e nxënësit, duke bërë që ai të jetë i pamotivuar për detyrat në vijimësi. Ai bën vlerësim sipërfaqësor të detyrave të dhëna, të cilat *në të shumtën* e rasteve nuk janë në përputhje me objektivat e programit. Nxjerrja e rezultateve vjetore bëhet duke respektuar *përgjithësisht* kërkesat zyrtare. *Shpesh* këto vlerësime nuk tregojnë rezultatet reale të nxënësit. Vlerësimi përfundimtar, në përfundim të ciklit apo nivelit në arsimin profesional, ka *ndryshime të dukshme* me vlerësimin e Provimeve kombëtare apo Provimet përfundimtare të Nivelit. Mësuesi llogarit kreditet dhe pikët e përfituara nga nxënësi sipas rregullores së vlerësimit në gjimnaz dhe në arsimin profesional, duke respektuar kriteret e përcaktuara.

## FJALORTH

**Aftësitë kroskurrikulare** janë aftësi që nxënësi i përfiton gjatë procesit mësimor dhe i përdor për procese të një niveli të lartë të të menduarit, për të zhvilluar idetë e tij, qëndrimet dhe vlerat.

**Arritja** nënkupton demonstrimin e njohurive, aftësive, qëndrimeve që nxënësi pritet të mësojë.

**Bashkëpunimi gjithëpërfshirës** nënkupton përfshirjen e fëmijëve me nevoja të veçanta në klasat e shkollave normale, pavarësisht nga natyra apo shkalla e paaftësisë dhe e vështirësive.

**Baza prodhuese** nënkupton një mjedis mësimor të pajisur me mjete të nevojshme për realizimin e moduleve të praktikës profesionale.

**Burimet mësimore** nënkuptojnë mjetet, materialet, pajisjet etj., që përdoren në procesin e mësimin.

**Burimi financiar** nënkupton mënyrën e zotërimit të të ardhurave në formën e lekëve *kesh* ose të të mirave materiale nga institucioni.

**Demonstrimi** nënkupton një metodë mësimdhënieje që mbështetet në parimin e konkretizimit, nëpërmjet të cilit nxënësi njihet drejtpërsëdrejti ose tërthorazi me objektin, procesin ose dukurinë që studiohet.

**Didaktika** është teoria e të mësuarit; disiplinë shkencore që ka për objekt përmbajtjen dhe synimet e procesit mësimor.

**Dijet** nënkuptojnë fakte, parime, procedura, koncepte, përkufizime.

**Diskriminimi** nënkupton veprime që ndërmerren për krijimin e pabarazive ndërmjet grupeve sociale apo individëve.

**Diskutimi** nënkupton një metodë mësimore me të cilën një grup nxënësish shkëmbejnë njohuri, ide dhe mendime për objektivat e të nxënësve në një formë bashkëpunimi, për të nxënë nga njeri-tjetri.

**Efektshmëria** lidhet me nivelin e dëshiruar të rezultateve të arritura.

**Eficienca** nënkupton arritjen e nivelit të dëshiruar përkundrejt një kostoje të ulët.

**Ekipi mbikëqyrës** përbëhet nga një grup individësh që ndjekin një proces që nga hartimi dhe mbaron me përfundimin e procesit.

**Etika** është shkenca që trajton moralin dhe analizon sistematikisht veçantinë e gjykimeve të vlerës, siç janë: “i mirë, i keq, i drejtë, i gabuar”, etj.; parimet e përgjithshme që përlligjin aplikimin në një objekt.

**Feedback-u** është informacioni për një produkt ose një proces, i cili përdoret nga sistemi për të bërë rregullimet e duhura (në arsim); komentet ose informacioni që nxënësit marrin për suksesin e detyrave të të nxënësve

nëpërmjet mësuesit ose nga nxënësit e tjerë dhe anasjelltas.

**Fusha kurrikulare** nënkupton një *menu* me lëndë të grupuara, sipas disa karakteristikave specifike për to.

**Fusha psiko-motore** synon të zhvillojnë shkathhtësitë, shprehjet, aftësitë deri në mjeshhtëri, të çojë nga aftësi më pak të zhvilluara në aftësi më të zhvilluara.

**Grupet e interesit** janë të gjitha subjektet e interesuara që kontribuojnë në zhvillimin e shkollës.

**Hulumtimi** nënkupton vërtetimin, shqyrtimin, gjurmimin në diçka për ta zbuluar; veprimtari intelektuale e organizuar dhe e drejtuar për studimin e një procesi ose dukurie psikike, duke zbatuar metodat e studimit shkencor dhe forma të efektshme organizative.

**Këshillimi për karrierën** nënkupton procesin e informimit të nxënësve dhe të prindërve të tyre për zgjedhjet që duhet të bëjnë lidhur me karrierën.

**Klima** (në fushën e edukimit) nënkupton kushtet fizike, sociale, psikologjike në të cilat zhvillohet veprimtaria në shkollë.

**Kompetenca kyç** nënkupton njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet bazë, të domosdoshme në një nivel të caktuar arsimor.

**Komuniteti i shkollës** përbëhet nga grupe njerëzish që jetojnë në një zonë të caktuar dhe lidhen nga interesa e qëllime të përbashkëta për zhvillimin e arsimit në zonën e tyre.

**Konfidencialiteti** nënkupton diçka që mbahet e fshehtë dhe nuk u tregohet të tjerëve; diçka që duhet ta dinë vetëm disa njerëz të caktuar e të ngarkuar për një punë.

**Korrelacioni** nënkupton përshkrimin statistikor që tregon marrëdhëniet ndërmjet dy faktorëve dhe drejtimin e tyre. Korrelacioni tregon vetëm lidhje ndërmjet dy objekteve ose ngjarjeve, por nuk provon shkakun dhe pasojën.

**Kreditet** nënkuptojnë pikët që përfiton nxënësi i gjimnazit, pasi ka përfunduar lëndë ose module të ndryshme. Ato llogariten duke pjesëtuar numrin e orëve vjetore të lëndës në planin mësimor me numrin e javëve të vitit shkollor.

**Kualifikimi** nënkupton shkallën e përgatitjes shkencore e profesionale të dikujt në një degë ose fushë të caktuar të arsimit; shkalla e njohurive dhe e aftësive që ka arritur dikush në një fushë të caktuar.

**Kurrikula me zgjedhje të detyruar** është një grup lëndësh të miratuara nga MASH-i, nga të cilat nxënësi zgjedh për t'u thelluar a zgjeruar në lëndë të ndryshme të kurrikulës bërthamë.

**Kurrikula bërthamë** është tërësia e lëndëve të përbashkëta që janë të detyruara për të gjithë nxënësit e një cikli shkollor.

**Kurrikula e shkruar** përmbledh të gjitha dokumentet shkollore, në nivel kombëtar dhe në nivel shkolle.

**Kurrikula e zbatuar** është zbatimi në kushtet konkrete të shkollës i kurrikulës së shkruar.

**Kurrikula** është një harmonizim i kurrikulës së synuar që përfshihet në dokumentet e shkruara dhe asaj që zhvillohen realisht në praktikën e shkollës.

**Kurrikula me zgjedhje** është një grup lëndësh që nxënësi i përzgjedh sipas interesave të tij.

**Kurrikula me zgjedhje të lirë** është një *menu* me lëndë/module lëndore, module profesionale, projekte kurrikulare, përforcim, shërbim komunitar nga të cilat nxënësi përzgjedh sipas udhëzimeve përkatëse zyrtare.

**Liria e mësimdhënies** është autonomia didaktike dhe e shprehjes së lirë të mësuesit në ushtrimin e profesionit të vet.

**Listëkontrolli** është një instrument që përmban një listë me tema, objektiva, aftësi, njohuri për të cilat nxënësi do të vrojtohet.

**Marrëdhëniet e partneritetit** janë marrëdhënie reciproke midis palëve me interesa të përbashkëta.

**Marrëdhëniet konfidenciale** janë marrëdhënie miqësore të afërta, larg bisedimit formal.

**Materiali këshillimor** nënkupton materialin që disponon shkolla, të cilin ua transmeton prindërve e nxënësve për të marrë njohuri për shkollën, profilin që duhet të ndjekin sipas aftësive e tregut të punës.

**Matja** është procesi me anë të cilit mundësohet grumbullimi i informacionit për përvetësimin e programit mësimor nga nxënësi, krahasuar me një standard të caktuar.

**Mesatarja e ponderuar (Mp)** e gjimnazit nënkupton mesataren që llogaritet duke pjesëtuar numrin e përgjithshëm të pikëve që nxënësi ka fituar gjatë gjimnazit me shumën e krediteve të lëndëve në të cilat nxënësi vlerësohet me notë.

**Mesatarja e ponderuar e Maturës Shtetërore** nënkupton mesataren që llogaritet duke pjesëtuar shumën e pikëve të fituara në provimet e Maturës Shtetërore me shumën e krediteve të lëndëve të dhëna në provim.

**Mesatarja e ponderuar e përgjithshme e gjimnazit** nënkupton mesataren që llogaritet duke pjesëtuar shumën e pikëve që nxënësi fiton pas marrjes së diplomës, me numrin e përgjithshëm të krediteve të fituara.

**Mësimdhënia** është akti i të dhënit mësim në një institucion arsimor; është një proces i qëllimshëm dhe i planifikuar nga mësuesi.

**Metodat e mësimdhënies** janë tërësia e planifikimeve nga mësuesi për të transmetuar njohuri, për të zhvilluar aftësi, për të kultivuar qëndrime dhe vlera të nxënësi.

**Mjedisi fizik** nënkupton tërësinë e kushteve fizike që krijojnë një atmosferë të përshtatshme për ecurinë e procesit mësimor.

**Mjetet didaktike** nënkuptojnë tërësinë e mjeteve që përdor mësuesi në funksion të lehtësimit të procesit të nxënies.

**Motivimi** nënkupton një shtysë të brendshme që drejton qëndrimin apo sjelljen drejt realizimit të saj; një

veprimtari që kryhet në mënyrë të vullnetshme, jo të detyruar, me qëllim që të arrihen disa objektiva.

**Nota** përdoret për të paraqitur rezultatin e arritjeve dhe të përparimit akademik të nxënësit.

**Nxënësi me nevoja të veçanta** nënkupton individin që ka vështirësi fizike, mendore, emocionale ose vështirësi të tjera.

**Nxënësi me prirje të veçanta** nënkupton individin që shfaq dukshëm parapëlqime dhe rezultate të larta në fusha të ndryshme.

**Objektiva specifike** janë objektivat që hartojnë mësuesit në planin ditor për të realizuar objektivat e programit.

**Objektivat mësimorë** (të programit) nënkuptojnë përshkrimin dhe përmbajtjen mësimore bazë që do të studiohet nga nxënësit.

**Objektivi i të nxënës** nënkupton një kompetencë të përbërë nga sjellje, njohuri e aftësi, të shprehura me terma të qartë. Objektivi tregon atë që duhet të jetë efektivisht e mësuar nga nxënësi dhe që duhet të manifestohet nga ana e tij si sjellje përfundimtare, e fituar falë proceseve të mësimdhënies dhe të të nxënës.

**Ora e mësim** është forma kryesore e organizimit të procesit mësimor; njësia metodike e sistemit të të mësuarit në bazë klase.

**Orët e lira** janë një sasi orësh të përcaktuara në programet lëndore që përdoren për zbatimin e kurrikulës në bazë shkolle.

**Orët ekstrakurrikulare** janë orë të përcaktuara në planin mësimor, të miratuara nga MASH-i, që përdoren për zbatimin e kurrikulës në bazë shkolle.

**Organizimi dhe drejtimi i klasës** është procesi i administrimit të veprimtarisë së klasës në lidhje me aspekte të tilla, si: planifikimi i mësim, shfrytëzimi i burimeve njerëzore dhe materialeve, shfrytëzimi i hapësirës dhe i kohës, krijimi i klimës, kontrolli, disiplina, zgjidhja e konflikteve për të realizuar qëllimet e edukimit.

**Përshkruesi i vlerësimit** nënkupton një grup shenjash që përdoren si një *shkallë* kundrejt produktit që do të vlerësohet.

**Plani afatmesëm** është programi i zhvillimit të shkollës për 4-vjet për të arritur tregues cilësorë e sasiorë, sipas prioriteteve që shkolla cakton.

**Plani vjetor mësimor** nënkupton zberthimin e dokumenteve zyrtare (programi lëndor dhe udhëzime të ndryshme), tekstit të nxënës dhe materialeve burimore në përshtatje me kushtet e shkollës dhe nevojat e nxënës.

**Planifikimi** nënkupton përcaktimin sistematik të mënyrës me të cilën do të arrihen objektiva të caktuara.

**Dosja e nxënës** nënkupton një koleksion sistematik dhe të organizuar të punës së nxënës, si dëshmi e drejtpërdrejtë e përpjekjeve, arritjeve dhe e progresit të tij gjatë një periudhe kohore.

**Praktika mësimore** nënkupton veprimtarinë e planifikuar mësimore, që krijon mundësi për të përfituar përvoja që lidhen me profesionin, si dhe për të punuar në kushte reale pune.

**Prioriteti** nënkupton përparësinë që shkolla cakton pasi ka analizuar gjendjen.

**Produkti** nënkupton rezultatin e prekshëm dhe të qëndrueshëm të një performance apo detyre.

**Programi mësimor** është dokumenti zyrtar ku paraqitet përmbajtja e lëndës mësimore dhe mënyra si realizohet ajo. Programi mësimor është detyrim ligjor për t'u zbatuar nga mësuesit.

**Projekti kurrikular** nënkupton një projekt të planifikuar dhe të realizuar gjatë vitit shkollor, në të cilin përfshihet lidhja ndër-lëndore dhe kërkon hulumtime të gjera. Projekti kërkon nivel të lartë aftësish të të menduarit kritik, të problemzgjdhjes, të të menduarit krijues etj.

**Projekti** nënkupton një detyrë komplekse që përfshin më shumë se një lloj aktiviteti apo prodhimi.

**Puna në grup** nënkupton bashkëpunimin e disa personave që ndërsjelltazi janë të lidhur për realizimin e një detyre të përbashkët.

**Qëllimet arsimore** janë synimet e përgjithshme afatgjata që duam të arrijmë në të ardhmen. Ato përcaktohen për veprimtarinë tërësore të shkollës, për planet dhe programet mësimore.

**Reflektimi** është procesi i analizës kritike që përfshin si elementin njohës edhe atë afektiv. Prosesi i reflektimit ndaj mësimdhënies përfshin: të menduarit kritik, vetëdrejtimin, zgjidhjen e problemit, të menduarit krijues.

**Rezultatet e të mësuarit** nënkuptojnë njohuritë, aftësitë, qëndrimet që ka fituar nxënësi në fund të një procesi mësimor.

**Rezultati** nënkupton një aktivitet, një produkt etj. të matshëm, në të cilin nxënësi demonstroi njohuri, aftësi dhe qëndrime.

**Rubrika e vlerësimit** përfshin kriteret e një sistemi vlerësimi, duke përshkruar qartë karakteristikat e performancës.

**Shpjegimi** është një metodë mësimore ku burim i njohurive të reja është fjala e mësuesit.

**Skeletkurrikula** nënkupton atë pjesë të kurrikulës qendrore të arsimit profesional që përmban informacion kurrikular thelbësor dhe të standardizuar për këtë kualifikim.

**Standardet** janë nivele të matshme që duhen arritur nga nxënësi dhe shkolla.

**Standardi i arritjes** nënkupton nivelin e përmbushjes së standardeve të përmbajtjes nga nxënësit.

**Standardi i përmbajtjes** nënkupton nivelin e njohurive, aftësive e qëndrimeve të nxënësve në një lëndë a fushë lëndore.

**Strategjitë e të mësuarit** nënkuptojnë çdo sjellje mendore të nxënësve që u mundëson ruajtjen, marrjen, organizimin dhe të kuptuarit e informacionit.

**Të mësuarit me projekte** është metodë mësimore e drejtuar ose e kontrolluar nga vetë nxënësi. Metoda përqendrohet në përmbushjen e një detyre, e cila kërkon që nxënësi të përdorë e të zbatojë njohuritë dhe shprehitë e fituara gjatë procesit mësimor në situata të reja ose të ndryshme.

**Teksti** është një nga mjetet burimore të mësimin, i shkruar dhe i përzgjedhur sipas kriterëve zyrtarë.

**Termi psiko-social** përdoret për të përshkruar marrëdhëniet ndërmjet nevojave të individit dhe mjedisit social.

**Testet diagnostifikuese** shërbejnë për të zbuluar shkaqet njohëse, fizike, emocionale, shoqërore të problemeve që kanë nxënësit në mënyrë që të përcaktohen teknikat korrigjuese.

**Testi i standardizuar** është testi, përmbajtja e të cilit përzgjidhet dhe kontrollohet në mënyrë empirike; janë caktuar norma, janë përcaktuar metoda të njëjta të administrimit, të pikëzimit dhe të vlerësimit dhe mund të vlerësohet me një shkallë të lartë objektiviteti.

**Thellimi** nënkupton avancim më në thellësi të përmbajtjes së një lënde, krahasuar me atë të lëndës bërthamë.

**Trajnimi** është proces i vazhdueshëm i fitimit të njohurive dhe të aftësive në ndihmë të përgatitjes individuale për të kryer më mirë detyrat përkatëse.

**Treguesi arsimor** është një statistikë e lidhur me politikën që synon të sigurojë informacion rreth kushtit, funksionimit ose veprimtarisë së një sistemi arsimor ose të një pjese të tij.

**Treguesi cilësor** shënon ndryshore që nuk është e lehtë të paraqiten numerikisht. Për to përdoret shkalla vlerësuese e përshkruese.

**Treguesi sasior** përmban ndryshore që mund të paraqiten lehtësisht në mënyrë numerike.

**Vetëvlerësimi** nënkupton një proces ku institucioni a individ i angazhohet në një rishikim sistematik të performancës së tij me qëllim përmirësimin në të ardhmen.

**Vëzhgimi i veprimtarisë mësimore** nënkupton gjykimin e vlerave të diçkaje për një qëllim të dhënë, duke përdorur kritere të caktuara.

**Vlerësimi diagnostikues** synon të zbulojë shkaqet njohëse, fizike, emocionale, shoqërore të problemeve që kanë nxënësit, në mënyrë që të përcaktohen teknikat korrigjuese.

**Vlerësimi** është procesi gjatë të cilit përcaktohen vlerat mbi bazën e informacionit të grumbulluar nga procesi i matjeve. Elementi kryesor i vlerësimit është gjykimi.

**Vlerësimi përfundimtar** nënkupton vlerësimin që shërben për të përcaktuar arritjet në përfundim të kapitullit, të kursit për të vendosur notat dhe certifikimin. Vlerësimi përmbledhës mund të përdoret edhe për të gjykuar efektshmërinë e mësimdhënies dhe të programit mësimor.

**Zgjerimi** nënkupton avancim në gjerësi, duke shtuar tema të reja brenda një kapitulli a duke shtuar kapituj të rinj.

## BIBLIOGRAFIA

- A.Pollard & S.Tann, *Teaching & learning in School*.
- AEDP, *How good is our school*, Tiranë, 2000.
- Agjencia e Arsimit Profesional, *Skeletkurrikula e arsimit profesional*, Tiranë, 2009.
- Allan C. ORSTEIN, Francis P. Hunkins, *Kurrikula, bazat, parimet dhe problemet*; Përkthim i ISP-së, Tiranë, 2003.
- Arsimi dhe formimi profesional, Nr. 10 dhe 11 (botim i AKAFP-së).
- Carter McNamara, *Human resource management*.
- Departament, HM Inspectors of Schools (Scotland), 1998 <http://www.hmis.scotoff.gov.uk/hmi/>
- Dictionary of Education, Third Edition, USA, 1973.
- Dispozita Normative, Tiranë. 2002.
- Dr. Frank Schorn, *Arsimimi e trajnimi i mësuesve drejt kualifikimit afatgjatë të tyre*.
- Elementary school educational environments: Toward schools that are responsive to students. "National Elementary Principal", 49, 53-58. Sinclair, R. L. (1970).
- Haynes, N. M., Emmons, C., & Comer, J. P., *Elementary and middle school climate survey*, 1993.
- Instituti i Kurrikulës dhe i Trajnimit, *Drejtimi i shkollës, udhëzues për drejtuesit e shkollës*, Tiranë, 2008.
- Instituti i kurrikulës dhe i Trajnimit, *Korniza e kurrikulës së gjimnazit*, Tiranë, 2009.
- Instituti i Kurrikulës dhe i Trajnimit, *Udhëzuesi për zhvillimin e kurrikulës së re të gjimnazit*, Tiranë, 2010.
- Instituti i Kurrikulës dhe i Trajnimit, *Vlerësimi i nxënësit-Manual për mësuesit*, Tiranë, 2009.
- Ligji Nr.7952, dt.21.06.1995 "Për sistemin arsimor parauniversitar", i ndryshuar me ligjin Nr. 8387, datë 30.07.1998; ligjin Nr.8872, datë 29.03.2002; ligjin Nr.9903, datë 17.04.2008; ligjin Nr.9985, datë 11.09.2008.
- MASH & Save the Children, *Manual inspektimi i plotë i shkollës*, Tiranë, 2005.
- MASH & Save the Children, *Manual vetëvlerësimi i shkollës*, Tiranë, 2007.
- Misha, A., *Vlerësimi i shkollës*, Tiranë, 2003.
- Musai, B., *Metodologji e mësimdhënies*, Tiranë, 2000.



- QTKA, *Aftësimi dhe trajnimi i mësuesve drejt një zhvillimi profesional afatgjatë*, Tiranë, 2001.
- Save the Children & MASH, Manuali “*Vetëvlerësimi i Shkollës*”, Tiranë, 2007.
- Susan M. Heathfield, *What is human resource management* (article).
- *The International Encyclopedia of Teacher and Teacher Education*, Pergamon, 1995.
- The Scottish Office (2000). Përkthim.
- Udhëzimi Nr.29, datë.25.09.2007 “Për grumbullimin, ruajtjen dhe përdorimin e të ardhurave nga dhurimet nga prindërit e nxënësve të shkollave të arsimit parauniversitar”.
- Udhëzimi Nr.40, datë 17.10.2007 “Për ngritjen dhe funksionimin e bordit të shkollës”.
- Urdhër Nr.170, datë.21.04.2008 “Për funksionimin e shërbimit psikologjik shkollor në sistemin arsimor parauniversitar”.

## NË VEND TË MBYLLJES...

Udhëzuesi “Inspektimi dhe vlerësimi i brendshëm i shkollës” synon të ndihmojë mësuesit dhe drejtuesit e shkollës për të zbatuar kurrikulën me të gjithë elementet e saj, sipas standardeve zyrtare, por dhe të mbështesë një bashkëpunim dhe menazhim të frytshëm të institucionit-shkollë, duke përfshirë në këtë proces të gjithë stafin e saj.

Në qendër të vëmendjes, ky botim ka gjithnjë fëmijën-nxënës, kujdesin për të, dhe, në mënyrë të veçantë, arritjet e tij të cilat i japin krenari dhe identitet shkollës.

IKAP-i, si institucioni përgjegjës i inspektimit, do ta përdorë këtë botim si një material që, *veçanërisht*, do të nxitë, do të përmirësojë dhe do të sigurojë një shërbim cilësor të shkollës dhe *asnjëherë* për qëllime të mirëfillta kontrolli keqdashës.

Në udhëzues gjenden shumë tregues dhe instrumente, por ato nuk mund të përdoren të gjitha në një kohë. Vlera e tyre parësore është që çdo mësues apo drejtues shkollë t’i lexojë dhe të identifikojë se ku është me përmbushjen e tyre, me qëllim që të përmirësojë dhe të përsosë më tej aftësitë dhe kompetencat profesionale, si mësues lëndor, mësues kujdestar, drejtues shkollë, por edhe si anëtar i ekipeve dhe organizmave të ndryshëm të shkollës.

Çdo shkollë i përdor treguesit dhe instrumentet sipas objektivave afatgjatë dhe vjetor të saj, për të bërë vlerësimin e brendshëm dhe verifikimin e gjendjes reale, duke përcaktuar edhe rrugët për përmirësimin në të ardhmen.

IKAP-i do të punojë që të instalojë në çdo shkollë kulturën e vetëvlerësimit, në mënyrë që të sigurojë dhe të rritë cilësinë e shërbimit arsimor.

Shkolla mund të përqendrohet të paktën, në dy fusha dhe tregues të tyre që lidhen ngushtë me synimet dhe objektivat e saj, për t’i patur objekt të vlerësimit të brendshëm gjatë një viti shkollor.

Kjo është një rrugë sfiduese, por që kërkon pasion e përkushtim, më qëllim që ju, mësues dhe drejtues, ta ktheni shkollën tuaj në një mjedis realisht profesional, ku pasurohen çdo ditë përvojat e të nxënit.

Inspektimi dhe vlerësimi i brendshëm i shkollës/ Autorë: Stafi i  
IKAP-it; red. shkenc Nikoleta Mita. - Tiranë:  
Inspektoriati Kombëtar i Arsimit Parauniversitar, 2011  
116f; 21x21cm. - (Inspektoriati Kombëtar i Arsimit  
Parauniversitar)  
Shtypur në shtypshkronjën KRISTALINA - KH